



AVOKATI I POPULLIT

**Konferenca Kombëtare
“AVOKATI I POPULLIT
NË MBROJTJE TË PERSONAVE
ME AFTËSI TË KUFIZUARA”**

Organizuar nga AVOKATI I POPULLIT
në bashkëpunim me Save the Children
dhe UNICEF - Shqipëri

11 DHJETOR 2006

PASQYRA E LENDES

Fjala e hapjes Z. Ermir Dobjani, Avokat i Popullit "Avokati i Popullit në Mbrojtje të Personave me Aftësi të Kufizuara"	5
Fjala e Ilir Rusmajli Zv.kryeministër "Të drejta dhe dinjitet të barabartë, për personat me aftësi të kufizuara"	9
Fjala përshëndetëse e Z. Koço Barka Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Politikat për Personat me Aftësi të Kufizuar, në kontekstin e modelit social shqiptar	11
Fjala përshëndetëse e Z.Arben Ivanaj Zv.ministër i Shëndetësisë Ministria e Shëndetësisë dhe problematika e Personave me Aftësi të Kufizuara	16
Fjala përshëndetëse e Z.Genc Pollo Ministër i Arsimit dhe Shkencës Krijimi i shanseve të barabarta për arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara	19
Fjala Drejtorit të Save the Children-Shqipëri Z. Stefen Ashby. Aftësinë e Kufizuar dhe arsimin gjithëpërfshirës	21
Fjala Përfaqësueses së UNICEF në Shqipëri Zj.Carrie Auer	24
Fjala e Znj.Blertha ÇANI Kryetare e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar	
Fjala e Z.Kosta Barjaba Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Drejtor i Kabinetit Implementimi i Strategjisë së PAK-ut, pagesat dhe shërbimet për aftësinë e kufizuar	30
Fjala përshendetese e Prof. Sinan Tafaj.. Kryetar i Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë dhe Kryetar i Këshillit Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuar E drejta e përfaqësimit të PAK-ut, rëndësia e organizimit të tyre dhe roli i organizatave kombëtare të PAK-ut	38
Fjala përshëndetëse e Znj Merlta Pone (Myftari) Shoqata "Handicap International Shqipëri" Zhvillimi përfshirës dhe Konventa për Mbrojtjen dhe Nxitjen e të Drejtave dhe Dinjitetit të Personave me Aftësi të Kufizuar	49
European Disability Forum – EDF (Forumi Europian i Aftësisë së Kufizuar) Një shoqëri që është e mirë për njerëzit me aftësi të kufizuara është e mirë për të gjithë	54
Z.Riza Poda, Komisioner i Zyrës së Avokatit të Popullit Institucioni i Avokatit të Popullit në Mbrojtje të Integritimit dhe Barazisë në Komunitet të Personave me Aftësi të Kufizuar"	58
Fjala e Z.Abdulla Omuri Kryetar i "Shoqatës të Invalidëve të Punës të Shqipërisë" Integrimi i invalidëve të Punës në shoqëri nëpërmjet Punësimit	64
Fjala e Z.Bardhylka Kospiri Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar Legjislacioni, si zbatohet, mangësitë dhe problematikat në këndvështrimin e aftësisë së kufizuar	68

Fjala e Z. Nuredin Dushani Nënkryetar i Shoqatës “Invalidët e Luftës Antifashiste të Popullit Shqiptar”	
Të rritim më tej kujdesin për invalidët e luftës	76
Fjala e Z. Eduard Ajazi Kryetar i “Shoqatës së Personave që nuk Dëgjojnë”	
Arsimimi i personave që nuk dëgjojnë në Shqipëri	
Fjala e Znj. Mybere Prizreni Kryetare e “Shoqata e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë”	
Të aftë ndryshe, por të barabarte me të gjithë	83
Fjala e Znj. Vera PAJA Kryetare e “Shoqatës së Grave dhe Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar”	
Mendime për legjislacionin aktual për Personat me Aftësi të Kufizuar	87
Fjala e Z. Zela Kola “Shoqata e Mbrojtjes së të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar”, me qendër në Librazhd Vlerësimi i nevojave të personave me aftësi të kufizuara.	
Fjala e Z. Nasi Duka President i Përgjithshëm i Shoqatës Kombëtare “Në Ndihmë të Handikapëve Mendorë”	
Legjislacioni Shqiptar në fushën e paaftësisë mendore dhe zbatimi në praktikë	90
Fjala e Z. Nasi Duka President i Përgjithshëm i Shoqatës Kombëtare “Në Ndihmë të Handikapëve Mendorë”	
Legjislacioni Shqiptar në fushën e paaftësisë mendore dhe zbatimi në praktikë	92
Fjala e Z. Ndrek Ismajli Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Drejtoria e Shanseve të Barabarta	
Udhëkryqi i Legjislacionit të Personave me Aftësi të Kufizuara	99
Fjala e Dr. Veip Proda Kryetar i Shoqatës “Mbrojtja, Integrimi dhe Socializimi i Artistëve me Aftësi të Kufizuara”	
Diskutim në Konferencën Kombëtare “Të drejta dhe dinjitet të barabartë për personat me aftësi të kufizuar	101
Rekomandimet e Konferencës	104

FJALA E AVOKATIT TË POPULLIT, Z. ERMIR DOBJANI, NË KONFERENCËN KOMBËTARE ME TEMË “AVOKATI I POPULLIT NË MBROJTJE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA”

Tiranë, 11 dhjetor 2006

Të nderuar pjesëmarrës!

Konferenca e sotme është e gjashta radhazi që organizon Institucioni i Avokatit të Popullit, që nga fillimi i veprimtarisë së tij, në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve, të cenuara nga veprimet ose mosveprimet e organeve apo funksionarëve të administratës publike shqiptare.

Sivjet u mendua që tema e Konferencës Kombëtare që organizon çdo vit Institucioni i Avokatit të Popullit të jenë problemet e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Këta persona zënë rreth 3 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë në vendin tonë, dhe përbëjnë shtresën me standarde të ulëta ekonomike, me mundësi më të pakta arsimimi dhe punësimi, me aftësi të kufizuara lëvizjeje; me një fjalë, gëzojnë të drejta njerëzore në përgjithësi të kufizuara.

Në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut shpallet se të gjitha qeniet njerëzore kanë lindur të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta, dhe se gjithkush duhet t’i gëzojë këto të drejta dhe liri të shprehura në të, pa dallim race, ngjyre, seksi, gjuhe, besimi fetar, politik apo çfarëdolloj besimi tjetër, origjinë kombëtare apo sociale, pasurie, statusi lindjeje apo çdo statusi tjetër.

Që të arrihet qëllimi i Deklaratës Universale, të gjitha komunitetet duhet të reflektojnë për të krijuar kushtet që Personave me Aftësi të Kufizuar t’u garantohen të drejtat civile, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore, të njohura si standarde nga Aktet Ndërkombëtare.

Për fat të keq, sikundër mund të dalë edhe nga kontributet e gjithsecilit në këtë Konferencë, kam përshtypjen se një vëzhgim mbi zbatimin, pra edhe për efikasitetin e tyre, të zhgënjën.

Moszbatimi i kuadrit ligjor dhe mungesa e strukturave dhe sistemeve kontrolluese janë bërë pengesë në lehtësimin e jetës dhe të qenit e këtyre personave në vëmendjen e duhur të shoqërisë. Varfëria dhe padrejtësitë shoqërore, qëndrimet rëndom diskriminuese nga segmente të caktuara të komunitetit dhe të administratës publike, veçimi në banesa, largësia nga qendrat administrative dhe mungesa e mbështetjes, apo edhe ndarja jo e drejtë e burimeve ekonomike e financiare, janë faktorë të dukshëm që s'mund të anashkalojnë. Hidhni një sy në të gjitha ndërtesat qeveritare dhe publike dhe do shikoni se këta persona nuk mund të hyjnë dot në to bashkë me karrocet e tyre. Kjo mund të thuhet edhe për të gjitha hotelet e vendit, me përjashtim të këtij hoteli ku zhvillojmë sot këtë konferencë. Kjo ishte edhe arsyeja kryesore pse e zhvillojmë konferencën në këtë hotel, i cili është më i shtrenjti në Shqipëri.

Një faktor tjetër i rëndësishëm në skakierën e zhvillimit dhe zbatimit të politikave të shërbimit social, janë vetë grupimet e personave me aftësi të kufizuara, të cilët rezultojnë të ndërgjegjësuar se vazhdimi pafundësisht i të jetuarit me ndihma ekonomike dhe të natyrave të tjera të ngjashme, nuk është zgjidhja më e mirë. Tashmë pranohet nga të gjithë se politikat sociale, qoftë në kushtet e një habitati sa më komod ekonomik-shoqëror, nuk mund t'u japin zgjidhje të gjitha problemeve të personave në nevojë, pa pjesëmarrjen aktive dhe të organizuar të vetë kësaj shtrese. Hapja e vendeve të posaçme të punës apo punësimit i sa më shumë personave me aftësi të kufizuara, është një objektiv dhe sfidë për të gjithë administratën publike shqiptare.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me parimet dhe vlerat mbi të cilat ushtron veprimtarinë e tij, një vëmendje të veçantë i ka kushtuar edhe trajtimin të problemeve dhe shqetësimeve të Personave me Aftësi të Kufizuara, të bëra të njohura përmes rrugëve të ndryshme të informimit. Në institucionin tonë vepron nënseksioni për fëmijët, përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, tregues i rritjes së interesimit tonë për këto kontingjente individësh. Në funksion të shtrirjes së tij dhe në bazë të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", janë ngritur në bashkëpunim me *Save the Children*, dy zyra rajonale, përkatësisht në Shkodër dhe Korçë, për të qenë më afër njerëzve dhe problemeve të tyre.

Sakaq, është nxitur fakti se ka një shtim të organizatave, shoqatave dhe fondacioneve jofitimpruese të licencuara, rrjeti i të

cilave mbulon thuajse gjithë territorin e vendit. Në përmbushjen e misionit të tyre njerëzor, kjo pjesë e shoqërisë civile punon me individë me aftësi të kufizuar, me organizata simotra të tyre brenda dhe jashtë vendit, me institucionet shtetërore për promovimin e legjislacionit tonë dhe atij ndërkombëtar, për zhvillimin e programeve, ofrimit të konsulencës ligjore dhe të shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuar.

Të nderuar pjesëmarrës!

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, e miratuar në gusht të këtij viti nga Kombet e Bashkuara, është një akt juridik tepër i rëndësishëm, dokumenti kryesor, unik dhe universal në pandashmërinë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga ato të mbrojtjes dhe afirmimit të Personave me Aftësi të Kufizuara. Konventa parashikon zhvillimin e politikave sociale, vendos rregulla dhe standarde unifikuese për të gjitha vendet që do të aderojnë në të, me qëllim ekuilibrimin e mundësive që do t'u jepen personave në nevojë, do të jetë specifike në sanksionimin e integritit të tyre në shoqëritë e vendeve aderuese dhe promovon respekt për dinjitetin e tyre të lindur. **Miratimi sa më i shpejtë i saj nga Kuvendi i Shqipërisë**, do të rrisë shkallën e përgjegjësisë dhe të fokusimit të detyrimit dhe përkrahjes pozitive të shtetit për barazi, jetesë e lëvizje të pavarur, privatësi dhe pjesëmarrje pa kufizime në jetën publike dhe politike. Ky, mendoj, do të jetë edhe një ndër përfundimet me të cilat do të dale kjo konferencë, e që do të përfshihet në rekomandimet përkatëse që Avokati i Popullit, si çdo vit, ka përgatitur dhe dërguar instancave më të larta shtetërore.

Ne vlerësojmë pozitivisht edhe tre Vendimet e Qeverisë të datës 6 dhjetor 2006 për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuar dhe të moshuarit në qendrat rezidenciale, ngritjet e pensioneve të pleqërisë apo atyre të veçanta e masa të tjera me karakter social.

Impenjimi dhe shkalla e përgjegjësisë e institucioneve shtetërore dhe e faktorëve të tjerë aktivë të shoqërisë civile, informimi i drejtë i strukturave përgjegjëse dhe opinionit, do të rrisë interesin e të gjithë shoqërisë dhe ndikimin e tyre në mbrojtjen e të gjithë Personave me Aftësi të Kufizuara, sigurimin e një niveli ekonomik të nevojshëm për përmirësimin e kushteve të strehimit, të rritjes së mundësive për punësim, për ngritjen e nivelit të tyre kulturor, arsimor

e profesional, me synim integrimin e tyre të mëtejshëm në shoqëri.

Në emër të Institucionit që drejtoj, unë ju siguroj se Avokati i Popullit do të ketë të gjithë vullnetin dhe predispozicionin e duhur që, në emër të standardeve më të larta në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, të adresojë me profesionalizëm maksimal të gjitha shqetësimet e ligjshme të kësaj shtrese, duke kërkuar nga instancat e administratës publike respektimin dhe rivendosjen e të drejtave të shkelura.

Njëkohësisht, në vazhdimësi të praktikave tona më të mira, Zyra jonë do të vazhdojë t'i rekomandojë pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv përmirësime dhe ndryshime në aktet ligjore e nënligjore, në zbatim të Akteve dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare, që shteti ynë ka ose do aderojë, si dhe të Kushtetutës dhe ligjeve të vendit tonë. Firmosja nga shteti shqiptar i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, na obligon të gjithëve si shoqëri dhe si shtet për arritjen e standardeve të tjera, cilësisht më të larta, në hartimin e politikave sociale për përfshirjen dhe gjetjen e individualitetit të secilit person në nevojë në gjithë veprimtarinë shoqërore, ekonomike dhe politike të vendit.

8

Avokati i Popullit shikon si mjaft pozitiv faktin se ndërgjegjësimi dhe zëri i tyre për barazi, mos-diskriminim dhe integrim në komunitet ka ardhur gjithnjë e në rritje, veçanërisht për detyrimet që ka shteti dhe shoqëria ndaj tyre. Ne u bëjmë thirrje këtyre njerëzve dhe shoqatave të tyre që të ngrenë më tepër zërin dhe t'i përdorin më tepër të gjitha mjetet e mundshme në demokraci, për të fituar të gjitha të drejtat e tyre. Ju nuk duhet t'i konsideroni të drejtat që fitoni si "lëmoshë apo privilegje që ju falen" nga qeveritë shqiptare, por si të drejta të ligjshme që ju takojnë dhe që shoqëria shqiptare jua ka borxh dhe duhet t'jua kthejë këtë borxh.

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen dhe suksese punimeve të kësaj konference!

“TË DREJTA DHE DINJITET TË BARABARTË, PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

Ilir Ruzmajli
zv.kryeministër

I nderuar zoti Dobjani, Avokat i Popullit!

Të nderuar pjesëmarrës!

“Një shoqëri që është e mirë për njerëzit me aftësi të kufizuara është e mirë për të gjithë.”

Dëshiroj në radhë të parë të falënderoj organizatorët e kësaj konference për ftesën, si edhe shpreh kënaqësinë e veçantë të përshëndes të gjithë pjesëmarrësit të cilët kontribuojnë në fushën e mbrojtjes të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Kjo konferencë e organizuar nga Avokati i Popullit, me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve që kontribuojnë në këtë fushë, tregon jo vetëm për rritjen e përgjegjësisë të të gjitha hallkave institucionale dhe shoqërore ndaj kësaj shtrese, por tashme po dëshmohet edhe një ndërgjegjësim më pozitiv edhe ndaj harmonizimit më të mirë të të gjithë komponentëve që ndikojnë direkt në përmirësimin e jetës së Personave me Aftësi të kufizuara, për të drejta dhe dinjitet të barabartë.

Për t'u theksuar është gjithashtu se kjo konferencë zhvillohet në një kohë kur Kombet e Bashkuara po organizojnë takime rajonale dhe ndërkombëtare për lançimin e Konventës Ndërkombëtare, integrale dhe gjithëpërfshirëse, për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara.

Duke qenë se jemi në një fazë të re të të gjitha zhvillimeve social-ekonomike të vendit, të cilat përkojnë tashmë edhe me zhvillimet botërore dhe rajonale për nevojën e progresit në realizimin e standardeve të domosdoshme edhe për këtë shtresë të popullsisë, çështjes duhet t'i përafrohemi sipas modelit të shoqërisë bashkëkohore.

Në cilësinë edhe të kryetarit të Këshillit ndër ministror unë ju siguroj se qeveria jonë, ashtu si ka treguar vullnet të plotë politik në hapat e ndër marrë gjatë këtij viti për realizimin e objektivave të strategjisë Kombëtare të PAK-ut, do të vazhdojë të tregojë një kujdes edhe në vazhdim për përmirësimin e jetës së kësaj shtrese.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se modele të reja të aftësisë së kufizuar e ripërcaktojnë PAK-un si pjesëtare me të drejta të plota në shoqëri, që kanë mundësi të japin një kontribut të çmuar për veten, familjet e tyre dhe për komunitetin ku ata jetojnë, tashmë kjo po funksionon edhe te ne.

Kjo përfaqje e rishikuar, që shpesh quhet model social për aftësinë e kufizuar, gjen mishërim të plotë sa te programi i qeverisë po aq edhe në masat që po merren për zbatimin e strategjisë kombëtare të PAK-ut.

Personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një grup të konsiderueshëm, të cilët përballen me vështirësitë në integrimin e tyre në jetën shoqërore. Ata kanë nevojë për mbështetje, për të realizuar të drejtat e tyre si qytetarë të barabartë të shoqërisë. Prandaj qeveria shqiptare dhe institucionet e saj e kanë vënë fokusin në radhë të parë në identifikimin, zbutjen dhe pakësimin e kufizimeve që hasin personat me aftësi të kufizuar në ambientin fizik e social në të cilin jetojnë.

Të gjithë masat konkrete të marra gjatë këtij viti tregojnë për një progres pozitiv të realizimit të shumë objektivave të vendosura në strategjinë kombëtare të PAK-ut.

Gjithashtu, ndihma e shërbimit social për personat me aftësi të kufizuar po synon të mënjanojë barrierat dhe të krijojë kushte sa më optimale që edhe kjo kategori të shprehë vetveten.

Ajo që dua të theksoj në këtë takim është dhe vlerësimi mjaft pozitiv për rolin dhe kontributin që kanë luajtur pikërisht shoqatat e aftësisë së kufizuar jo vetëm në mbrojtje të interesave grupit që përfaqësojnë, por edhe për rolin që ato luajnë si partnere aktive në të gjitha nismat programore apo legislative, duke bërë kështu realitet filozofinë e Konventës që është gjithëpërfshirja.

Me dëshirën dhe urimin që kjo konferencë të ndikojë pozitivisht në sensibilizimin e të gjithë aktorëve dhe faktorëve që kontribuojnë në përmbushjen e sfidës për një jetë më të mirë dhe një shoqëri pa dallime, do t'u uroja suksese të mëtejshme.

POLITIKAT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR, NË KONTEKSTIN E MODELIT SOCIAL SHQIPTAR

Kosta Barka

Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

I nderuar z. Rusmajli!

I nderuar z. Dobjani, organizator i konferencës!

Të nderuar kolegë ministra!

Të nderuar pjesëmarrës!

Konferenca e sotme e Avokatit të Popullit, sjell në vëmendjen tonë një temë të rëndësishme të politikave e shërbimeve sociale në Shqipëri: trajtimin e të drejtave sociale dhe humane të personave me aftësi të kufizuara.

Realizimi i këtyre të drejtave lidhet ngushtë me objektivat dhe punën e institucioneve të ndryshme qeveritare: Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punëve Publike dhe Rregullimit të Territorit, si dhe institucione dhe agjenci të tjera që kanë në misionin e tyre detyrime për plotësimin e kërkesave për përmirësimin e cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara.

Vënia në fokus e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Konferencën vjetore të Avokatit të Popullit, tregon se çështjet e këtij grupimi të popullsisë janë një preokupim gjithëshoqëror; kjo dëshmon për ndërgjegjësimin dhe vëmendjen e institucioneve të pavarura, shoqërisë civile dhe opinionit publik ndaj personave me aftësi të kufizuara, jetesës si dhe të drejtave të tyre.

Para se të kaloj në trajtimin e disa problematikave konkrete të politikave të PAK-ut, do të dëshiroja të paraqisja para jush disa refleksione të miat, të cilat lidhen me kontekstin e politikave sociale europiane dhe ndërtimin e modelit social shqiptar.

Siç e dimë, politikat sociale, ndoshta më shumë se çdo fushë tjetër e politikave kombëtare të vendeve anëtare të BE-së, janë jo uniforme dhe asimetrike. Më shumë sesa atribut i Brukselit, politikat

sociale janë prerogativ i qeverive kombëtare të vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Zgjerimi i BE-së me anëtarë të rinj, përveç implikimeve të tjera, ka shkaktuar probleme edhe në sinkronizimin e politikave ekonomike, të tregut dhe atyre sociale dhe ka vendosur në një kontekst të ri përpjekjet për forcimin e kohezionit social në kontinent. Në këtë kuptim, është vështirë të flitet për një model social europian dhe është më vështirë akoma të flasim sot për një model social shqiptar.

Me gjithë këtë vështirësi, studiuesit dhe politikëbërësit socialë flasin aktualisht për katër modele kryesore të politikave sociale europiane, që lidhen me katër modelet përkatëse të sistemit të welfare në Europë:

1) Modeli i sistemit liberal, që aplikohet kryesisht në Britaninë e Madhe dhe Irlandë, tipar i të cilit është aplikimi i përfitimeve të kufizuara ekonomike e sociale, duke i dhënë prioritet krijimit të kushteve ekonomike e sociale për grupet vulnerable, nëpërmjet nxitjes së zhvillimit ekonomik dhe aksesit të tyre në këtë zhvillim;

2) Modeli skandinav social-demokrat, që aplikohet kryesisht në vendet skandinave, Danimarkë, Suedi, Finlande etj., i cili karakterizohet nga aplikimi i përfitimeve të larta në korrelacion me nevojat e grupeve vulnerable të popullsisë dhe që për pasojë rezulton me një kosto mjaft të lartë të sistemit të welfare, por që përballohet jo me shumë vështirësi nga ekonomitë dhe shoqëritë e konsoliduara në këto vende;

3) Modeli korporativ, i aplikuar kryesisht në Gjermani, Austri, Francë, Belgjikë etj., tipar i të cilit është dhënia përparësi nevojave ekonomike e sociale të grupeve të caktuara profesionale vulnerable të popullsisë;

4) Modeli Mesdhetar, që ka filluar të aplikohet në vende të tilla si Itali, Greqi, Spanjë, Portugali etj., tipar i të cilit është aplikimi i përfitimeve të ulëta sociale të papunësisë, asistencës sociale e familjare dhe lejeve për detyrime prindërore.

Siç edhe përmenda më lart, është e vështirë që të vlerësojmë modelin aktual social shqiptar, i cili paraqitet aktualisht i diversifikuar dhe në proces kristalizimi. Ligji për Shërbimet Sociale i vitit 2005 ishte një përpjekje që duhet vlerësuar për ndërtimin e politikave sociale kohezive për grupet vulnerable të shoqërisë. Ligji i mësipërm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij kanë krijuar një model social të

përzier me elemente të modelit korporativ dhe mesdhetar. Pyetjes se “Çfarë modeli social duhet të ndërtojmë në Shqipëri?” nuk është e lehtë për t’iu përgjigjur dhe për këtë duhet ta thonë fjalën të gjithë, por në radhë të parë ekspertet e studiuesit dhe pastaj ligjvënësit e politikëbërësit.

Duke zbritur në terrenin konkret të politikave sociale, dëshiroj të nënvizoj se problematikat e PAK-ut, nëpërmjet Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara, tashmë janë bërë pjesë integrale e punës së institucioneve qendrore e vendore si dhe e organizatave që përfaqësojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre. Ministria e Punës, po monitoron strategjinë e mësipërme nëpërmjet Sekretariatit Teknik për PAK-un, që është ngritur pranë Drejtorisë së Shanseve të Barabarta në ministri.

Dëshiroj të theksoj se situata e personave me aftësitë të kufizuara, aspektet sociale, shëndetësore, ekonomike, të pjesëmarrjes në jetën publike etj., kanë ndryshuar duke u përmirësuar nga viti në vit.

Qeveria nisët nga maksima se nuk mund të ketë politika për PAK-un pa rolin dhe inputet e personave me aftësi të kufizuar në këto politika. Prandaj, krahas punës së Qeverisë për përmirësimin e jetës së grupeve në nevojë, si prioritet të komponentit social të Programit të Qeverisë, dëshiroj të ndaj me ju edhe impaktin e punës së organizatave të personave me aftësi të kufizua dhe organizatave që ofrojnë shërbime për këtë grupim social. Organizatat e personave me aftësi të kufizuara, duke njohur më mirë gjendjen dhe nevojat e PAK-ut, janë nxitësit kryesorë të politikave të reja. Po ashtu OJF-të, me shërbimet që ofrojnë, kanë pasuruar ndjeshëm rrjetin e shërbimeve sociale për PAK-un.

Ministria e Punës ka bashkëpunuar dhe vazhdon të bashkëpunojë me organizatat e fushës së aftësisë së kufizuar dhe i konsideron ato partnere në zhvillimin e politikave dhe programeve të reja për mbështetjen e PAK-ut. Nga ky bashkëpunim politikat e Ministrisë së Punës janë më afër realiteteve të vendeve të përparuara dhe direktivave të Bashkimit European.

Sot në këtë Konferencë dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj reformën e thellë dhe politikat e reja që Ministria e Punës ka ndërmarrë në sistemin e pagesave dhe të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

Reforma, e mbështetur në ligjin nr. 9355 “Për ndihmën dhe

shërbimet shoqërore”, të cilit iu referova më lart, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, synon:

- Mbulimin më të mirë me pagesa të grupeve të aftësisë së kufizuar, duke hequr kufizimet e ligjeve ose vendimeve të mëparshme.

- Si rezultat i kësaj politike, është hequr kufizimi i moshës, deri në 21 vjeç, për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar.

- Gjithashtu, zgjerohet grupi i para tetraplegjikëve edhe me përfitues të tjerë, përveç atyre me dëmtime në shtyllën kurrizore. Nga kjo hapësirë përfitojnë 500–600 para-tetraplegjikë dhe një numër i konsiderueshëm i PAK mendorë e fizikë.

- Konsiderimin e pagesave si një e drejtë individuale e personave me aftësi të kufizuara, që u jep mundësinë për shërbime cilësore dhe pavarësi.

- Kjo është realizuar përmes vlerësimit më të mirë të së drejtës për shërbimin e kujdestarisë dhe dhënien e kësaj pagese në çdo rast, që ka nevojë për shërbim, pa kufizime, që më parë lidheshin me gjendjen financiare të familjes. Nga kjo masë po përfitojnë rreth 10 mijë persona me aftësi të kufizuara shtesë.

- Rritjen e pagesave në Kesh, për të plotësuar më mirë nevojat e PAK-ut dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. Si rezultat:

- Pagesa e aftësisë së kufizuar, për të gjitha grupet, bëhet 80 \$ nga 68 \$ që ka qenë;

- Pagesa e PAK-ut dhe pagesa e kujdestarisë, rriten çdo vit mbi bazën e indeksimit vjetor të pagës minimale;

- Pagesa e kujdestarisë për të verbrit dhe para tetraplegjikët bëhet 80 \$ nga 68 \$;

- Kujdestaria e PAK-ut, mendorë e fizikë, unifikohet me kujdestarinë e grupeve të tjera dhe bëhet 80 \$ nga 50 \$ që ka qenë;

- Përcaktohet masa e kujdestarisë 150% për familjet me më shumë se një PAK;

- Në këto nivele janë rritur edhe pagesat për nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuar, që vazhdojnë arsimin e mesëm dhe të lartë.

- Për vitin 2007, janë parashikuar 8.1 miliardë lekë, të cilat do të mbulojnë të gjitha pagesat dhe shërbimet për PAK-un.

- Ministria e Punës po ndërton një sistem informacioni të detajuar për personat me aftësi të kufizuara, që do të shërbejë për vlerësimin më të mirë të politikave aktuale dhe ndërmarrjen e hapave të tjerë për të realizuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Ky

informacion përfshin të dhëna për grup moshën, llojin e aftësisë së kufizuar, gjininë, nivelin arsimor etj.

- Për vitin 2007 janë parashikuar të gjitha fondet e nevojshme për pagesat dhe shërbimet për PAK-un.

- Edhe sistemi i shërbimeve për PAK-un është në vëmendjen e Ministrisë së Punës. Me decentralizimin e qendrave të zhvillimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, brenda tyre do të hapen edhe njësi ditore shërbimesh, për përfituesit e komunitetit afër tyre.

- Shërbime të reja ditore po ngrihen edhe nga Projekti i Bankës Botërore dhe shërbimet për PAK-un përbëjnë një të tretën e tyre.

- Në objektivin e Ministrisë së Punës, për të garantuar cilësinë e shërbimeve, ishte edhe hartimi i standardeve për shërbimet e PAK-ut, të cilët u miratuan nga Qeveria këtë muaj.

- Në vazhdim, Ministria po studion edhe politika të reja për mbështetjen e grupeve të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara:

- Është përgatitur projektvendimi për mbështetjen e para tetraplegjikëve, që kanë nevojë, me një paketë me materiale higjieno-sanitare, i cili pritet të miratohet së shpejti.

- Po vlerësohet mundësia për rritjen e masës mujore të karburantit, të caktuar për lëvizjen e PAK-ut.

- Po përgatiten kriteret mjekësore, që edhe njerëzit e prekur nga HIV-AIDS të trajtohen me pagesë për aftësinë e kufizuar.

Në mënyrë më të detajuar politikat e Ministrisë për PAK-un do të prezantohen në një referat teknik në Seksionin e Dytë të Konferencës.

Duke shprehur vlerësimin tim për objektivin e kësaj Konference, ju garantoj se Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta do të vazhdojë në rrugën e reformave, të politikave e shërbimeve sociale, për të rritur cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara sa më pranë standardeve bashkëkohore.

Ju faleminderit!

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE PROBLEMATIKA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Arben Ivanaj
Zv.ministër i Shëndetësisë

I nderuar z.Dobjani!

Zonja dhe zotërinj!

Dëshira për të hequr pengesat që shkaktojnë aftësinë e kufizuar lidhet ngushtësisht me idenë e të drejtave të njeriut dhe të njerëzve që kanë pësuar dëmtime. Askush nuk mund të jetojë si qenie njerëzore me të drejta të plota, nëse mungojnë të drejtat dhe liritë e tij.

Neni i parë i Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut përcakton: “Të gjithë njerëzit janë të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta”. Në mënyrë që të arrihet ky qëllim, edhe Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarrë një sërë iniciativash për përmirësimin e kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuar, për të siguruar një jetesë pa barriera.

Parimi i Rehabilitimit qëndron në bazë të procesit i cili u siguron personave me aftësi të kufizuara mjetet dhe rrugët për një jetesë të pavarur. Ai ka të bëjë me masat që merren për parandalimin, lehtësimin apo kompensimin e një aftësie të kufizuar, për parandalimin e përkeqësimit të saj, për nevojën për një kujdes afatgjatë dhe mundësimin e jetës normale për personat me aftësi të kufizuar.

Në tre vitet e ardhshme përpjekjet e Ministrisë së Shëndetësisë për trajtimin e personave me aftësi të kufizuar do të përqendrohen në dy drejtime kryesore:

- Së pari, në krijimin e një rrjeti kabinetesh të rehabilitimit fizik mjekësor

-Së dyti, në krijimin e qendrave të trajtimit mendor.

Kjo politikë mbështetet në Strategjinë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, të shpallur nga Qeveria Shqiptare, e cila thekson nevojën për “ *të aprovuar dhe zbatuar një program kombëtar për*

ngritjen dhe funksionimin e shërbimit rehabilitues, që gradualisht duhet të mbulojë të gjithë Shqipërinë”. Ministria e Shëndetësisë ka shprehur vullnetin e qartë për realizimin e kësaj strategjie.

Për arritjen e objektivave të mësipërme, gjatë muajit qershor 2006 u hartua dokumenti për *“përmirësimin e shërbimit të rehabilitimit të fokusuar te njerëzit me aftësi të kufizuar, për të sjellë një përmirësim të dukshëm në gjendjen dhe cilësinë e tyre të jetës”*.

Për të realizuar këta objektiva, Ministria e Shëndetësisë e ka përqendruar vëmendjen në sensibilizimin e të gjithë aktorëve kryesorë, si drejtuesit e spitaleve universitare dhe të rretheve kryesore, drejtuesit e Kujdesit Shëndetësor Parësor si dhe drejtuesit e qeverisjes lokale dhe të Shëndetit në rrethe. Është bashkëpunuar ngushtësisht me Fakultetin e Mjekësisë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe që nga muaji shtator 2006 në Fakultetin e Infermierisë funksionon dega e fizioterapisë. Ky brez i ri i fizioterapistëve do të kontribuojë fuqimisht për lehtësimin e vuajtjeve për personat me aftësi të kufizuar, por njëkohësisht nëpërmjet një rehabilitimi profesional dhe me përkushtim do t’u sigurojë këtyre personave një jetë sa më afër jetës normale.

Për përmirësimin e Rehabilitimit Fizik, në Kujdesin Shëndetësor Universitar po punohet për ngritjen e një Qendre Kombëtare që do të shërbejë jo vetëm për trajtimin e specializuar të përbërë nga ekupe multidisiplinare, por kjo qendër njëkohësisht do të përfshihet edhe në formimin e profesionistëve të rinj në fushën e Rehabilitimit Fizik Mjekësor. Sigurisht kjo qendër do të krijohet duke u mbështetur në pavijonet apo njësitë ekzistuese, por do të lejojë që në të ardhmen të krijohet dega e specializimit për mjekët e rinj që mbarojnë Fakultetin e Mjekësisë, që deri më sot nuk ekziston. Kjo do të çojë në rritjen e cilësisë së shërbimit nëpërmjet përmirësimit gradual të shkallës së tipit të shërbimeve në kirurgji. Gjithashtu, do të krijohen në këto qendra njësi për pacientët të cilët kanë pësuar dëmtime të shumëfishta, të rënda dhe komplekse. Nga ana tjetër, me qëllim shtimin e kapaciteteve mjekuese dhe rehabilituese, gjatë vitit 2007 Ministria e Shëndetësisë nëpërmjet një financimi të Bankës Islamike dhe OPEK-ut do të fillojë ndërtimin e spitalit të ri në qytetin e Kavajës. Është menduar që në katin e parë të këtij spitali të ngrihet një pavijon për rehabilitim fizik mjekësor, i cili do të ketë hapësirat dhe pajisjet e nevojshme për një trajtim bashkëkohor dhe eficient. Po kështu me buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë, por edhe me

Mbështetjen e Departamentit të Shtetit Amerikan, do të rikonstruktohet dhe do pajiset një kabinet për orto-protezimin dhe fizioterapinë në spitalin e Kukësit, për të ndihmuar personat e dëmtuar gjatë luftës nga minat. Qendra të ngjashme do të hapen në vitet në vazhdim edhe në qytetet e tjera kryesore.

Një drejtim tjetër i punës do të jetë edhe “Shëndeti mendor”. Mbështetur edhe në *“Dokumentin Politik dhe planin e veprimeve të shëndetit mendor në Shqipëri*, ku theksohet se e vetnja mënyrë e sigurt për të arritur shërbime komunitare për të gjithë është deinstitucionalizimi i spitaleve psikiatrike dhe ngritja e një rrjeti të ri shërbimesh. Për të arritur këtu, Ministria e Shëndetësisë po punon për:

- Parandalimin e shtrimeve të papërshtatshme në spitalet psikiatrike dhe ngritjen e strukturave komunitare
- Transferimin e burimeve nga spitalet drejt komunitetit
- Uljen graduale të shtretërve në spitalet psikiatrike dhe ngritjen e strukturave komunitare.

Kështu, gjatë 2007-ës në qytetin e Shkodrës do të ndërtohen qendra të trajtimit mendor, të quajtura qendra “Mimoza”, me një vlerë prej 40 milionë lekësh të reja, ku pacientëve mendorë do t’u krijohen kushte sa më afër kushteve në familje. Kjo eksperiencë do të ndiqet edhe në vitet e ardhshme, duke synuar shtrirjen e këtyre strukturave në të gjithë vendin.

KRIJIMI I SHANSEVE TË BARABARTA PËR ARSIMIMIN E NXËNËSVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Genc Pollo

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Shkalla e emancipimit të një shoqërie vlerësohet nga qëndrimi që ajo u mban edhe ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Në këtë këndvështrim, MASH po tregon një kujdes të veçantë e të vazhdueshëm për arsimimin e nxënësve me nevoja të veçanta.

Dy janë objektivat kryesorë të punës së MASH:

- Shtrirja graduale e arsimit gjithëpërfshirës;
- Përmirësimi i shkollave speciale dhe kthimi i tyre edhe në qendra burimore për arsimin e zakonshëm.

Për realizimin e këtyre objektivave MASH ka marrë këto masa:

Po përmendim masat që MASH ka marrë këto dy vitet e fundit.

Pilotimi i ngritjes së 12 kopshteve dhe 12 shkolla integruese në gjashtë qytete, qendra qarku, ku ka universitete.

MASH në bashkëpunim me *Save The Children* dhe FSHDP (Fondacioni Shqiptar i të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara) ka filluar pilotimin e krijimit të shkollave dhe kopshteve të integruara në qytetet qendra qarku ku ka universitete. Në këtë kuadër funksionojnë 25 shkolla dhe 21 kopshte të integruara, nga 12 shkolla e 12 kopshte të planifikuara në Strategji. Për këtë, MASH në bashkëpunim me *Save The Children*, realizoi trajnimin e mësuesve dhe drejtuesve të këtyre shkollave e kopshteve. Tashmë po monitorojmë praktikën e integritit të shkollave e kopshteve në fjalë.

Gjithashtu, në këto shkolla po punohet për hartimin e planeve edukative individuale (PEI) për punën me nxënësit me aftësi të kufizuara. Këto plane do të shërbejnë si modele për të gjithë

mësuesit që do të punojnë me nxënësit me aftësi të kufizuara.

MASH, nëpërmjet Institutit të Kurrilulave dhe Standardeve, në bashkëpunim me *Save The Children*, po përgatit një paketë me udhëzime praktike, materiale didaktike dhe standarde integruese në ndihmë të shkollave.

Gjithashtu, jemi në proces të përgatitjes së dy buletineve me materiale me karakter divulgativ për mirërritjen e fëmijëve.

MASH ka hartuar standardet e ndërtimit të shkollave të reja, në të cilat përcaktohet dhe përshtatshmëria për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Jo vetëm në shkollat e reja, por edhe në shkollat që restaurohen, pas hartimit të këtyre standardeve, bëhet përshtatshmëria fizike e tyre.

-Gjithashtu, MASH në bashkëpunim me FSHDP ka kryer një studim për legjislacionin në fushën e aftësisë së kufizuar.

Regjistrimi me prioritet i këtyre të rinjve në shkollat e mesme profesionale.

- Bazuar në mundësitë dhe aftësitë konkrete të çdo fëmije, MASH ka mundësuar regjistrimin e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat artistike e profesionale.

Në vitin shkollor 2005-2006, me një shkresë të veçantë të MASH, kanë shkuar në shkollat e mesme me konkurs (pa konkurruar) 10 nxënës të verbër, nga të cilët 6 janë nxënës të këtij instituti, si dhe dy nxënës që nuk dëgjojnë e nuk flasin, ndërsa në vitin shkollor 2006-2007 kanë shkuar 8 nxënës.

- MASH po punon për të konsoliduar degën e Pedagogjisë Speciale në Universitetin e Vlorës. Theksojmë se me Udhëzimin e datës 31.08.2006, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për zbatimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2006-2007”, të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit u është kërkuar të emërojnë me përparësi në shkollat speciale dhe ato të integruara studentët të cilët kanë mbaruar për pedagogjinë speciale ne Universitetin e Vlorës.

MASH ka krijuar mundësinë e mbështetjes financiare për nxënësit me aftësi të kufizuara.

“SAVE THE CHILDREN” PËR AFTËSINË E KUFIZUAR DHE ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS

Stefen Ashby

Drejtor i “Save the Children”

Save the Children, si një organizatë që merret me të drejtat e fëmijëve, e konsideron arsimin gjithëpërfshirës si një nga gurët e themelit të veprimtarisë së saj globale dhe gjithashtu i ka dhënë përparësi arsimit gjithëpërfshirës brenda programit të Shqipërisë.

Sipas Bankës Botërore, më shumë se një e treta e fëmijëve në botë, që nuk frekuentojnë shkollat kanë një aftësi të kufizuar dhe me pak se 5% e fëmijëve me aftësi të kufizuara, arrijnë synimin e Arsimit për të Gjithë, që ka të bëjë me kryerjen e arsimit fillor.

Studimet jo vetëm vërtetojnë vlerën e arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, por sugjerojnë, gjithashtu, se mënyra më e mirë për t’i arsimuar nxënësit me aftësi të kufizuara është duke i vendosur ata së bashku me bashkëmoshatarët e tyre, pa kufizime në aftësi.

Studimi i kohëve të fundit nga Instituti Innocenti i UNICEF-it, sikurse edhe raporti i LINICEF-it mbi fëmijët e padukshëm, theksojnë në mënyrë të qartë çështjet që lidhen me mospërfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, të cilët kanë nevojë të trajtohen dhe ofrojnë udhëzime të dobishme si për agjencitë shtetërore edhe për OJF-të.

Qeveria e Shqipërisë ka bërë përparime në sigurimin e politikave të cilat do të ndihmojnë në mbështetjen e arsimit gjithëpërfshirës. Qeveria është angazhuar në zbatimin e Konventës të të Drejtave të Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara për të zhvilluar Arsimin për të Gjithë dhe gjithashtu ka zhvilluar kuadrin ligjor për arsimin gjithëpërfshirës.

Save the Children ka bashkëpunuar në mënyrë aktive me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës për krijimin e më shumë shkollave dhe kopshteve gjithëpërfshirës, nëpërmjet trajnimit të mësuesve dhe specialistëve të tjerë të edukimit si edhe mbështetjes materiale.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës është angazhuar në mbështetjen

e më shumë strukturave gjithëpërfshirëse të edukimit parashkollor për fëmijët me aftësi të kufizuara, nëpërmjet një projekti pilot në 12 rajone. *Save the Children* shpreson që ta mbështesë MASH në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë nismë.

Ndërhyrjet aktuale që po pilotohen nga *Save the Children* në partneritet me organizatën *Ndihmoni Jetën* këtu në Tiranë dhe MEDPAK në Librazhd, përfshijnë dy zona urbane dhe periferike të Shqipërisë. Një projekt i ngjashëm po vihet gjithashtu në zbatim në rrethin e Beratit me Drejtorinë Arsimore lokale.

Ne shpresojmë që këto nisma t'i ofrojnë qeverisë një udhëzues për zhvillimin e metodave gjithëpërfshirëse në programet arsimore në shkollë kombëtare dhe do të vazhdojmë të punojmë me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës në veçanti për ta zhvilluar këtë punë.

Miratimi i dispozitave normative nga qeveria, në dhjetor 2002, shënon një indikator të rëndësishëm në procesin e përmirësimit të kuadrit ligjor aktual për integrimin dhe përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme. Rishikime specifike mund t'u bëhen Dispozitave Normative për të krijuar mundësi me të mira për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ne mund të nxisim një rishikim të këtyre Dispozitave Normative.

Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara ka për qëllim të mbledhë së bashku shërbimet arsimore, shëndetësore dhe sociale dhe thekson arsimin gjithëpërfshirës si fokusin e ndërhyrjeve të ardhshme të qeverisë. Arsimi Gjithëpërfshirës, si koncept, është gjithashtu i njohur zyrtarisht në Strategjinë e Arsimit 2004 të Qeverisë.

Këto politika janë progresive në kuptimin që dëshmojnë për herë të parë parimet ndërkombëtare të drejtave të njeriut për përfshirjen e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e zakonshëm, përkundërt modeleve institucionale, të cilat janë përhapur në të gjithë rajonin dhe fatkeqësisht vazhdojnë edhe sot.

Megjithatë, ka një nevojë për t'u fokusuar në vënien në zbatim të këtyre politikave përmes programeve e angazhimeve dhe ngritjes së përgjithshme të kapaciteteve brenda ministrive dhe departamenteve përgjegjëse të qeverisë.

Çështjet që kanë të bëjnë me aftësinë e kufizuar në moshën e hershme janë në shumë raste të lidhura me identifikimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Siç shkruhet në Deklaratën për Veprim të Dakarit, për Arsimin

për të Gjithë, tërheqja e fëmijëve nga grupet e mënjanuara ka nevojë për mjete për të kërkuar në mënyrë aktive fëmijët e mënjanuar dhe përjashtuar dhe për t'iu përgjigjur nevojave të tyre në mënyrë elastike.

Identifikimi dhe ndërhyrja e hershme shpesh janë të kufizuara nga teknologjia dhe burimet ekonomike të një vendi. Përjasje të ndryshme janë, megjithatë, të realizueshme në fushën e ZHFH-së, që nga forcimi i shërbimeve këshillimore shtetërore ekzistuese deri te përjasjet me bazë komunitare në fushat që janë më në nevojë dhe ku shërbimet janë të varfra.

Nëse do të adresohet çështja e ndërhyrjeve të hershme, Qendra Kombëtare e Zhvillimit, Departamenti i Shëndetit Mendor, Grupi i Advokimit i ADRF dhe OJQ dhe organizata të tjera që merren me aftësinë e kufizuar duhet të bashkëpunojnë në mënyrë më efektive për të hartuar një sërë programesh për ndërhyrjen e hershme, duke bashkëndarë ekspertizën dhe trajnimet. Megjithatë, trajnimet kompetente në metodologjitë dhe praktikat që lidhen me aftësinë e kufizuar duhet të forcohen.

Ka, pa dyshim, pengesa të konsiderueshme dhe sfiduese, me të cilat duhet të përballemi dhe këto pengesa mund të kapërcehen vetëm nëpërmjet një përpjekjeje të përbashkët nga ana e Qeverisë, OJQ-ve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe agjencive ndërkombëtare, prindërve dhe komuniteteve.

Megjithatë, qëllimi i sigurimit të arsimit cilësor gjithëpërfshirës duhet të jetë një përparësi në kontekstin e gjerë të arritjes së një shoqërie të drejtë dhe të begatë. Pavarësisht se ende nuk është përcaktuar zgjidhja më e mirë për ndryshimet në arsim, ne biem dakord për disa hapa të cilët do të nevojitet të ndërmerren.

Për ta përfunduar, është e rëndësishme të përmendet mesazhi i Deklaratës së mirënjohur të Salamankës dhe i Kuadrit për Veprim të 1994-s:

Shkollat e zakonshme me arsim gjithëpërfshirës janë mjetet më efektive në luftën kundër diskriminimit, krijimin e komuniteteve mirëpritëse, ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe arritjen e arsimit për të gjithë.

FJALA E MBAJTUR NGA PËRFAQËSUESJA E UNICEF-it

Mirëmëngjesi

të nderuar, Kryetare e Parlamentit, znj. Topalli; zv/kryeministër, z. Rusmajli; Avokati i Popullit, z. Dobjani; të nderuar ministra, të ftuar, zonja dhe zotërinj!

Ju faleminderit që keni ftuar UNICEF-in të jetë një pjesë e Konferencës së sotme si një bashkësponsor.

Kjo temë përbën një kuptim të veçantë për mua, pasi përpara se të punoja për UNICEF-in kam punuar për fëmijët me kërkesa të veçanta. Ajo çfarë kam mësuar nga kjo eksperiencë është se nuk ka fëmijë me aftësi të kufizuar, por pak-a-shumë të gjithë fëmijët kanë aftësi të ndryshme. Është obligimi i shtetit që t'i pajisë të gjithë fëmijët e vet me mundësitë e nevojshme që ata të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë. Qeveria e Shqipërisë, si nënshkruese e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, u ka premtuar fëmijëve shqiptarë se do të punojë për të përmbushur të drejtat e tyre.

Fëmijët me aftësi të kufizuar janë fëmijët më të marxhinalizuar. Të lënë pas dore vazhdimisht nga vendimmarrësit, ekonomistët, shërbimdhënësit dhe media, ata përballen me diskriminimin, u mohohen shërbimet më të thjeshta të cilat u takojnë dhe janë veçanërisht vulnerabël ndaj abuzimit, dhunës, shfrytëzimit dhe sidës.

Në gusht 2006, pas 5 vjet negociatash, delegatë nga 193 vende anëtare të Kombeve të Bashkuara ranë dakord për një traktat të ri në mbrojtje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Draft-Konventa për të Drejtat dhe Dinjitetin e Personave me Aftësi të Kufizuar, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme gjatë sesionit të saj në vitin 2006, është një arritje historike që i jep status, autoritet dhe largpamësi aftësisë së kufizuar si një çështje e të drejtave të njeriut. Kjo forcon dhe plotëson Konventën për të Drejtat e Fëmijëve.

Qëllimet e Zhvillimit të Mileniumit (QZhM) përcaktojnë një kuadër të njohur botërisht për arritjen e të drejtave themelore të njeriut. Bashkimi European, gjithashtu, ku Shqipëria inspiron të futet, është impenjuar për reduktimin e varfërisë sikurse është përcaktuar në QZhM dhe pranon që ky qëllim nuk mund të realizohet nëse nuk merren në konsideratë nevojat e njerëzve me aftësi të kufizuar.

Krijimi i Njësisë për të Drejtat e Njeriut, me sekretariatit teknik për fëmijët dhe sekretariatit teknik për njerëzit me aftësi të kufizuar, pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, janë shumë të mirëpritura.

Sikurse është thënë edhe më parë, në Shqipëri janë bërë hapa pozitivë, megjithatë shqetësimi mbetet për fëmijët me aftësi jashtë normales, të cilët nuk janë përgjithësisht të përfshirë në sistemin e edukimit ose janë fare të paarsimuar. Ka një mungesë burimi për ta, ata kanë një akses të limituar për kujdesin mjekësor, për shkollim apo shërbime të tjera që janë shumë thjesht të aseksueshme nga fëmijët e tjerë.

Shumë vende të tjera luftojnë për balancën midis realizimit të të drejtave të këtyre fëmijëve dhe vështirësisë për të arritur t'u jepen burimet e limituara të mundshme. Por kjo nuk përbën një zgjidhje, pasi është një obligim që shteti ka marrë përsipër. Duke realizuar të drejtat e fëmijëve me aftësi të ndryshme, jeta bëhet më e mirë për të gjithë. Për shembull, duke siguruar ndërtesa dhe vende publike të aksesueshme nga fëmijët dhe njerëz të tjerë me aftësi të kufizuar, duke ndërtuar dyer të gjera dhe të pjerrëta për të hyrë dhe dalë karriget me rrota, është më e thjeshtë që të gjithë njerëzit të kenë akses. Sa prindërve u është dashur të shtyjnë karroca fëmijësh rreth qytetit apo brenda ndërtesave? Në arsim, duke prezantuar metoda mësimdhënieje dhe materiale të përshtatshme për fëmijët me aftësi të ndryshme mësimmarjeje, sistemi përmirësohet për të gjithë.

Kohët e fundit kam takuar një grua e cila kishte pësuar një aksident automobilistik në vitin 1997. Ajo kish mbetur e paralizuar dhe e lidhur pas një karroce me rrota. Në diskutuam se si jeta e saj kishte ndryshuar, që nga koha e aksidentit, dhe ndërsa ajo e kishte

pranuar pak a shumë ndryshimin në aftësitë e saj, një nga frustracionet që ajo përjetonte ishte pamundësia e saj për të bërë një jetë të pavarur, për shkak të mundësive të limituara për të frekuentuar vende publike këtu në Shqipëri. Ajo nuk mund të lëvizë e pavarur jashtë shtëpisë së saj, për shkak të mungesës së vendeve të pjerrëta, hapësirës së dyerve apo të ashensorëve, që mundësojnë kalimin e karrocës me rrota. Kështu si kjo grua e re, shumë fëmijë përballen me jetën në varësi, pasi ata nuk kanë akses ndaj shërbimeve që do t'i mbështesnin ata të zhvillonin potencialin e tyre të plotë dhe t'u lejonte atyre të bënin një jetë të pavarur. Me qëllim që të ndihmojmë ëndrrën e kësaj gruaje të re për të jetuar e pavarur, sikurse dhe të drejtat e gjithë fëmijëve dhe njerëzve me aftësi të ndryshme, ne i drejtohemi Qeverisë së Shqipërisë të trajtojë me prioritet veprimet e mëposhtme:

- Të rishikojë politikat ekzistuese, praktikat dhe legjislacionin dhe ta zbatojë atë në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të gëzojnë të drejtat e tyre.

- Të sigurojë që të gjithë fëmijët të ushtrojnë të drejtën e tyre për arsimim dhe të lehtësojë përfshirjen e tyre në sistemin normal arsimor; të implementojë në mënyrë më specifike dhe me prioritet Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe rregullore të tjera për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

- Të bëjë përpjekje për të vënë në dispozicion burimet e domosdoshme profesionale dhe financiare, sidomos në nivel lokal dhe të promovojë e zgjerojë programin e rehabilitimit bazuar në komunitet, përfshirë grupet mbështetëse të prindërve.

- Të përmirësojë fushatat e ndërgjegjësimit të publikut që kontribuojnë në ndryshimin e qëndrimeve negative ekzistuese ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara. Një vëmendje e veçantë u duhet dhënë profesionistëve, të cilët këshillojnë dhe mbështesin prindërit (antidoti i një foshnje lindur me Sindromën Down, e braktisur nga prindërit e saj dhe e vendosur në një institucion. Mund të jetë shkak padituria e stafit mjekësor në përcaktimin e prognozës).

- Të mundësojë personat me aftësi të kufizuara të jetojnë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës. Në këtë këndvështrim, të marrë masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses në mënyrë të barabartë me të tjerët për të frekuentuar fizikisht mjediset, për transportin,

informacionin dhe komunikimin, përfshirë teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit si dhe lehtësira dhe shërbime të tjera të hapura për publikun, si në zonat urbane edhe në ato rurale. Këto masa duhet të aplikohen në ndërtime, rrugë, transport, në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, lehtësirat mjekësore dhe ato të vendit të punës; gjithashtu në lehtësirat për informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimin elektronik dhe atë të emergjencës.

UNICEF mbetet e gatshme t'i ofrojë Qeverisë së Shqipërisë bashkëpunimin e vet si dhe mbështetjen teknike për realizimin e të drejtave të të gjithë fëmijëve.

Faleminderit!

PËRSHËNDETJE PËR KONFERENCËN KOMBËTARE

Blerta ÇANI

Kryetare e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me
Aftësi të kufizuara

Të nderuar zotërinj ministra!

I nderuar z. Avokat i Popullit!

**Të nderuar përfaqësues të organizatave ndërkombëtare,
të nderuar miq!**

Më lejoni fillimisht të shpreh falënderimet e mia dhe Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, për mundësinë për të marrë pjesë dhe për të përshëndetur këtë ngjarje me të vërtetë të rëndësishme në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri.

Kam kënaqësinë të konstatoj se së fundmi nuk kanë qenë të rralla rastet kur shoqëria civile dhe institucionet përgjegjëse shtetërore gjenden së bashku në iniciativa në mbështetje të personave me aftësi të kufizuar dhe përmirësimit të cilësisë së jetës për ta.

Si përfaqësuese e njërës nga organizatat më të hershme dhe më aktive në sferën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, kam kënaqësinë të konstatoj se vëmendja që po i kushtohet respektimit të këtyre të drejtave, por dhe rëndësisë që ka sigurimi i kushteve për t'i ushtruar ato, ka nisur të jetë pjesë e një angazhimi parësor, jo vetëm të faktorëve të shoqërisë civile, por dhe e strukturave shtetërore shqiptare.

Në vitet e tranzicionit për Shqipërinë, garantimi, mbrojtja dhe respektimi i lirive dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuar ka qenë shpeshherë një mision i vështirë. Rritja e kapaciteteve integruese të këtij komuniteti, prania gjithmonë e më aktive e tyre në grupe të ndryshme sociale, interesi dhe vëmendja në rritje e mjaft aktorëve të rëndësishëm shtetërorë dhe civilë në mbështetjen e këtyre përpjekjeve, megjithatë ka kontribuar në shtimin e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuar në jetën e përditshme të shoqërisë

shqiptare, çka përbën mision e angazhimit dhe kontributit të FSHDPAK.

Janë bërë përpjekje serioze për të përmirësuar një realitet aspak premtues për jetën e përditshme dhe integrimin e atyre personave që përcjellin mesazhin e denjë për një komunitet qytetar të emancipuar: Jetën duhet ta jetojmë të gjithë njësoj. Një opinion rëndom indiferent ndaj njeriut në nevojë, karshi vuajtjes, vështirësive dhe mundimeve të shumta që po shoqërojnë shoqërinë shqiptare përgjatë këtij tranzicioni, ka nisur dalëngadalë të ndërgjegjësohet dhe të pranojë diku me ndrojtje e diku me guxim e kurajë, që pranë tij mund dhe duhet të qëndrojë si i barabartë fqinji, miku, i afërmi, vëllai, të cilit jeta apo natyra i ofroi një fat të vështirë.

Sot, ndodhur në këtë konferencë, mund të themi se në Shqipëri ka nisur të rritet shpresa se personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre, në përgjithësi shoqëria shqiptare do të mund të gjejnë te njëri-tjetri të barabartin, partnerin e ndërtimit të një jete më kuptimplote, të një jete më njerëzore.

Ju faleminderit!

“IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË SË PAK-UT, PAGESAT DHE SHËRBIMET PËR AFTËSINË E KUFIZUAR”

Kosta Barjaba

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të
Barabarta Drejtor i Kabinetit

I. TIPOLOGJIA E PAK-ut

- Aktualisht nga programet sociale me pagesë për aftësinë e kufizuar, kujdestari dhe shërbime rezidenciale trajtohen rreth 3% e popullsisë:

- Rreth 36 mijë invalidë pune;
- 10 mijë të verbër;
- Rreth 800 para e tetraplegjikë dhe
- 43 mijë PAK mendorë dhe fizikë etj.
- Këto kategori mbështeten me rreth 16 mijë kujdestarë.
- Në 6 qendra publike rezidenciale të përkujdesit trajtohen rreth 400 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe në tri qendra ditore rreth 70 fëmijë.
- Për këtë grup janë ngritur edhe shërbime nga OJF-të.

II. KUADRI LIGJOR

- Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Strategjia e Shërbimeve Sociale;
- Ligji nr. 9355 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”;
- Legjislacioni për sigurimet shoqërore;
- Ligji “Për statusin e invalidit të punës”;
- Ligji “Për statusin e të verbërve”;
- Ligji “Për statusin e invalidëve, para e tetraplegjikë etj.
- Në thelb të tyre qëndron një filozofi e re për trajtimin e PAK-ut, respektimin dhe realizimin e të drejtave të tyre si gjithë qytetarët e tjerë dhe krijimin e mundësive konkrete për integrim;

III. KUADRI I POLITIKAVE:

Strategjia Kombëtare e PAK-ut

- Strategjia është ribotuar dy herë në bashkëpunim me OSBE-në;
- Dokumenti i ribotuar është rishpërndare në të gjithë aktorët zbatues;
- Ai përmban Strategjinë, Planin e Veprimit dhe prioritetet e vitit 2006;
- Dokumenti njihet nga çdo ministri dhe strukturat rajonale të ministrive të linjës;
- Qarqet, bashkitë dhe komunat;
- Sekretariati Teknik i PAK-ut po përgatit objektivat e vitit 2007 për të gjitha ministrinë e linjës dhe strukturat vendore.

IV. KUADRI INSTITUCIONAL

- U ngrit Sekretariati Teknik i PAK-ut, me tre punonjës, me urdhër të Kryeministrit, pranë Drejtorisë së Shanseve të Barabarta, në MPCSSH;B;
- Sekretariati, nëpërmjet pikave të kontaktit, do monitorojë zbatimin e Strategjisë nga institucionet që ngarkohen me detyra prej saj, ministrinë e linjës dhe strukturat e varësisë, njësitë e qeverisjes vendore, qarqet / bashkitë / komunat;
- Pikat e kontaktit po mbështeten dhe trajnohen për të përcjellë informacion për zbatimin e Strategjisë së PAK-ut, bazuar në treguesit e monitorimit.

V. PROBLEMATIKA TË IMPLEMENTIMIT

5.1. Raporte të reja midis pagesave në *kesh* dhe shërbimeve

Sistemi i pagesave për personat me aftësi të kufizuara po reformohet tërësisht, bazuar në ligjin nr. 9355 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

- Reforma, krahas pagesave, me përparësi trajton edhe shërbimet sociale, si faktorë që plotësojnë një pjesë të konsiderueshme të nevojave të PAK-ut dhe mundësojnë integrimin dhe përfshirjen e tyre në shoqëri.

- Mbështetje për familjet e PAK-ut, për të plotësuar nevojat e PAK-ut në familjen, njësinë sociale bazë.

V. PROBLEMATIKA TË IMPLEMENTIMIT

5.2. Zbatimi i legjislacionit

Legjislacioni dytësor në zbatim të ligjit:

- Në zbatim të ligjit janë miratuar VKM dhe Udhëzimet e ministrit për 28 nene që përcaktojnë detyrimin për akte nënligjore;
- 98% e detyrimeve që rrjedhin nga ligji po implementohet;
- Për vitin 2006, u vunë në dispozicion 16% më shumë fonde buxhetore për PAK-un, se një vit më parë ose
 - 6.1 miliardë lekë për pagesën e PAK-ut, për të verbrit, për invalidët para dhe tetraplegjikë dhe PAK mendorë e fizikë;
 - 1 miliard lekë për invalidët e punës, si dhe
 - 485 milionë lekë për shërbimet rezidenciale
- Për vitin 2007, janë programuar rreth 8.1 miliardë lekë për PAK-un.

V. PROBLEMATIKA TË IMPLEMENTIMIT

5.3. Mobilizimi i më shumë burimeve financiare

- PAK do të përfitojnë një pagesë për aftësinë e kufizuar, pavarësisht nga mosha e dëmtimit. Hiqet kufiri i moshës deri në 21 vjeç.

- PAK, që sipas vendimit të KMCAP kanë nevojë për shërbimin e një kujdestari, u lind e drejta për një kujdestar me pagesë, edhe në rastet kur familja nuk është në skemën e NE.

- Për invalidët para dhe tetraplegjikë, zgjerohet sfera e përfitimit edhe për persona që janë bërë të tillë jo vetëm si pasojë e dëmtimeve të shtyllës kurrizore, por edhe nga shkaqe të tjera që vijnë nga dëmtimet në kokë.

- Po rishikohen kriteret e komisionimit për të gjitha kategoritë e PAK-ut, për të rritur kontrollin dhe përjashtimin e rasteve abuzive.

V. PROBLEMATIKA TË IMPLEMENTIMIT

5.4. Rritje e masës së pagesave në kesh

- Pagesa e aftësisë së kufizuar, për të gjitha grupet bëhet 80\$ nga 68 \$ që ka qenë;

- Pagesa e PAK-ut dhe kujdestaria rriten çdo vit mbi bazën e indeksimit vjetor të pagës minimale;

- Pagesa e kujdestarisë për të verbrit dhe para tetraplegjikët bëhet 80\$ nga 68 \$;

- Kujdestaria e PAK mendorë dhe fizikë unifikohet me kujdestarinë e të tjerëve dhe bëhet 80 \$ nga 50 \$ që ka qenë;

- Përcaktohet masa e kujdestarisë 150% për familjet me më shumë se një PAK;

- Mbështetje nga buxheti për Shoqatat Kombëtare të aftësisë së kufizuar dhe për Shoqatën e të Verbërve, për ndërtimin e Qendrës Rehabilituese.

V. PROBLEMATIKA TË IMPLEMENTIMIT

5.5. Rritja e aksesit në arsimin nëpërmjet incentivave financiare

- Nxënësit me aftësi të kufizuara që vazhdojnë shkollën e mesme, përfitojnë 16 500 lekë në muaj, nga 13 600 lekë që ishte me parë;

- Studentët me aftësi të kufizuara, përfitojnë 24 800 lekë në muaj nga 20 400 që ishte më parë.

- Ministria e Arsimit, me një Vendim për kuotat dytësore, përjashton nga pagesa e taksave studentët para tetraplegjikë.

- Familjet me persona me aftësi të kufizuara përfitojnë 500 lekë në muaj, për rimbursimin e çmimit të energjisë.

V. PROBLEMATIKA TË IMPLEMENTIMIT

5.6. Masa plotësuese në proces

- Rimbursimi i shpenzimeve për materialet higjieno-sanitare për para tetraplegjikët (është ndryshuar ligji, P-VKM në proces);

- Përfshirja e personave të prekur nga Hiv AIDS, në skemën e aftësisë së kufizuar; (në proces rishikimi i kritereve mjekësore)

- Rritje e masës së karburantit për PAK, që janë invalidë pune; (në proces diskutimi)

- Përfitimi nga invalidët e punës me sëmundje profesionale i një shtese për aftësinë e kufizuar, pavarësisht nga pagesat e sistemit të sigurimeve shoqërore (në proces).

VI. PERSPEKTIVA

- Fuqizimi i strukturave implementuese dhe roli i ri i tyre në qendër dhe në nivel vendor;

- Rritja e pjesëmarrjes së pushtetit vendor dhe shoqërisë civile në ofrimin e shërbime;

- Decentralizimi i shërbimeve rezidenciale;

- De-institucionalizimi i shërbimeve rezidenciale;

- Qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e tyre;

- Garantimi i cilësisë së shërbimeve (standardet, licencimi dhe inspektimi);

- Vlerësimi i nevojave dhe planifikimi komunitar;

- Trajnimi dhe zhvillimi i stafit.

VII. SFIDAT E DECENTRALIZIMIT

7.1. Rritja e kompetencave të qeverisjes vendore

- Njësitë vendore marrin përgjegjësi për të vlerësuar nevojat sociale të qytetarëve dhe për të ngritur shërbime në përputhje me to.
- Bashkitë, komunat me fonde nga buxheti i shtetit dhe me fonde nga taksat lokale do të ngrenë shërbime edhe për personat me aftësi të kufizuara ose do të mbështesin financiarisht shërbimet ekzistuese.
- Për të ndihmuar bashkitë, komunat me më pak të ardhura, do të krijohet Fondi Social.
- Fondi Social do të sigurojë qëndrueshmërinë e shërbimeve të nevojshme dhe do të mbështesë iniciativat e reja në fushën e kujdesit social.

VII. SFIDAT E DECENTRALIZIMIT

7.2. Decentralizimi i shërbimeve sociale

- 26 qendrat rezidenciale të shërbimeve për fëmijë jetimë, fëmijë me aftësi të kufizuara dhe të moshuar, do të transferohen në varësi të njësisve vendore, ku janë të vendosura.
- Edhe shërbimet publike për PAK-un, në 6 qendra rezidenciale zhvillimi dhe në 3 qendra ditore, do të decentralizohen.
- Gjatë vitit 2006, me Vendim të KM po kalojnë 12 institucione, duke përfshirë edhe Qendrën e Zhvillimit të Fëmijëve në Tiranë.
- Transferimi i shërbimeve do të përfundojë në vitin 2008.
- Transferimi i institucioneve shoqërohet me kalimin e shërbimeve, kompetencave dhe fondeve të nevojshme për mbajtjen e tyre, si dhe me rregulla dhe përgjegjësi të reja për bashkitë për menaxhimin e shërbimeve pa ndryshuar destinacion dhe pa prekur asetet e sistemit të shërbimeve sociale.

VII. SFIDAT E DECENTRALIZIMIT

7.3. Pasurimi i rrjetit dhe tipologjive të shërbimeve

- Ngritja e shërbimeve të reja në komunitet, mbështetur nga projekti i Bankës Botërore.
- Ka filluar ofrimi i shërbimeve në 17 qendrat sociale, ditore në komunitet për fëmijët, të rinjtë, për personat me aftësi të kufizuara, vajzat dhe gratë në nevojë, për të moshuarit në qarqet Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë;
 - Një treta e këtyre shërbimeve janë për PAK;
 - Për PAK po ngrihen shërbime ditore në: Tiranë, Berat (ASED),

Vlorë dhe pranë Qendrave të Zhvillimit.

- Këto do t'u shtohen shërbimeve jo publike, të OJF-ve, që aktualisht ofrohen në 5 qendra rezidenciale dhe në 20 qendra ditore;

- Kanë filluar punimet për ngritjen dhe rikonstrukcionin e objekteve për 27 shërbime të tjera komunitare.

- 8 shërbime do të jenë për PAK, në Durrës, Gjirokastër, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Kukës.

- Shërbimet sociale komunitare do të mbulojnë 2/3 e territorit të vendit.

VII. SFIDAT E DECENTRALIZIMIT

7.4. Deinstitucionalizimi

Procesi i deinstitucionalizimit ka si qëllim lëvizjen e përfituesve të shërbimeve rezidenciale në alternativa të tjera shërbimesh si shtëpitë-familje, jetesë gjysmë e pavarur, apartamente të mbrojtura etj.

- Me fëmijë të Qendrës së Zhvillimit Shkodër, Shoqata “Projekti Shpresa” ka ngritur 6 shtëpi familje, me atelie pune dhe veprimtari të tjera riintegruese, ku trajtohen 54 fëmijë.

- Ky model financohet nga burime të shoqatës dhe fonde të buxhetit të shtetit.

- Në Berat, së bashku me ASED, po ngrihet qendra LIRA, e cila do të themelojë modelin komplementar të shërbimeve komunitare, që synojnë jetesën e pavarur të personave me aftësi të kufizuara.

VIII. RITJIA E PROFESIONALIZMIT DHE KUJDESIT TË SPECIALIZUAR

- Njësia e Pedagogjisë së Specializuar pranë Universitetit të Vlorës këtë vit ka diplomuar rreth 25 edukatorë të specializuar.

- Kjo shkollë është mbështetur me financime dhe asistencë teknike nga Qeveria Zvicerane, nëpërmjet Shoqatës ASED, e cila ka investuar për ngritjen e kapaciteteve humane dhe përmirësimin e infrastrukturës së qendrave të zhvillimit për fëmijët me aftësi të kufizuara.

- Ministria e Punës po punon për sistemimin e këtyre profesionistëve në shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, për të përmirësuar cilësinë e këtyre shërbimeve.

IX. STANDARDET E: INOVACION NË SHËRBIMET PËR PAK

- Përfundoi procesi i hartimit të standardeve dhe rregullave për shërbimet sociale për grupet e ndryshme në nevojë.

Janë hartuar dhe miratuar:

- Standardet e përgjithshme të shërbimeve shoqërore.

- Standardet e fëmijëve në qendra rezidenciale

- Standardet për shërbimet e të moshuarve

- Sapo u miratuan nga Qeveria edhe **standardet e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.**

- Këto standarde garantojnë cilësinë e shërbimeve dhe mbrojtjen e të drejtave dhe integrimin e përfituesve të tyre.

- Ato janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë ofruesit publikë dhe jopublikë.

X. LICENCIMI DHE MONITORIMI

- Në bazë të ligjit dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave, ka filluar procesi i licencimit.

- Janë licencuar 55 OJF-të e para dhe po vazhdon procesi për licencimin e të gjithë operatorëve që ofrojnë shërbime, duke përfshirë edhe shërbimet për PAK.

- Inspektimi

Është ngritur Inspektoriati i shërbimeve sociale dhe VKM Nr. 512 dt 31.05.2006 përcakton metodologjinë e kontrollit të shpërndarjes së pagesave në *Kesh* dhe të inspektimit të shërbimeve sociale që ofrohen nga operatorët publikë e privatë.

- Trajnimi dhe rritjen e kapaciteteve

Brenda strukturës së SHSSH është ngritur njësi për trajnimin e punonjësve të angazhuar në strukturat sociale në nivel qendror dhe vendor.

XI. INFORMACIONI SI INSTRUMENT I MONITORIMIT

- VKM 617 dt 07.09.2006 përcakton sistemin e treguesve që do të mblidhen për ndihmën ekonomike, për PAK dhe për shërbimet sociale.

- Udhëzimi i ministrit të Punës, për statistikat do të fillojë të zbatohet nga janari i vitit të ardhshëm.

- Informacioni për PAK, përveç të tjerash, do të fokusohet në:

- të dhëna sipas llojit të AK dhe shkallës së saj;
 - sipas masës së përfitimit të pagesës;
 - sipas grupmoshës;
 - sipas gjinisë;
 - vazhdimit të arsimimit etj.
- Njësitë vendore mbledhin informacion dhe raportojnë në strukturat eprore sipas një kalendari të veçantë.
- Ky informacion do të analizohet dhe do të shërbejë si bazë për ndërmarrjen e politikave të reja për PAK-un.

Ju faleminderit!

E DREJTA E PËRFAQËSIMIT TË PAK-ut, RËNDËSIA E ORGANIZIMIT TË TYRE DHE ROLI I ORGANIZATAVE KOMBËTARE TË PAK-ut

Prof. Sinan Tafaj

Kryetar i Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë dhe kryetar i
Këshillit Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuar

I nderuar z. Avokat i Popullit!

Të nderuar pjesëmarrës!

Më lejoni që, që në fillim, të falënderoj për zemërsisht Avokatin e Popullit për këtë iniciativë me vlera të veçanta që ai ka ndërmarrë.

Në këtë referat do të përpiqem të pasqyroj pikëpamjet e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë lidhur me temën “**E drejta e përfaqësimit, rëndësia e organizimit dhe roli i organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar**”.

Aftësia e kufizuar e vendos mbartësin e saj në një status të ndryshëm social-ekonomik nga ata që nuk janë mbartës të këtij kufizimi.

Që nga ky moment gëzimi i të drejtave dhe ushtrimi i tyre nga PAK-u bëhet i ndryshëm nga ajo çka ne mund të quajmë normale. Për arsye objektive dhe subjektive PAK-u vendoset në pozitë të disfavorshme për njohjen dhe ushtrimin e të drejtave që gëzon çdo qytetar. Praktika botërore si edhe ajo e vendit tonë kanë vërtetuar se, për reduktimin e pasojave të aftësisë së kufizuar, për krijimin e shanseve për t’u integruar dhe për të përmirësuar jetën ekonomike dhe shoqërore, shteti dhe qeveria miratojnë një seri normash dhe aktesh komplementare.

Ato udhëhiqen nga diskriminimi pozitiv, duke krijuar nëpërmjet tyre hapësira shoqërore dhe ekonomike ku PAK-u mund të lëvizë e të përpiqet për përmirësimin e jetës së tij, duke reduktuar pasojat e kufizimeve.

Ky grup normash dhe rregullash të reja me karakter të posaçëm janë jetet të rëndësishme, pasi PAK-ut i ofrohen shërbime të

ndryshme dhe i garantohet një standard social-ekonomik i pranueshëm.

Megjithatë, në këndvështrimin tonë **problemi i parë** është përcaktimi i atyre politikave që materializohen pikërisht me këtë grup normash.

Problemi i dytë është mënyra e rregullimit dhe zgjidhjes së problemeve të PAK-ut me anë të këtyre normave.

Pra, çështja shtrohet: Cilat janë fushat me përparësi të ndërhyrjes të PAK dhe si duhen rregulluar ato? Cili është raporti në mes këtyre normave të posaçme me normat dhe parimet e përgjithshme?

Ku fillon diskriminimi real i PAK-ut nëpërmjet këtyre normave?

Cilat fusha, apo probleme të PAK-ut mbeten të paprekura dhe të parregulluara dhe sa të rëndësishme janë ato? Sa ndihmojnë apo pengojnë këto norma të posaçme në realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut? A bëhen vërtet pengesë në momente të caktuara në zbatimin e tyre?

Të nderuar pjesëmarrës!

Siç shihet, grupi i normave të posaçme ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për PAK-un dhe përgjigjja apo përcaktimi i këtyre qëndrimeve nuk është i thjeshtë. Kjo bëhet akoma më e komplikuar kur këto përcaktime apo përgjigje synohen të jepen nga individë jashtë PAK-ut.

Pra, persona jashtë PAK-ut marrin përgjegjësinë për të përcaktuar se çfarë është e rëndësishme apo e parëndësishme në jetë e PAK-ut?!

Pra, cilat janë nevojat e PAK-ut? Për çfarë lloj shërbimesh ka nevojë PAK-u? Kur dhe si duhen bërë ato shërbime?

Pra, këta individë apo organizata marrin përsipër që të përfaqësojnë PAK-un, duke vlerësuar nevojat dhe interesat e tij. Kjo praktikë është tejet e papranueshme dhe, pse jo, e dëmshme dhe e rrezikshme për PAK-un.

Së pari: në rrethanat aktuale dhe standardet shoqërore të qytetarëve shqiptarë, që krijojnë organizata, fondacione apo qendra për PAK-un, mund të hidhen me të drejtë dyshime mbi motivet e ndërmarrjes së këtyre iniciativave.

Janë të njohura praktikat në vende të tjera të zhvilluara dhe të pasura, ku njerëz me pasuri të konsiderueshme krijojnë fondacione me anë të të cilave realizojnë pikëpamjet, dëshirat apo sentimentet e tyre në dobi të personave në nevojë.

Të paktën në vendin tonë nuk kemi dëgjuar që ndonjë qytetar shqiptar të ketë vënë në themel të ndonjë fondacioni apo ndonjë qendre të ardhurat apo pasurinë e tij, të cilat kanë gjeneruar veprimtarinë e tyre.

Atëherë shtrohet pyetja:

Këta qytetarë të zellshëm, që janë në gjendje të përlohen e të përбетohen se mbrojnë interesat tona, si i mbrojnë interesat e tyre në këto organizata jofitimprurëse?

A duhet të jemi kaq naivë sa të besojmë se interesat tona janë prioritare në raport me interesat e tyre?

Si duhet të bindemi që përfaqësimi i të drejtave dhe interesave tona është real dhe i mundshëm edhe kur është në dëm të interesave të tyre?

Të nderuar pjesëmarrës!

Unë ju kërkoj ndjesë të gjithë atyre që mund të ndihen keq nga kjo mënyrë kaq e sinqertë e pozimit të problemit. Unë nuk dua të inicioj asnjë konflikt me askënd, por gjithë sa them më sipër do të përpiqem ta ilustroj nga praktika e derisotme.

Harmonizimi esencial dhe formal i interesave është një proces mjaft i vështirë edhe brenda komuniteteve më të qëndrueshme, madje edhe qelizës më të shëndetshme të shoqërisë siç është familja.

Dihet tashmë se PAK nuk mund të mbrojë të drejta të rëndësishme, interesa themelore apo të përfitojë shërbime të qenësishme në mënyrë individuale. Sigurisht kjo është për arsye praktike të njohura, siç është numri i madh i tyre, shumëllojshmëria dhe vështirësitë e tjera pse jo edhe objektive në të cilat kalon shoqëria jonë. E vetnja mundësi që PAK-u të mbrojë të drejtat dhe interesat e veta është forcimi i lëvizjes së personave me aftësi të kufizuar dhe krijimi i organizatave kombëtare partnere me shtetin.

Por cili është realiteti i sotëm shqiptar?

E vërteta është se PAK-u që në ditët e para të demokracisë ka qenë tepër aktiv në përpjekjet e tij për mbrojtjen e interesave, ku shembull i qartë është Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë e krijuar më 8 janar 1991, në më pak se një muaj pas Partisë Demokratike, Shoqata e Invalidëve të Punës krijuar po më 1991, Shoqata në Ndihmë të Handikapatëve Mendorë, po më 1991 etj.

Përpjekjet e këtyre organizatave dhe të të tjerave kanë qenë të mahnitshme dhe sigurisht janë shoqëruar me rezultate pozitive. Megjithatë shtrohet pyetja: A kanë qenë ato dhe a janë përfaqësuese

reale të të drejtave dhe interesave të anëtarëve të tyre? Pa frikë mund të themi: po!

Po cilat janë problemet në të drejtën e përfaqësimit?

Ju kërkoj ndjesë të gjithë pjesëmarrësve, por më duhet të them se njëri ndër problemet më të mëdha, që organizatat kombëtare të PAK-ut ndeshen, është rivaliteti i pandershëm që një numër i vogël i organizatave të krijuar për PAK-un u bëjnë atyre. P.sh.: prej afro 10 vjetësh ka fondacione pa anëtarë, që në mënyrë absurde janë përpjekur të marrin rolin e ombrellës për të përfaqësuar PAK-un. Ato nuk lënë rast e vend pa folur për PAK-un, ata nuk lënë projekt të bjerë në tokë, pra ku ka para dhe interesa janë më të shkathtit dhe më të zotët.

Sigurisht ata janë të zotë të sigurojnë edhe mbështetjen e politikës dhe të administratës publike. Unë nuk dua të akuzoj askënd në mënyrë të drejtpërdrejtë, por edhe dështimeve të kategorive të caktuara të PAK-ut për t'u organizuar dhe ngritur në nivel kombëtar, u kanë kontribuar kjo filozofi dhe kjo natyrë përpjekjesh. Megjithëse këta persona, qoftë të këtyre organizatave të shkathëta qoftë të administratës publike, e dinë shumë mirë zgjidhjen që këtij problemi i është dhënë në vendet perëndimore, ata jo vetëm që nuk e përmendin, por janë edhe të gatshëm ta mohojnë atë.

Po t'i referohemi legjislacioneve perëndimore, si p.sh. në Itali, Spanjë, Britani etj. konstatohet lehtë se shteti vendos marrëdhënie partneriteti me një organizatë kombëtare sipas llojit të aftësisë së kufizuar. P.sh.: në ligjin ONLUS të vitit 1976 në Itali, kur *Unione Italiana dei Cieci* nga një Ent Publik u shndërrua në një organizatë Ent Moral Privat, iu rikonfirmua e drejta e përfaqësimit të të gjithë qytetarëve të verbër italianë dhe përparësia në ofrimin e shërbimeve.

Po të ecim më tej, në Spanjë shteti jo vetëm që u ka njohur të drejtën ekskluzive të përfaqësimit, por këtë të drejtë e ka shtrirë edhe në fushën e shërbimeve dhe të trajtimit social-ekonomik, ku të verbrit trajtohen në një skemë të veçantë të administruar nga ONCE.

Por çfarë ndodh te ne?

Të krijohet përshtypja sikur organizatave kombëtare të PAK-ut u është shpallur luftë, luftë e cila bëhet në emër të barazisë para ligjit dhe në emër të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore. Pra, pozicion i qartë dhe i thjeshtë. Organizata të krijuara për ne, nga individë jashtë nesh, kanë dhimbje të madhe nga shkëlja e të

drejtave që ne i bëkemi vetvetes.

Në botimet publike shkohet deri në absurditet, ku thuhet se të verbërve kujdestari duhet t'u caktohet nga gjykata. Do të ishte më e thjeshtë sikur kjo të shpjegohej me naivitet profesional, ku shoqëruesi (kujdestari) i të verbrit barazohet me kujdestarin në konceptin e Kodit të Familjes për personat që u hiqet zotësia për të vepruar.

Por nuk mendoj kështu, pasi qëllimi indirekt është që të aludohet se të verbrit janë pak-a-shumë me të njëjtat probleme si ata që u kufizohet zotësia për të vepruar për sa i përket mundësive dhe shanseve për të menaxhuar vetveten dhe të drejtat e tyre. Pra, në këtë logjikë do të thotë se të verbrit nuk janë në gjendje që të marrin përsipër përgjegjësi për veten e tyre dhe ca më pak të kujdesen për shokët e tyre nëpërmjet organizatës së tyre.

Agresiv ka qenë qëndrimi edhe ndaj Organizatës së Invalidëve të Punës, ku në mënyrë të zellshme nga organizata apo individë, madje edhe jashtë ministrisë, u punua për të bindur ministrin për kufizimin e përdorimit të librezës së invaliditetit në marrjen e ndihmës ekonomike, gjë e cila u arrit nëpërmjet një udhëzimi të paligjshëm.

Një formë tjetër e agresivitetit ndaj organizatave kombëtare të PAK-ut është edhe sulmi i fuqishëm mbi partneritetin e tyre me shtetin, pasi këtu është edhe thelbi i përfaqësimit të të drejtave dhe interesave të PAK-ut.

Janë bërë dhe po bëhen të gjitha përpjekjet për shfuqizimin e nenit 4 të Statusit të Invalidit të Punës, sipas të cilit Shoqata e Invalidëve të Punës lëshon dëshminë zyrtare të invaliditetit. As në këtë nen dhe as në ndonjë nen tjetër nuk thuhet që kjo dëshmi u jepet vetëm anëtarëve, përkundrazi në këtë rast ShIP-së i është dhënë kompetenca e një agjencie për ushtrimin e një funksioni.

Shembuj të tillë ka plot, ku individë, kompani, e ca më shumë organizata jo fitimprurëse ndërtojnë partneritet me shtetin. Kështu, në Kodin Doganor partnere të shtetit janë agjencitë private, në legjislacionin mbi sistemin e taksave janë agjentët tatimorë etj. Pra, pa qenë nevoja t'u referohemi shembujve konkretë jashtë vendit, kemi analogji të pastra brenda vendit.

Por përse konsiderohet agresiv ky qëndrim ndaj ShIP-së?

Është i tillë pasi manipulohet me interpretimin e shtrembër, duke u përpjekur të bindë Parlamentin dhe Qeverinë se krijohen diferenca

në përfitimin e invalidëve, se marrja e dëshmisë zyrtare të invaliditetit i detyron ata të jenë anëtarë. Ky nuk është vetëm një shtrembërim, por është një manipulim dhe falsifikim keqdashës.

Le të shtyhem më tej në rastin e nenit 13 të ligjit “Për statusin e të verbërit”. Çfarë thuhet në këtë nen?

Citojmë: “Shteti mbron dhe përkrah Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë.

Ai i njej asaj rolin aktiv në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve, duke e trajtuar si palë konsultative në hartimin e ligjeve e akteve nënligjore, si dhe zgjidhjen e problemeve të të verbërve.

Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim.

Shteti vë në dispozicion të Shoqatës së të Verbërve mjedise pune në qendër dhe në rrethe, të cilat ua jep në përdorim.”

Shtrohet pyetja:

A duhet shteti ta mbrojë dhe ta përkrahë ShVSh-në?

A duhet t’ia njohë rolin aktiv në mbrojtjen e interesave të të verbërve?

A duhet ta trajtojë si palë konsultative në çështjen e të drejtave të tyre?

Në botimet publike të fondacioneve që pretendojnë se mbrojnë të drejtat tona apo individëve të zellshëm që duan të na përfaqësojnë, thuhet se kjo dispozitë duhet të shfuqizohet si antikushtetuese.

Pra, mbrojtja dhe përkrahja e ShVSh-së, roli i saj aktiv dhe konsultativ, partneriteti me shtetin na qenkan antikushtetuese dhe se shkelka liritë dhe të drejtat e njeriut, duke shtypur të drejtat e anëtarëve të saj. Pra, ShVSh-ja që nga krijimi i saj nuk paska bërë gjë tjetër veçse paska shkelur të drejtat e anëtarëve të saj. Këto janë manipulime të neveritshme dhe thellësisht keqdashëse.

Unë pyes:

Kush u përpoq të luftojë për arritjen e standardeve aktuale të cilat gëzojnë sot të verbërit? Kush i hartoi politikën, draft-ligjet dhe aktet nënligjore? Kush i inicioi ato? Kush është në pararojë të mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave të të verbërve? Kush po e kryen ekspertizën dhe kush po ofron shërbime të specializuara?

Përgjigjja është e qartë:

Vetë komuniteti i të verbërve, i organizuar dhe i përfaqësuar në përputhje të plotë me vullnetin jo të çdo anëtar, por të çdo qytetari

të verbër.

Filozofia paternaliste është filozofia më e përshtatshme për krijimin e terreneve abuzive, përkundrazi filozofia e partneritetit është ajo që i kufizon ato mundësi.

Me keqardhje e themi se përfaqësimi i PAK-ut në institucionet shtetërore është ende larg asaj që pretendohet dhe që përcaktohet nga akte të ndryshme normative. Në pozicione të caktuara shtetërore, borde apo funksione, janë përcaktuar individë që nuk përfaqësojnë komunitetin e PAK-ut, as organizata të kategorive të veçanta. Ca më keq në Këshillin Kombëtar Ndërdikasterial të kryesuar nga zv.kryeministri, nuk i është dhënë e drejta e përfaqësimit komunitetit të Shurdhmemecëve me anë të Shoqatës së tyre, komunitetit të prindërve të handikapatëve mendorë, përkundrazi ka prirje të vendosen organizata, fondacione apo qendra që punojnë për PAK-un. Kjo është një tjetër sfidë me të cilën ne do të përballemi në të ardhmen.

Përveç agresivitetit të drejtpërdrejt politik ndaj organizatave kombëtare të PAK-ut ka edhe forma të tjera të luftës ndaj tyre, si p.sh. përdorimi i mekanizmit më efikas dhe të përbotshëm, përçarjes.

Por si motivohet dhe realizohet kjo përçarje?

Së pari: përpjekjet për të zbuluar elementë opozitarë brenda organizatës, motivimi dhe përkëdhelja e tyre.

Së dyti: mbështetja e fortë e fraksioneve dhe motivimi i tyre për krijimin e organizatave të pavarura.

Së treti: hiperbolizimi i ankesave të individëve të veçantë lidhur me zgjerimin e gamës së të drejtave të tyre.

Është e çuditshme, pasi kur individë të veçantë janë të pakënaqur me privilegjet që gëzojnë, motivohen për të kërkuar më shumë, duke e konsideruar si një shkelje të të drejtave të tyre dhe si një paaftësi të organizatës së tyre për t'i mbrojtur ato. Mirëpo ndodh krejt ndryshe kur këta përlo të ndodhen në tryeza qeveritare në debatet mes organizatave kombëtare dhe përfaqësuesve të Qeverisë dhe administratës publike. Aty marrin krahun e Qeverisë dhe janë të pakursyer në elozhe dhe komplimente për punën dhe sakrificat e mëdha që Qeveria po bën për PAK-un dhe çuditërisht ky qëndrim është i njëjtë në çdo Qeveri.

Një formë tjetër e rezistencës që i bëhet organizatave kombëtare nga individë apo organizata të lartpërmendura është dhe dhënia e rekomandimeve në zgjidhjen e problemeve themelore të PAK-ut.

Rekomandimet e tyre në mjaft raste bazohen në përkthime joprofionale të marra nëpër internet apo nga bashkëpunime me organizata me linja të ngushta. Shpeshherë këto rekomandime ide, apo deri filozofi, janë të ndërtuara me fjalë dhe fjali të komplikuar dhe deri dhe të pakuptimta. Kështu, ata marrin përsipër rolin e ekspertit dhe kur administrata nuk është në gjendje të përballojë me kompetencë rekomandimet e tyre bëhen pjesë e politikave të administratës dhe për pasojë ata shndërrohen në përfaqësues të interesave tona.

Të nderuar pjesëmarrës!

Unë ju lutem juve që më kuptoni drejt për gjithçka që kam thënë deri tani, pasi gabimisht mund të krijohet ideja sikur organizata e të verbërve është aq autarkike sa nuk dëshiron asnjëlloj bashkëpunimi, marrëveshje apo mbështetje nga jombartësit e aftësisë së kufizuar apo organizatat e tjera. Unë dua t'ju siguroj se është krejt e kundërta. Ne jo vetëm e duam bashkëpunimin me ta, por dhe kemi shumë nevojë për mbështetjen e tyre. Ne jemi të bindur se pa mirëkuptimin dhe mbështetjen e shoqërisë të verbrit do të mbeteshin të izoluar dhe të përjashtuar jo vetëm nga realiteti shoqëror por dhe ai natyror.

Çfarë do të donim ne?

Ne do të donim që t'u afroheshim këtyre individëve dhe organizatave, dhe të na afroheshin për të ndërtuar një bashkëpunim konstruktiv në themel të të cilit të qëndrojë mbrojtja e interesave social-ekonomike të qytetarit të verbër. Njohja dhe zbatimi i parimeve të tiflogjisë, respektimi i praktikave të përbotshme në trajtimin e verbërisë të të verbërve dhe organizatave të tyre.

Për fat të keq deri më sot ne kemi përballuar dhe po vazhdojmë të përballemi jo në pak raste me karshillëk dhe kundërshtim të pabazuar në moral, në ligj dhe në praktikën botërore. Të njëjtat probleme ka dhe organizata e invalidëve të punës dhe, mesa duket, i njëjti fat do presë dhe organizata të tjera kombëtare të PAK-ut. Konstatimi është i thjeshtë: Sa më shumë të forcohen organizatat kombëtare aq më përfaqësuese ato bëhen dhe aq më pak terren mbetet për të tjerët jashtë nesh.

Cili është roli real i politikës, qeverisë, institucioneve shtetërore dhe administratës publike?

Së pari: unë besoj se gjithçka çfarë është trajtuar më lart do të konsiderohet nga ana e tyre si një absurditet. Kjo për faktin se çdokush në vetvete, kur bëhet fjalë për personat me aftësi të kufizuar,

udhëhiqet nga mirësia dhe pozitiviteti ndaj njerëzve në nevojë. Ata nuk thellohen për të parë konfliktin e interesave në terren. Më së shumti, kjo motivohet nga mosbesimi te PAK-u. Pra, keqardhja dhe mosvlerësimi është perceptimi i parë ndaj PAK-ut. Mosvlerësimi i PAK-ut në mënyrë indirekte vjen dhe nga ndërhyrja e vrullshme në këtë fushë e të gjitha organizatave që punojnë për ta.

Një tjetër problem është dhe inkompetenca e administratës publike që mbulon sektorin e PAK-ut. Kjo inkompetencë nuk përfshin vetëm specifikat shkencore, por dhe mungesën e eksperiencës së brendshme dhe ca më tepër të asaj ndërkombëtare. Ndoshta politikanët dhe drejtuesit e rëndësishëm të shtetit nuk kanë as mundësinë dhe as informacionin e duhur për të njohur mekanizmat e funksionimit në këtë fushë, implikimin dhe komplikimin e interesave dhe për shkak të saj ata në mënyrë direkte dhe indirekte inkurajojnë dhe mbështesin veprime dhe veprimtari të cilat në mënyrë indirekte dëmtojnë interesat e PAK-ut.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se për shkak të kufizimeve të ndryshme krijohen dhe vështirësi dhe pamundësi për marrjen e informacioneve dhe dhënien e ekspertizës kompetente. Kjo pamundësi shfrytëzohet në mënyrë perfekte për të na mohuar të drejtën e përfaqësimit nga të interesuarit. Sigurisht, ashtu siç e thashë dhe më lart, harmonizimi i interesave në komunitete kaq të mëdha është mjaft i vështirë dhe pse ato janë thelbësisht të njëjta. Gjykoj se, nëse Qeveria, institucionet shtetërore dhe administrata publike do të udhëhiqen nga mirësia, pozitiviteti, duhet të përpiqen për t'i ndihmuar dhe kontribuar në përpjekjet e PAK-ut për organizimin e tij, për krijimin e organizatave kombëtare dhe për t'i shndërruar ato në përfaqësuese dinjitoze.

Gjithmonë kemi ngulur këmbë që në ligjin për organizatat jotifimprurëse në rrethanat aktuale duhet të ketë një kapitull të veçantë për organizatat e PAK-ut dhe atyre që punojnë në fushën e tij. Mendojmë se statutet e organizatave të PAK-ut duhet të ndërtohen në mënyrë më specifike, ku rregullat e lojës demokratike të jenë të përcaktuara më mirë dhe më qartë sesa në organizatat e tjera.

Prej shumë vitesh kemi propozuar dhe vazhdojmë të insistojmë që shteti, me ligj, të ketë të drejtën të ushtrojë kontroll mbi veprimtaritë ekonomike, të ardhurat dhe shpenzimet e organizatave të PAK-ut dhe sidomos atyre që punojnë në fushën e PAK-ut. Ky

kontroll nuk duhet të ketë natyrën përcaktuese të mënyrës apo orientimit të shpenzimeve, por vërtetësinë dhe efikasitetin e tyre. Ky kontroll nuk duhet konsideruar si një ndërhyrje në pavarësinë e organizatave, por si një mbështetje dhe mbrojtje që i garantohet individit PAK.

Në statusin e KKPAK, i cili është miratuar me konsultën e EDF dhe është vlerësuar mjaft mirë, janë dhënë disa përcaktime mbi organizatat kombëtare lokale si dhe grupet e tjera të bashkëpunimit. Aty janë përcaktuar jo vetëm kriteret dalluese mes tyre, ku ndër më kryesoret është qëllimi mbi të cilën ngrihet, roli që do të kryejë, pra është dhënë një përcaktim i qartë mes organizatave përcaktuese dhe atyre që do të ofrojnë shërbime. Ndërsa të parat marrin pjesë dhe ndikojnë në politikat dhe vendimmarrje, të dytat ofrojnë shërbime të specializuara. Janë përcaktuar dhe kriteret bazë mbi të cilat duhet të organizohet, shtrihet dhe veprojë secila nga to.

Gjykojmë se, nëse këto kritere do të merreshin parasysh dhe të shndërroheshin në ligj, do të krijohesh një bazë dhe stabilitet i fortë për lëvizjen dhe organizimin e PAK-ut.

Pra, do të kalonim një realitet të ri, jo vetëm ligjor por dhe shoqëror, ku parimi i përbotshtëm asgjë për ne pa ne, do të gjente fushë të plotë zbatimi. Ne jemi të ndërgjegjshëm se beteja për përfaqësimin është mjaft e vështirë dhe do të duhet një kohë e gjatë, gjatë së cilës të ndryshojmë së pari standardet social-ekonomike të vendit, ku tendenca e shndërrimit të OJF në OF do të zbutet, ku interesat për PAK-un të njerëzve jashtë tij do të jenë më realiste, duke i harmonizuar ato në mënyrë të drejtë dhe transparente. Gjatë kësaj kohe do të rritet dhe ndërgjegjësimi i PAK-ut për nevojën e organizimit dhe përfaqësimit. Ne do të synojmë që përfaqësimi të shndërrohet në një të drejtë ekskluzive për PAK-un.

Ne shpresojmë se civilizimi i mëtejshëm i shoqërisë do të jetë në dobi të përpjekjeve tona për zhvillim, prosperitet dhe integritet.

Të nderuar pjesëmarrës!

Kërkoj mirëkuptimin e të gjithëve për të shmangur çdo keqkuptim të mundshëm, pasi unë personalisht dhe organizata që përfaqësoj nderojmë dhe vlerësojmë kontributin e çdo individi dhe organizate në favor të PAK-ve dhe jemi absolutisht të hapur për të bashkëpunuar në dobi të çdo individi.

Gjithë sa u trajtua më lart, ne e vlerësojmë si një pjesë të procesit të zhvillimit të shoqërisë edhe pse vende-vende është i sforcuar.

Për përmirësimin e jetës sonë, ne do të parashtronim para Avokatit të Popullit dy grupe rekomandimesh

Grupi i parë

1. Përfaqësimi dhe mbrojtja kolektive nëpërmjet organizatave kombëtare të shndërrohet me ligj si një drejtë e PAK-ut.

2. Roli, funksionimi dhe statuti i organizatave kombëtare të PAK-ut të rregullohen në mënyrë të posaçme me akte ligjore apo nënligjore.

3. Shteti, me ligj, të ketë të drejtën të ushtrojë kontroll mbi drejtimin kryesor të veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj ekonomike financiare mbi organizatat e PAK-ut dhe në mënyrë të veçantë ndaj atyre që punojnë për PAK-un.

Grupi i dytë

1. Me ligj, pagesa e aftësisë së kufizuar të konsiderohet pagesë sociale me karakter kompensues për pasojat e kufizimit.

2. Personat me aftësi të kufizuar që nuk kanë të ardhura të qëndrueshme, përjashtuar ndihmën ekonomike, të përfitojnë një pension jo kontributiv.

3. Të klasifikohet me ligj aftësia e kufizuar, sipas shkallës së gravitetit fizik dhe social.

4. Ofrimi i shërbimeve, ndërhyrja dhe mbështetja social-ekonomike të bëhet në përputhje me shkallën e gravitetit.

ZHVILLIMI PËRFSHIRËS DHE KONVENTA PËR MBROJTJEN DHE NXITJEN E TË DREJTAVE DHE DINJITETIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Merita Pone (Myftari)

Shoqata “Handicap International Shqipëri”

1. Në rezolutën 56/168 të 19 dhjetorit 2001, Asambleja e Përgjithshme e OKB vendosi të krijojë një Komision Ad Hoc për Konventën Ndërkombëtare Integrale Gjithpërfshirëse për Mbrojtjen dhe Nxitjen e të Drejtave dhe Dinjitetit të Personave me Aftësi të Kufizuar, bazuar në modelin integruar, në punën e bërë deri më sot në fushën e zhvillimit social, të drejtat e njeriut, në parimin e mosdiskriminimit, si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit të të Drejtave të Njeriut dhe të Komisionit të Zhvillimit Social.

Zhvillimi Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar dhe Konventa e OKB-së

Personat me aftësi të kufizuar kanë jetuar në skajet e shoqërisë për shumë kohë. Ata vazhdojnë të shfuqizohen si qytetarë dhe të përjashtohen shoqërisht, ekonomikisht dhe politikisht. Procesi i hartimit të konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar mbulon të drejtat e njeriut dhe po zhvillohet përmes pjesëmarrjes së drejtuesve të organizatave të personave me aftësi të kufizuar.

Konteksti i Zhvillimit Inklusiv

Kombet e Bashkuara vlerësojnë se ka rreth 600 milionë persona me aftësi të kufizuar dhe se pjesa më e madhe e tyre (mbi 75%) jetojnë në vendet në zhvillim dhe janë më të varfrit e të varfërve. Sipas Bankës Botërore, një në pesë persona të varfër në botë është person me aftësi të kufizuar¹. Personat me aftësi të kufizuar përballen me shumë barriera që pengojnë aksesin e tyre në arsim, punësim, strehim, transport, kujdes shëndetësor dhe rehabilitim apo krijimtari.

Përjashtimi ekonomik dhe social, që është një realitet i hidhur për personat me aftësi të kufizuar në vendet në zhvillim, është pa diskutim çështje madhore e zhvillimit.

Zhdukja e varfërisë nuk do të - dhe nuk mund të - arrihet pa i rrymëzuar çështjet e aftësisë së kufizuar në të gjitha politikat e zhvillimit dhe pa siguruar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në planifikim, hartim, zbatim dhe vlerësim të programeve të zhvillimit.

Modelet për Aftësinë e Kufizuar

Personat me aftësi të kufizuar janë përpjekur të luftojnë perceptimet tradicionale për personin me aftësi të kufizuar si një objekt mëshire apo si njerëz të sëmurë që kanë nevojë për kurim.

Modelet e reja të aftësisë së kufizuar i ripërcaktojnë personat me aftësi të kufizuar si pjesëtarë me të drejta të plota në shoqëri që kanë mundësi të japin një kontribut të çmuar për veten, familjet e tyre dhe për komunitetet ku jetojnë. Kjo përfaqëse e rishikuar shpesh quhet ' modeli social ' për aftësinë e kufizuar. Ai e sheh aftësinë e kufizuar si një ndërveprim të personit me dëmtim me mjedisin social çaftësues përmes barrierave diskriminuese dhe izoluese që pengojnë pjesëmarrjen e plotë në jetën shoqërore. Modeli social i aftësisë së kufizuar thekson se personat me aftësi të kufizuar nuk lejohen të zhvillojnë mundësitë e tyre jo për shkak të dëmtimit, por si rezultat i barrierave diskriminuese ligjore, paragjykimeve dhe qëndrimeve, pengesave arkitektonike, komunikuese dhe të llojeve të tjera. Fokusi në radhë të parë vihet tek identifikimi, zbulimi dhe shqyrtimi i kufizimeve që hasin personat me aftësi të kufizuar në ambientin fizik dhe social në të cilin jetojnë.

Modeli social për aftësinë e kufizuar lidhet ngushtë të drejtat e njeriut: (i) I njeh personat me aftësi të kufizuar si bartës të drejtash që mund dhe duhet ta përcaktojnë vetë kursin e jetës së tyre ashtu siç është në gjendje çdo pjesëtar tjetër i shoqërisë. (ii) Fokuset te kufizimet që u bëhen personave me aftësi të kufizuar prej mjedisit social dhe fizik, duke i konsideruar këto kufizime si shkelje e të drejtave të njeriut.

Zhvillim Përfshirës, për të Ndërtuar një Shoqëri Përfshirëse

Zhvillimi përfshirës siguron se të gjitha etapat e ciklit të zhvillimit (hartimi, zbatimi, monitorimi, dhe vlerësimi) përfshijnë dimensionin

e aftësisë së kufizuar dhe siguron gjithashtu pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në mënyrë të plotë në proceset e zhvillimit dhe hartimin e politikave të zhvillimit. Zhvillim Përfshirës do të thotë, gjithashtu, zhvillim dhe respektim i të drejtave të njeriut.

Zhvillimi përfshirës reflektohet në konventë dhe: (i) Lehtëson rrymëzimin e çështjeve të aftësisë së kufizuar në të gjitha strategjitë kombëtare të zhvillimit, përfshi vendimet buxhetore për zbatimin e tyre. (ii) Jep kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim përfshirës.

Konventa e OKB-së për Mbrojtjen dhe Nxitjen e të Drejtave dhe Dinjitetit të Personave me Aftësi të Kufizuar

Lidhja mes të drejtave të njeriut dhe zhvillimit u njoh që me krijimin e Komitetit Ad Hoc, i cili draftoi një konventë të të drejtave për personat me aftësi të kufizuar.

Përpjekja për të hartuar një konventë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar paraqet një mundësi të rëndësishme për zhvillimin përfshirës dhe në konventë shprehet:

- koncepti i pjesëmarrjes dhe fuqizimit të personave me aftësi të kufizuar në nivel individual dhe mbështetja e përfaqësuesve të tyre (organizatave) në nivel kolektiv për të ushtruar ndikim politik.

Vetëm zhdukja e barrierave nuk do të krijojë kushtet për përfshirje të personave me aftësi të kufizuar. Kushtet e krijuara duhet të nxisin fuqizimin individual të personave që prej lindjes (të zhvillohet funksionim maksimal) dhe të lehtësojnë formimin e organizatave nga nivel komunitar dhe më lart. “Rrymëzimi” nuk është përgjigjja e vetme. Pa fuqizim të personit me aftësi të kufizuar, nuk ka pjesëmarrje të fuqishme. Personi duhet të aftësohet të jetë pjesëmarrës në ndryshim.

- sigurohet se të drejtat e personave me aftësi të kufizuar janë pjesë e programeve të zhvillimit që prej planifikimit, hartimit të monitoruar e deri te zbatimi dhe vlerësimi dhe se përfshirja e personave me aftësi të kufizuar në këtë proces është mënyra më e mirë për arritjen e zhvillimit përfshirës.

Parimet e Konventës për Zhvillim Përfshirës

Parimet janë: (i) autonomi & pavarësi; (ii) mos-diskriminim; (iii)

përfshirje e plotë dhe pjesëmarrje; (iv) respekt për të ndryshmit; (v) barazi mundësish².

· *Mosdiskriminim*

Mosdiskriminimi është parimi i përgjithshëm i konventës dhe lidhet me konceptin e barazisë (neni 7). Mosfutja e këtij koncepti do të përbënte jo vetëm një shkelje të të drejtave të njeriut, por do të shkonte edhe kundër etikes edhe kundër idesë së zhvillimit përfshirës. Aftësia e kufizuar duhet parë në syrin e diversitetit, ku qenia të ndryshëm është pasuri. Ky parim plotëson masat që merren për zhdukjen e çdo lloji diskriminimi bazuar në aftësinë e kufizuar, seksin, racën, dhe forma të tjera³.

· *Pjesëmarrja*

Ky parim shihet përgjatë gjithë tekstit të draft-konventës. Është e rëndësishme që qeveritë të sigurojnë fuqizim dhe pjesëmarrje të personave me aftësi të kufizuar përmes shoqatave të tyre në të gjitha nivelet e vendimmarrjes.

Strategjitë e zhvillimit duhet të sigurojnë pjesëmarrje të plotë të të gjithë aktorëve, pasi zhvillimi përfshirës lidhet me të gjithë sektorët në të gjitha nivelet. Neni 4 i konventës parasheh obligime për shtetet të punojnë në partneritet me personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat e tyre.

· *Përfaqësimi*

Rregulli 18 i Rregullave Standard të OKB-së për Barazinë e Mundësive për PAK-un njih parimin e përfaqësimit si mjetin më të fuqishëm për zbatimin e të gjitha rregullave standard të OKB-së.

Parimi i përfaqësimit lidhet me parimin e pjesëmarrjes, por në mënyrë të veçantë lidhet me të drejtën e personave me aftësi të kufizuar dhe të organizatave të tyre, të flasin me zërin e tyre dhe të veprojnë për vete dhe për të tjerë persona me aftësi të kufizuar në bashkësinë e njerëzve me aftësi të kufizuar. Parimi i përfaqësimit është themelor për të siguruar se bashkësia e njerëzve me aftësi të kufizuar mund të kontribuojë me ide në çështjet që prekin të gjithë personat me aftësi të kufizuar.

· *Bashkëpunimi ndërkombëtar (ky parim duhet shtuar në konventë)*

Ky parim është parë si mundësi për zbatimin e zhvillimit

përfshirës jo vetëm si bashkëpunim mes vendeve të zhvilluara me ato në zhvillim, por mes të gjitha vendeve dhe theksohet në të gjitha konventat e OKB-së dhe marrëveshjet e agjencive të OKB-së.

Bashkëpunimi ndërkombëtar mund të ndihmojë në fuqizimin e personave me aftësi të kufizuar dhe të organizatave të tyre në nivel lokal dhe kombëtar, duke i bërë shërbimet të njohura dhe të përdorshme për gjithkënd.

EUROPEAN DISABILITY FORUM – EDF (FORUMI EUROPIAN I AFTËSISË SË KUFIZUAR)

“Një shoqëri që është e mirë për njerëzit me aftësi të kufizuar
është e mirë për të gjithë”

3.1 Të Drejtat e Njeriut

Të drejtat janë universale: Aftësia e kufizuar është konsideruar gjithnjë e më shumë si çështje e të drejtave të njeriut, prej instrumenteve ligjore ndërkombëtare, dhe e drejta njerëzore për të mos u diskriminuar ka përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuar.

Në vendet në zhvillim brezi i dytë i të drejtave të njeriut si e drejta për jetën, për ushqim etj. janë një prioritet për personat me aftësi të kufizuar në komunitetet e varfra, por duhen parë ngushtësisht të lidhura me të drejtat civile dhe ato politike. Nga perspektiva e të drejtave të njeriut, programet e zhvillimit nuk mund të gjejnë më justifikim për t’iu shmangur aftësisë së kufizuar. Përjashtimi i qëllimshëm i aftësisë së kufizuar nga programet e zhvillimit konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut e shprehur kjo në instrumentet legale të ratifikuara prej shteteve.

Të drejtat janë të Padukshme: Lidhur me rrymëzimin, çështja më me rëndësi është të bëjë të dukshme të drejtat njerëzore për personat me aftësi të kufizuar, pasi edhe pse një qendër rehabilitimi mund ta ndihmojë një person të gëzojë të drejtën e rehabilitimit, nëse ai përjashtohet nga shkolla dhe puna, të drejtat e tij civile janë shkelur. Vetëm mbështetja e projekteve specifike për aftësinë e kufizuar nuk d.m.th. se po respektohen të drejtat, sepse diskriminimi dhe përjashtimi vazhdon edhe brenda sistemit të rrymëzuar. Ka disa parime themelore që japin një bazament solid për rrymëzimin:

- Vlera të barabarta dhe dinjitet për çdo qenie njerëzore.
- Mosdiskriminim: diskriminimi njihet si forma më e përhapur e dhunimit të të drejtave njerëzore, ka diskriminim në sistemin e shërbimeve dhe në shoqëri.
- E drejta për akses - në mjedis, shërbime, struktura
- E drejta për të jetuar në komunitetin vet dhe pranë familjes.

- E drejta për integrim shoqëror dhe për pjesëmarrje të plotë në shoqëri.
- E drejta për marrë pjesë aktivisht në jetën politike dhe për të votuar.
- E drejta për lirinë e organizimit.

4 Rekomandime për Bashkimin European, për të përfshirë dimensionin e aftësisë së kufizuar në bashkëpunimin për zhvillim

4.1 Çfarë e bën të mirë një politikë?

Politika për rrymëzimin e aftësisë së kufizuar sapo ka lindur. Ajo duhet të marrë në konsideratë si kuptimet që po ndryshojnë me shpejtësi në lidhje me bashkëpunimin për zhvillim, ashtu edhe kuptimin e thelluar të aftësisë së kufizuar si një çështje e të drejtave të njeriut brenda kontekstit të varfërisë dhe të kulturave tepër të ndryshme. Një politikë është e mirë, saç është i madh impakti i saj. Në ç'masë ofron ajo një bazë reale për realizimin e të drejtave të personit me aftësi të kufizuar dhe për pjesëmarrjen e tyre të plotë në zhvillimin e komunitetit? Politika duhet të ketë dhëmbë: Është tjetër politika formale, që përmban detyrime ligjore dhe tjetër diskutimi, konceptet, strategjitë, konsultimet, apo letrat që prodhohen. Këto mund të jenë shumë ndikuese dhe përdoren shumë prej lobistëve dhe japin më shumë frymëzim se sa jep letra e një ligji.

Përbërësit Kyç të një politike të mirë

a) Politikë e rrymëzuar: politika e aftësisë së kufizuar dhe bashkëpunimi për zhvillim duhet të jenë pjesë përbërëse e politikës së përgjithshme të zhvillimit european dhe e politikave të bashkëpunimit të vetë shteteve anëtare të BE-së. Edhe kur është çështje specifike e aftësisë së kufizuar, ajo duhet të integrohet plotësisht në objektivat e përgjithshme të zhvillimit.

b) “Asgjë për Ne, pa Ne”: Konsultim i organizatave të personave me aftësi të kufizuar, veçanërisht nga vende partnere të Europës Juglindore dhe me theks të veçantë përfshirjen e personave të varfër me aftësi të kufizuar, të grave, fëmijëve, grupeve që janë të përjashtuara, sidomos: personat shurdhë, ata me dëmtime intelektuale, personat me probleme të shëndetit mendor, grupet e prindërve etj.

c) Një shoqëri për të gjithë: duhet përmendur qartë qëllimi i një shoqërie përfshirëse që toleron dhe mirëpret diversitetin, nxit barazinë dhe drejtësinë sociale, një shoqëri ku personat me aftësi të kufizuara kanë një rol kyç për të luajtur.

d) Aftësia e kufizuar është çështje e të drejtave të njeriut: referim te rregullat standard të OKB-së dhe te dokumentet ligjore detyruese për të drejtat e njeriut që kanë shtrirje të gjitha qeniet njerëzore. Pjesëmarrje dhe reflektim për draftin e OKB-së për Konventën e të drejtave të personit me aftësi të kufizuara. Politika duhet të reflektojë mirëkuptim për padukshmërinë e të drejtave të njeriut dhe një vazhdimësi të të drejtave që prej mbijetesës e deri te zhvillimi i të drejtave civile dhe politike.

e) Modeli social: Politika duhet të reflektojë se e kupton aftësinë e kufizuar si një marrëdhënie mes personit dhe shoqërisë, që e diskriminon, përjashton dhe e lë mënjanë atë. Ajo duhet të fokusohet te barrierat që hasin personat me aftësi të kufizuara për përfshirje shoqërore dhe pjesëmarrje, duhet të theksojë qartë zhdukjen dhe parandalimin e të gjitha barrierave.

f) Varfëria dhe Aftësia e Kufizuar: Politika duhet të përmendë në mënyrë të qartë ndërvarësinë mes varfërisë dhe aftësisë së kufizuar dhe rëndësinë e përfshirjes së dimensionit të aftësisë së kufizuar në strategjitë e zbutjes së varfërisë.

g) Përfaqje paralele: politika duhet të theksojë nevojën për programe specifike për aftësinë e kufizuar, si ngritja e kapacitetit të organizatave të personave me aftësi të kufizuara, si dhe ta rrymëzojë atë në të gjithë sektorët kryesorë të zhvillimit. Megjithatë, duhet bërë kujdes me programet specifike, pasi mund të veçojnë më shumë se sa të përfshijnë.

h) Strategji praktike të përshtatshme: politika duhet t'i referohet shembujve të mirë që kanë pasur sukses në kontekstin lokal, dhe jo të eksportojë praktika nga Nordi. Këtu përfshihen shërbimet me bazë komunitare dhe arsimit gjithëpërfshirës që është më i gjerë se sa arsimit formal special.

i) Situatat dhe grupet veçanërisht vulnerabël: Politika duhet të përmendë në mënyrë të veçantë situatat kur personat me aftësi të kufizuara ndodhen në gjendje konflikti, emergjence apo situatë refugjatësh, si dhe në rastet kur nxitet institucionalizimi në vend të përfshirjes. Këto situata po ndodhin shpesh. Politika duhet të marrë parasysh që personat me aftësi të kufizuara nuk janë një grup

homogjen, dhe se brenda tyre ka grupe veçanërisht të rrezikuara për t'u lënë mënjanë, siç janë: njerëzit me dëmtim të thellë të shumëfishtë, personat shurdhë, njerëzit me probleme të shëndetit mendor dhe ata që vuajnë një diskriminim të shumëfishtë si p.sh. fëmijët me aftësi të kufizuar, gratë dhe minoritetet etnike.

j) Aksesibiliteti: Politika duhet ta vërë theksin tek aksesibiliteti në informacion, komunikim, si p.sh. gjuhë shenjash, Braille, në shërbimet e rrymëzuara dhe në mjedis.

k) Përgjegjësia dhe Burimet: Personat brenda sektorëve të rëndësishëm duhet të vishen me përgjegjësi për të rrymëzuar aftësinë e kufizuar. Buxheti duhet të ketë një llogari më vete për rrymëzimin e aftësisë së kufizuar, listimi në fund të buxhetit nuk duhet të ndodhë më.

Të gjitha këto elemente përbërëse të një politike të mirë për aftësinë e kufizuar, qëndrojnë jo vetëm në formulimin e politikës në nivelin e Bashkimit European, por edhe në formulimin e politikave kombëtare të vetë shteteve anëtare të BE-së.

“INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT NË MBROJTJE TË INTEGRIMIT DHE BARAZISË NË KOMUNITET TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

Fjala e z. Riza Poda

Komisioner në Institucionin e Avokatit të Popullit

Të nderuar pjesëmarrës,

Është privilegj i veçantë për këdo, për të diskutuar dhe referuar në këtë Konferencë Kombëtare me kaq rëndësi, ku marrin pjesë specialistë prestigjiozë si dhe personalitete të larta të fushës sociale dhe të të drejtave të njeriut. Ky privilegj është shoqëruar me preokupacion të sinqertë nga ana ime, për më tepër kur diskuton në emër të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Bëhet fjalë për trajtimin dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuar, kategori e veçantë e shoqërisë sonë, që përbëhet nga fëmijët, moshat e reja, të moshuarit, deri invalidët e Luftës Antifashiste.

Duke iu referuar të dhënave zyrtare, numri i personave me aftësi të kufizuar që trajtohen me skemat e shërbimit social dhe përfitojnë pagesë mujore, në vitin në vazhdim është përafërsisht rreth 105 000 veta.

Bëhet fjalë për individë me të meta mendore, të verbër, para dhe tetraplegjikë, invalidë të punës dhe të luftës. Për këta individë, buxheti i Shtetit për vitin 2007 ka parashikuar një fond prej 82 milionë dollarë ose 15% më shumë se vitin në vazhdim. Është parashikuar dhe efektivisht ka nisur transferimi i qendrave të shërbimeve rezidenciale në varësi të pushtetit lokal, si dhe është menduar ngritja e 40 qendrave të reja të shërbimeve sociale në 8 qarqe.

Pavarësisht sa më sipër, numri i personave të tjerë në nevojë, me situata të ndryshme të pamundësisë fizike e mendore, të cilët nuk përfitojnë nga Shërbimi Social Shtetëror, mund të jetë edhe më i madh.

Si rrjedhojë e një vëmendjeje të veçantë për kategori të tilla të shoqërisë sonë, mund të thuhet se kujdesi i shtetit dhe shoqërisë në vend ka ardhur në rritje dhe megjithatë, ka vend për më shumë.

Strategjia dhe politikat e ndjekura në këtë kuadër janë ende jo gjithëpërfshirëse, me programe jo të plota dhe shërbime sociale të pamjaftueshme. Është për të vlerësuar se veprimet në aspektin legjislativ, por edhe atë ekzekutiv, për këtë kategori shoqërore në nevojë, kanë pasur dhe kanë ecuri. Është përmirësuar dhe plotësuar legjislacioni përkatës, gjë që ka sjellë për rrjedhojë edhe rritjen e shkallës së përkujdesjes, shtimin e të ardhurave nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të drejtpërdrejta dhe atyre mbështetëse, aplikimi i politikave subvencionuese, por edhe rritjen e nivelit ekonomik-e-financiar.

Për t'u përmendur është trajtimi nëpërmjet rregullimit me ligje të veçanta të kategorive të tilla si invalidët e punës dhe të luftës kundër pushtuesve nazifashistë, të verbërve dhe të para dhe tetraplegjikëve.

Garantim i veçantë ligjor i është kushtuar, sidomos ndërmjetësimit për punësim për personat me aftësi të kufizuar, programeve të formimit dhe riaftësimit profesional, por edhe stimulimit e dhënies së subvencioneve për nxitjen e punëdhënësve. Më tej akoma, i njëjti garantim ligjor i është kushtuar strehimit me përparësi, në bazë të programeve sociale për strehim në zonat urbane dhe subvencionimin e qirasë. Por megjithatë kërkesat për strehim janë në përpjesëtim të zhdrejtë me çka ofrohet.

Përcaktimi i rregullave dhe normave urbanistike dhe arkitektonike, ndërtimet pa barriera për PAK-un, gjithashtu janë rregulluar me ligj, por zgjidhjet alternative në to mungojnë, siç mungon edhe vendosja e ashensorëve enkas për ta, shtëpitë dhe ndërtesat e aksesueshme, siç mungon lëvizja e lirë dhe e pavarur në mjedisin e ndërtuar. Të gjitha këto anashkalohen nga projektuesit dhe subjektet ndërtuese, pa u ushtruar asnjë penalitet ndaj tyre.

Është garantuar në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor e drejta e çdo shtetasi që ka mbushur moshën 18 vjeç që të zgjedhë dhe të zgjidhet. Por praktika ka treguar se praktikisht kjo e drejtë u është mohuar një pjesë të madhe të PAK-ut. Janë të papërshtatshme për një kategori, Qendrat e Votimit, të cilat janë tej mundësisë së tyre fizike për të shkuar në to. E njëjta gjë mund të thuhet lidhur me udhëtimet falas me mjetet e transportit qytetës, me pajisjen me mjete ortopedike, proteza dhe mjete lëvizëse, për kurimin e barabartë me të tjerët në institucione shtetërore mjekësore dhe marrjen e medikamenteve farmaceutike falas, në mundësitë e pakta për arsimim etj.

Me rëndësi të veçantë në këtë kuadër është sidomos procesi i punësimit, arsimimit dhe strehimit, si fusha ku vërehen më shumë qëndrime ende neglizhente, si një refleksion i traditës diferencuese dhe konceptimeve arkaike, që vazhdon ende të mos pranojë individët me aftësi të kufizuar si të barabartë në shoqëri.

Strategjia e Shërbimeve Shoqërore, miratuar me VKM nr.8, datë 7.1.2005, në tërësinë e saj është një arritje në vendosjen e piketave të reja në programin e shërbimeve sociale të shtetit në trajtimin e kësaj kategorie personash. Ky dokument synon të sigurojë një politikë reformuese jo vetëm për personat me aftësi të kufizuar (PAK), por në veçanti përafrimin me programet e përparuara të shteteve të integruara prej vitesh në Bashkimin Europian. Kjo nga njëra anë. Nga ana tjetër, ajo synon përshkallëzimin e emancipimit të mentalitetit dhe opinionit të brendshëm për këtë problem. Strategjia synon, gjithashtu, zgjerimin e llojshmërisë së shërbimit shoqëror, kalimin në shërbime komunitare, decentralizimin e shërbimeve shoqërore dhe delegimin e kompetencave të pushteti vendor, pjesëmarrjen e këtij të fundit për financime të shërbimeve edhe me fondet e tyre.

60

Të nderuar pjesëmarrës!

Institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se Integrimi i mëtejshëm i PAK-ut dhe moslënia e tyre në harresë, kërkon përpjekje dhe vëmendje akoma më të madhe nga shteti dhe shoqëria. Problemet e PAK-ut kanë një fushë të gjerë trajtimesh, të cilat duhen trajtuar në të gjitha nivelet, përfshirë bashkëpunimin ndërmjet ministrive të linjës (të Ndërtimit, Arsimit, Shëndetësi-Financave, Drejtësisë etj.) dhe autoriteteve të pushtetit lokal.

Nga studimet e bëra dhe konstatimet në vend, rezulton se pjesa më madhe e ankesave të personave me aftësi të kufizuar, kanë pasur të bëjnë me pretendime ndaj Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social për masën e ndihmës ekonomike, për pagesën për aftësi të kufizuar, për mostrajtim ose ndërprerje të saj, për shërbimet e përkujdesit shoqëror dhe për zvarritje të procedurave administrative nga këto Drejtori, si dhe për përfitimin e pagesës së kujdestarisë. Për këtë të fundit, mendojmë se ky lloj përfitimi nuk duhej dhe s'kishte pse të lidhej me skemën e ndihmës ekonomike. Këtë qëndrim e materializua me një Rekomandim, i cili u vlerësua i drejtë dhe i bazuar në ligj. Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit nr.9355,

datë 10.3.2005 “Për Ndhimën dhe Shërbimin Shoqëror”, u materializuan ndryshimet e lartpërmendura. Gjatë shqyrtimit të disa ankesave për shërbimet sociale, është konstatuar se mundësitë e vendit për të siguruar shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë, në disa raste janë kompromentuar nga gjendja e dobët e infrastrukturës dhe lëvizjet e mëdha demografike. Për një numër të konsiderueshëm ankesash, jashtë kompetencave dhe juridiksionit tonë, ndihma e Avokatit të Popullit ka konsistuar në orientimin dhe informimin e ankuesve për të drejtat e tyre dhe rrugët që duhet të ndjekin. Institucioni ynë, duke vlerësuar me vëmendje rastet e trajtuara, pasi ka arritur në përfundimin se ndodhemi para shkeljeve evidente, ka shfrytëzuar mjetin e tij ligjor në kësi rastesh, duke u dërguar rekomandime organeve të administratës qendrore apo vendore, për rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur. Vetëm këtë vit u janë adresuar 56 rekomandime organeve të ndryshme të administratës qendrore apo vendore. Objekti i tyre përfshin rekomandime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe të Komisionit të Shërbimit Civil, të trajtimit të të burgosurve, të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, të nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të ligjit ose përmirësimi i tyre, të problemit të faturimeve të harxhimit të energjisë elektrike dhe ndryshimin e këtij të fundit, marrjen e masave administrative ndaj punonjësve të administratës publike për shkelje të të drejtave dhe interesave të qytetarëve etj.

Për t’u përmendur është rekomandimi i datës 12.6.2002, drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, për përgatitjen e një projektvendimi në lidhje me një shtesë në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.381, datë 20.5.1996 “Për zbatimin e Ligjit Nr.7889 datë 14.12.1994 “ Për statusin e invalidit”, ku kërkohet një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, për të gjithë të aksidentuarit gjatë kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Rekomandimi është pranuar dhe reflektuar në nenin 17 të Ligjit nr.9418, datë 20.5.2005 “Për Sigurimet Shoqërore Suplementare të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura”. Në zbatim të Ligjit “Për shëndetin mendor”, ministrit të Shëndetësisë dhe drejtorit të Spitalit Psikiatrik Elbasan u është dërguar në datën 23.2.2006 Rekomandimi për përmirësimin e trajtimit ligjor, shëndetësor dhe social të pacientëve të Spitalit Psikiatrik Elbasan.

Në muajin mars i është dërguar një rekomandim tjetër ministrit të Shëndetësisë për problemet e bëra prezent nga Shoqata e

Talasemikëve të Shqipërisë, lidhur me shërbimin e transfuzionit të gjakut e produkteve të tij si dhe transplantimin. Për të dy këto rekomandime ministri i Shëndetësisë shprehu mirëkuptimin e institucionit të tij, duke bërë të ditur edhe masat konkrete të marra në zbatim të tyre. Në vazhdim, evidentojmë rekomandimin e datës 3.3.2006 drejtuar Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për përgatitjen e një Projektvendimi të Këshillit të Ministrave në bazë dhe për zbatim të neneve 8, 9, 10 e 11 të Ligjit nr.8661 datë 18.09.2000 “Për sigurimet shoqërore suplementare e punonjësve të Policisë së Shtetit”. Në përgjigjen e ardhur jepeshin sqarime se ishte përgatitur një VKM, por që ishte kthyer për rishikim nga Ministria e Financave. Në muajin tetor e kemi përsëritur rekomandimin dhe jemi ende në pritje të përgjigjes.

Në muajin maj të vitit 2005 i janë dërguar Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave, rekomandimet e dala nga seminari i datës 23-24 shkurt 2005, organizuar nga institucioni ynë në bashkëpunim me Shoqatën e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar, me qendër në Gjenevë, për problemet e adoleshentëve dhe adultëve me aftësi të kufizuar.

Në vendin tonë, në fushën e shërbimit social, ushtrojnë veprimtari shumë shoqata, fondacione dhe organizata jofitimprurëse, që kanë dhënë dhe japin kontribut në fushën e njohjes, promovimit, inkurajimit dhe mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar. Të gjithë këta organizma, secili në drejtimin e vet specifik, ndihmojnë konkretisht në integrimin sa më të plotë të grave, fëmijëve, njerëzve të moshave, shtresave, mentaliteteve dhe bindjeve të ndryshme, të gjithë me aftësi të kufizuara, duke kontribuar që përfshirja e tyre në shoqërinë e sotme të bëhet sa më e plotë.

Gjatë procesit të organizimit të kësaj Konference, jo vetëm gjetëm bashkëpunimin e plotë të tyre, por patëm edhe mundësinë të njiheshim nga afër me një pjesë të mirë të veprimtarisë së tyre alternative dhe konkurruese me shërbimet që ofrojnë institucionet shtetërore.

Ndërgjegjësimi i Komunitetit të biznesit, si një grupim i fuqishëm ekonomik-financiar, duhet të jetë evident në punën e të gjithëve. Ky Komunitet duhet ta ketë më të zhvilluar ndjenjën e humanizmit dhe të solidaritetit me pjesën e varfër të popullsisë, për shkak të

kufizimeve të tyre fizike apo mendore për t'u integruar. Kontributet dhe donacionet e tyre në përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve, të ambienteve të jashtme dhe të brendshme shkollave në përshtatje me gjendjen e fëmijëve me aftësi të kufizuar, mundësimin e ndjekjes së kurseve kompjuterike, të gjuhëve të huaja apo atyre profesionale, për këtë kategori personash do të jenë gjithnjë të mirëpritura.

Duhet veçuar edhe roli i veçantë që luan media në sensibilizimin e opinionit për problemet e personave me aftësi të kufizuar, bashkëpunimi i tyre me fondacionet dhe shoqatat që veprojnë në këtë fushë. Me publikimin e fakteve të ndryshme, njohurive dhe eksperiencave të tyre, me informimin, këndvështrimin e të drejtave dhe vështirësive që ata hasin, me portretizimin human dhe terminologjinë e saktë, mediat do të japin një pasqyrim sa më afër të vërtetës për këtë kategori në nevojë. Janë konkrete dhe me shumë vlera raste të tilla të bëra prezent nga shumë TV dhe gazeta.

Të nderuar pjesëmarrës!

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, si të drejta themelore të njeriut, për vetë veçorinë e tyre, kërkojnë politika të integruara dhe një angazhim jo vetëm shtetëror, por kryesisht mbarëshoqëror. Sado ligje dhe kode të miratohen, sado përpjekje të bëhen, sado para të investohen, pa solidaritetin dhe ndërgjegjësimin e të gjithëve, nuk mund dhe nuk do të ecet përpara për integrimin e plotë të kësaj pjese të shoqërisë.

Faleminderit!

INTEGRIMI I INVALIDËVE TË PUNËS NË SHOQËRI NËPËRMJET PUNËSIMIT

Abdulla Omuri

Kryetar i “Shoqatës të Invalidëve të Punës të Shqipërisë”

Invalidët e punës janë ajo shtresë e popullsisë që kërkojnë vëmendjen e shtetit dhe të shoqërisë. Me termin invalidë pune kemi parasysh të gjithë ata invalidë, që kanë kontribuar dhe janë bërë të paaftë nëpërmjet punës. Me fjalën shtet kuptojmë që ky i fundit është i detyruar të aplikojë një legjislacion me standarde reale, për punësimin e kësaj shtrese, ndërsa shoqëria është ajo që bën të mundur pranimin tonë në hapësirat e saj.

Në të vërtetë natyra na mori gjënë më të shtrenjtë të jetës sonë, shëndetin; por kjo nuk do të thotë aspak se ne jemi të padobishëm dhe të pavlerë në jetë. Invalidët e punës sot kanë kapacitete të pallogaritshme në shoqëri, ata i gjen me grada shkencore, ku me nivelin e tyre profesional mund të jepnin shumë në fusha të ndryshme të jetës. Profesionet e tyre fillojnë që nga juristë, mjekë, inxhinierë, ekonomistë, mësues, teknologë e të tjerë, por mbi të gjitha ata janë edhe familjarë të mirë, pavarësisht se të ardhurat e tyre janë nën minimumin jetik në vend.

Sot në vendin tonë numërohen mbi 36 mijë invalidë të punës, të ndarë sipas grupeve të invaliditetit dhe konkretisht: janë mbi 22 mijë invalidë të plotë dhe mbi 14 mijë invalidë të pjesshëm, të cilët janë me të drejtë pune. Aktualisht, me gjithë përpjekjet tona, në shumicën e rasteve duke u përballur edhe në procese gjyqësore, kemi mundur të mbajmë në marrëdhënie pune vetëm 1720 invalidë. Kapaciteti arsimor i invalidëve të punës është si vijon: 12 % me arsim të lartë, 63 % me arsim të mesëm dhe 25% me arsim tetëvjeçar.

Pra, kapacitetet arsimore të invalidëve të punës janë të pëlqyeshme. Shumica e këtyre invalidëve janë të grupuar në shoqatën e invalidëve të punës, ku çdo ditë po japin idetë e tyre në favor të përmirësimit të kushteve ekonomiko-sociale të kësaj shtrese. Si vend në tranzicion, punësimi i invalidëve të punës ka qenë shumë i vështirë, për të mos thënë dhe i pamundur.

Me këmbënguljen e Shoqatës është bërë i mundur hartimi dhe miratimi i një legjislacioni të pranueshëm dhe i standardeve ndërkombëtare për këta persona; konkretisht: Ligji 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ligji “Për Statusin e Invalidëve të Punës”, si dhe ligji 7995 “Për nxitjen e Punësimit”, i cili përcakton qartë se: “punëdhënësi është i detyruar që në çdo 25 punonjës të punësojë një invalid të punës”.

Në qoftë se shteti ka një ligj ku është garant vetë ai për zbatimin e këtij ligji unë do shtroja një pyetje: Sa invalidë pune janë të punësuar sot realisht në administratën shtetë-rore? Dimë se në administratën shtetërore ka një fuqi punëtore prej 110 mijë vetësh dhe në bazë të ligjeve të përmendura më lart duhet të ishin punësuar mbi 4500 invalidë.

Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për punë invalidin e deklaroi 8 orë ose 6 orë punë të lehtë, pra detyrimisht duhet që këtij të fundit t’i sigurohet punë. Me keqardhje duhet të pranoj sot këtu para jush se jo që nuk u sigurohet punë, por invalidët e punës marrin edhe një mospërfillje nga punëdhënësit me fjalët: “ne nuk kemi punë për të shëndoshët dhe jo më për juve”, paçka se këta punëdhënës të rinj mbajnë mbi supet e tyre kontributin e këtyre invalidëve. Në këtë rast dua të falënderoj ministrin e Punës dhe Shanseve të Barabarta, zotin Barka, i cili punësoi në atë dikaster një invalid, zotin Ndrekë Ismaili. Këto janë shenjat e para dhe optimiste për ne invalidët e punës, për të demonstruar energjitë dhe fuqitë tona administrative, organizative dhe profesionale, duke vërtetuar se jemi të aftë të punojmë krahas individëve të shëndoshë fizikisht, por në disa raste të sëmurë në ndërgjegje, ndërsa ne me humbje aftësie nga puna, por me një ndërgjegje të pastër për punë.

Punësimi i invalidëve të punës në radhë të parë është detyrim ligjor, por jo vetëm kaq, ai është logjik dhe njerëzor. Duke punësuar një invalid pune, atij i jepet shansi për të qenë i barabartë në shoqëri, për të punuar në komunitet, si dhe bëhet i dobishëm për familjen e tij, duke përmirësuar ndjeshëm gjendjen social-ekonomike. Jo vetëm kaq, por punësimi shton shanset e këtij personi për t’u integruar në shoqërinë pa barriera.

Unë kam pasur fatin të shikoj në shumë vende të Europës punësimin e invalidëve. Me anë të punësimit ata ishin plotësisht të integruar në jetën e përditshme shoqërore dhe asnjëherë nuk e mendonin veten jashtë shoqërisë. Më ka bërë përshtypje edhe mënyra

e formatimit të legjislacionit në Çeki, ku sekretarët e Bashkive në Qytetet e mëdha ishin persona me aftësi të kufizuara, përfshi këtu që kishte edhe një Sekretar Shteti për këto kategori. Ky mekanizëm i jepte shumë fuqi zbatimit të legjislacionit dhe zbuste shumë problemet e krijuara tek invalidët.

Një element i ngjashëm ligjor, që përmendëm më lart, është edhe miratimi nga Qeveria i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara. Në këtë dokument një kapitull të veçantë zënë edhe problemi i punësimit të kësaj shtrese. Dua të shtoj këtu se në hartimin e këtij dokumenti një kontribut të madh kanë dhënë edhe shoqatat që përfaqësojnë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Një element tjetër në këtë strategji është edhe Këshilli Kombëtar për çështjet e aftësisë së kufizuar, që drejtohet nga zv/Kryeministri, ku në përbërje të këtij këshilli do të jenë të gjithë ministrat që kanë lidhje me invalidët dhe 5 shoqatat kombëtare që përfaqësojnë aftësinë e kufizuar. Por si çdo ligj që nuk zbatohet në vendin tonë, edhe ky organizëm ende nuk ka gjetur mundësinë për t'u mbledhur edhe pse ka një urdhër të Kryeministrit që në muajin janar 2006. Ne mendojmë se funksionimi i këtij Këshilli do të ndikonte shumë në zbutjen e problemeve të invalidëve dhe në mënyrë të veçantë në punësimin e tyre.

Si e mendojmë zgjidhjen e këtij problemi?

Duhet detyrimisht ndërhyrja në ligje, ku disa kohë më parë në Ministrinë e Punës është diskutuar për një ndërhyrje të tillë, por, me sa duket, ky problem ka mbetur në heshtje. Ndërhyrja në ligje kishte të bënte me tre objektiva shumë të domosdoshëm në lidhje me punësimin. E para ishte ulja e koeficientit të punësimit për punëdhënësit, nga 25 punonjës të jetë në 10 vetë të punësuar, punëdhënësi të punësoje 1 invalid pune.

E dyta ishte që në ligje të përcaktoheshin sanksione të forta për punëdhënësit. E treta, po në këtë ligj duhet të përcaktohej edhe krijimi i fondit social. Me këtë fond nënkuptojmë që çdo punëdhënës që nuk përmbush detyrimet ligjore për punësimin e invalidëve të punës, të derdhë një detyrim financiar në këtë fond. Ky fond do të përdoret pastaj për kualifikimin e invalidëve dhe nëpërmjet programeve të punësimit hapjen e vendeve të reja të punës për invalidët. Mënyra të tilla punësimi aplikohen në Hungari e Bullgari, pa përmendur këtu vendet si Gjermania, Austria, Italia, Greqia e të tjera, që kanë rregulla shumë të forta për punësimin e

invalidëve të punës.

Po të shkoni në Greqinë fqinje, duhet që t'i biesh bulevardit më këmbë për të blerë një pakete cigare, sepse të drejtën për të tregtuar cigare në kioskat e tyre e kanë vetëm invalidët. Duke ju servirur shembuj pozitivë për punësimin e invalidëve, e kundërta ndodh në vendin tonë. Në bazë të statistikave tona, që nga muaji janar 2006 dhe deri më sot janë pushuar nga puna 227 invalidë të punës. Këta drejtues nuk mendojnë se po pushuan nga puna invalidët kanë shkelur ligjin, kanë dëmtuar shtetin, sepse po të pushosh nga puna invalidin e punës automatikisht invalidi përfshihet në skemën e ndihmës ekonomike, ke dëmtuar edhe invalidin vetë, duke e mënjanuar nga shoqëria ku ai kontribuonte, pra janë shkelur në flagrancë të drejtat e njeriut dhe konventat ndërkombëtare. Pushime të tilla nga puna kanë shkaktuar dhe shkatërrim të familjeve të invalidëve. Veprimet në kundërshtim me ligjet nuk i shërbejnë integritit, por lënë shteg për diskriminimin e kësaj kategorie.

Po të mendojmë se deklarimin e një invalidi të plotë apo të pjesshëm e bën një komision mjekësor prej 5 vetësh dhe në rastet kur ky komision shprehet për invalidin me të drejtë pune, atëherë çdo punëdhënës është i detyruar që të zbatojë vendimet e këtij komisioni. Dimë se në vendin tonë janë dy institucione të paapelueshme: Kempit dhe Gjykata Kushtetuese. Me të drejtë shtroj pyetjen: 'Përse nuk zbatohen vendimet e Kempit?' Ne jemi dëshmitarë se edhe në institucionin që funksionon dhe varet Kempit ka pasur pushim nga puna të invalidëve.

Një bashkëpunim shumë i ngushtë për zbatimin e këtij ligji duhet mes Shoqatave që mbrojnë interesat e këtyre invalidëve dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës. Bashkëpunimin unë e shikoj edhe në përfshirjen e invalidëve të punës në strukturat e administratës së Inspektoriatit të Punës. Jam i bindur se po të ishte një inspektor në këtë institucion, nga invalidët e punës, nuk do të kishim këto anomali në punësimin e invalidëve. Vetëm një bashkëpunim real dhe konstruktiv do të bënte të mundur realizimin e këtij objektivit tepër jetik dhe social për invalidët e punës.

LEGJISLACIONI, SI ZBATOHET, MANGËSITË DHE PROBLEMATIKAT NË KËNDVËSHTRIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR

Bardhylka Kospiri

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të
Kufizuar

Personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri përbëjnë një numër prej rreth 100 mijë personash, referuar Strategjisë Kombëtare të PAK-ut, duke u përfshirë edhe numri i PAK-ut që u rrit si rezultat i ndryshimeve të fundit ligjore.

Në pjesën më të madhe legjislacioni shqiptar ka garantuar realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, megjithatë ata vazhdojnë të ndeshen në të shumtën e rasteve me mohim apo mosrespektim të të drejtave të tyre njerëzore. Ky fenomen ndodh për shkak të shumë faktorëve, më kryesori ndër të cilët është kuadri ligjor, i cili nga njëra anë është hartuar në mënyrë të tillë që në vetvete ka prodhuar “diskriminim” midis kategorive të aftësisë së kufizuar, nga ana tjetër nuk kanë funksionuar si duhet mekanizmat detyrues ligjorë që vënë në lëvizje zbatimin e ligjit në praktikë.

Ky fenomen më pas reflektohet si në planin individual, me anë të mohimit të të drejtës për edukim, për punësim, shërbime shëndetësore dhe rehabilituese apo në forma të tjera, si p.sh. veçimi dhe izolimi për shkak të ekzistencës së barrierave fizike dhe sociale.

Pas viteve '90 shumë ligje për aftësinë e kufizuar janë bërë pjesë e sistemit Legjislativ Shqiptar. Këto ligje dhe rregullore, janë hartuar e miratuar nën presionin e organizatave më aktive të fushës së AK, të cilat synonin të përfitonin të drejtat për kategorinë që përfaqësonin. Kjo praktikë çoi në zgjidhje dhe përfitime të kënaqshme për kohën kur u realizuan, por vetëm për grupime të veçanta të aftësisë së kufizuar dhe, duke mos pasur angazhimin serioz të shtetit, gjeneroi diferencime apo elementë diskriminues midis tipeve të ndryshme të aftësisë të kufizuar.

Nga ana tjetër, ligjet respektive, për të disatën herë janë riparë apo amenduar, duke i trajtuar PAK si përfitues pasivë të të drejtave financiare, ose si të drejta që mund të shprehen si një përjashtim nga disa pagesa apo taksa të caktuara.

Proklamohet se legjislacioni është gjithëpërfshirës. Megjithatë, mund të konstatohet se ai nuk ndërhyr në të gjitha llojet dhe kategoritë e aftësisë të kufizuar, referuar këtu edhe përfitimeve jo të barabarta midis tyre, apo në të gjithë kërkesat e jetës sociale, në mënyrë që të favorizojë dhe garantojë barazinë e mundësive të PAK në jetën e gjithëpërfshirjen sociale.

Në legjislacion disa masa speciale mbrojtëse si parandalimi, trajtimet, riaftësimi, edukimi, integrimi social në pjesën më të madhe thjesht janë deklaruar dhe nuk ka apo janë të pamjaftueshëm mekanizmat ligjorë për të vënë në zbatim ato.

Politikat dhe ligjet në fushën e AK janë akoma të bazuara në modelin mjekësor të aftësisë të kufizuar, duke fokusuar vetëm pacientin te personi me AK, pra duke mohuar njeriun, duke mos arritur dhe garantuar barazinë e mundësive në stimulimin e pavarësisë dhe vetëvendosjes së PAK-ut.

Nëse duam të realizohet integrimi dhe gjithëpërfshirja, procesi duhet te ndryshojë që në fillim - në vlerësimin e AK.

Ka shumë vend për të diskutuar për mënyrën dhe mjetet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Funksionon një strukturë KMCA, e cila vlerëson aftësinë për punë thjesht për të përcaktuar masën e përfitimit financiar, pa vlerësuar aspak se cilat janë nevojat për rehabilitim dhe shërbimeve të mëtejshme për të mundësuar integrimin. Dhe është absurde që kjo procedure është e vetme dhe e njëjtë si për një të rritur ashtu edhe për një fëmijë 0-16.

Parlamenti Shqiptar ka ratifikuar gjatë kësaj periudhe 15-vjeçare disa nga konventat më të rëndësishme të OKB-së dhe Këshillit të Europës si:

- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP)

- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore (KNDESHK), e ratifikuar në vitin 1966,

- Konventa Kundër Torturës dhe Dhunës, Trajtimin apo Ndëshkimin Çnjerëzor dhe Poshtëruës (1949);

- Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979);

- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve (1989);
- Konventa Ndërkombëtare mbi mënjanimin e të gjitha formave të diskriminimit racial (1966).

- karta e rishikuar sociale europiane
- konventa europiane e të drejtave të njeriut

Pavarësisht nga fakti se këto konventa janë bërë pjesë e legjislacionit shqiptar, garantimi i një sërë të drejtash ekonomike, sociale dhe kulturore ende nuk ka gjetur gëzim në mënyrë të plotë edhe për personat me aftësi të kufizuar.

Mjafton të përmendim këtu të **drejtën për arsimim**, e cila është një nga të drejtat themelore të njeriut. Në Legjislacionin Shqiptar kjo e drejtë është sanksionuar si në ligjin themelor, Kushtetutën e RSH, ashtu edhe në ligje specifike. Por pavarësisht nga hartimi në nivele bashkëkohore i Kushtetutës dhe ligjeve tona realiteti është krejt i ndryshëm, e drejta për arsimim nuk është ofruar në plotësim të nevojave dhe aftësive të çdo nxënësi apo studenti me aftësi të kufizuar.

Me aprovimin e Dispozitave Normative të Dhjetorit 2002, iu hap rruga arsimit të integruar në Shqipëri. Në këto dispozita gjen shprehje, për herë të parë dhe në mënyrë të qartë, tendenca bashkëkohore e integritimit të fëmijëve me AK në shkollat e zakonshme, kundrejt veçimit të tyre në institucione speciale, dhe shpallet si i domosdoshëm arsimit gjithëpërfshirës. DN nuk përjashtojnë asnjë kategori fëmijësh nga arsimit i detyruar, pavarësisht nga aftësitë që ata kanë. Në të njëjtën kohë, kjo garanton tri forma të realizimit të edukimit të tyre, si shkollat e zakonshme, shkollat e veçanta dhe institucione të tjera (p.sh., shtëpi), për atë grup fëmijësh të cilët për arsye të ndryshme nuk mund të ndjekin as shkollën e zakonshme as shkollën e veçantë.

Por përpjekjet për t'i udhëhequr fëmijët dhe të rinjtë të pa përfshirë në edukim kanë qenë të pamjaftueshme nga ana e Qeverisë. Shumë fëmijë me AK akoma nuk janë përfshirë në sistemin e edukimit, e për më tepër në atë gjithëpërfshirës.

Gjithëpërfshirja në arsim cilësohet si mjeti më i favorshëm që krijon shanse të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët, me apo pa aftësi të kufizuara, shmang qëndrimet diskriminuese ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta, nxjerr në pah vlerat personale të gjithsecilit, për të cilat një shoqëri e emancipuar ka shumë nevojë, dhe lehtëson integrimin social të tyre në jetën e ardhshme si të rritur.

Problematika të tjera ligjore, të cilat konstatohen lidhur me zbatimin e Dispozitave Normative dhe sistemit të arsimit gjithëpërfshirës në tërësi:

- ende nuk është hartuar kurrikuli i shkollës së zakonshme, që favorizon proceset gjithëpërfshirëse; —nuk është miratuar akti normativ, që rregullon punën me PEI-në (plani edukativ i individualizuar); —mungojnë standardet që të orientojnë mësuesin se në ç’nivel duhet të përvetësojnë programet lëndore nxënësit me AK, në raport me bashkëmoshatarët e tyre; — mungojnë paketa me udhëzime praktike, materiale didaktike dhe standarde integruese në ndihmë të shkollave për ecurinë e procesit të gjithëpërfshirjes;

- mungojnë dispozitat ligjore që të sigurojnë ndërhyrje edukative më të hershme për fëmijët me AK. Në këtë kuadër, *procesi i gjithëpërfshirjes duhet të shtrihet* që në kopsht, pra *në nivel parashkollor*;

- Mosrregullimi ligjor për kategorinë e fëmijëve me AK mendore, të cilët mund të vazhdojnë arsimin parauniversitar (të mesëm të përgjithshëm).

Ka ende fëmijë të cilët janë të padukshëm, të cilët nuk janë ende të identifikuar në statistika dhe që nuk janë duke marrë arsimimin e nevojshëm, ku këtu përfshihen jo vetëm ata në gjendje tepër të rëndë, por edhe ata të cilët kanë vetëm probleme fizike. Gjithashtu, edhe të rinj të cilët nuk janë të integruar në shërbime të ofruara për arsimim special edhe për t’u bërë profesionistë. Ka të rinj të cilët jetojnë në izolim të plotë, pa përfituar asnjë ndihmë.

E drejta për punësim, është një nga elementet kyç për gjithëpërfshirjen sociale dhe pavarësinë ekonomike për personat me aftësi të kufizuar në moshë pune.

Sigurimi i të drejtës së punësimit për personat me aftësi të kufizuar duhet të jetë objektiv i rëndësishëm për një vend demokratik, pasi përmirësimi i politikave dhe situatës së punësimit të PAK-ut sjell përfitim jo vetëm për ta, por edhe për gjithë shoqërinë në tërësi.

Garantimi i kësaj të drejte duhet të sigurohet në kushte të barabarta edhe për PAK-un si edhe për shtetasit e tjerë, në mënyrë që kjo kategori të jetë e aftë të gëzojë jetën në të gjitha aspektet e saj, të kenë një punë të përshtatshme dhe të kenë të ardhura nga puna e tyre, si rrjedhim edhe integriteti i tyre njerëzor respektohet.

Por në krahasim me personat e tjerë që nuk kanë aftësi të kufizuar, punësimi dhe pagat e PAK-ut në Shqipëri janë shumë të ulëta dhe garantimi i kësaj të drejte, pavarësisht nga çfarë është parashikuar

në legjislacion, nuk zbatohet në praktikë.

Ligji nr.7995, dt.20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” (i ndryshuar) pavarësisht nga sanksionet dhe garancitë dhe mënyra bashkëkohore e hartimit të tij, nuk ka gjetur zbatim real në praktikë dhe kjo për disa arsye:

- Në vend kryesisht mbizotërojnë biznese të vogla, të cilat nuk kanë numrin e kërkuar mbi 24 punonjës, ose deklarojnë numër fiktiv punonjësish, duke stimuluar punën në të zezë.

- Edhe ato biznese të cilat kanë numrin e detyruar (24 punonjës) nuk kanë informacionin mbi stimujt inkurajues për punësimin e PAK-ut, informacioni jepet i cunguar edhe nga nëpunësit në zyrat kompetente të punësimit apo inspektoriatit shtetëror i punës dhe kjo për shkak se nuk ka punonjës apo strukturë të veçantë që të jetë i ngarkuar posaçërisht me kategorinë e PAK-ut.

- Personat me aftësi të kufizuar apo familjarët e tyre janë të painformuar mbi të drejtat që ligji u ka garantuar personave me aftësi të kufizuar për sa i përket marrëdhënieve të punësimit.

- Mungon një koordinim i mirë i punës midis zyrave të punës, inspektoriatit të punës dhe sipërmarrjeve për dhënien e informacionit dhe aplikimin e sanksioneve që ekzistojnë në ligj.

- Në vend nuk ekziston as sistem dhe as procedura rehabilitimi profesional për PAK-un, dhe për këtë arsye është e domosdoshme marrja e nismave ligjore për ngritjen e tyre.

- Gjithashtu shumë e nevojshme është të nxiten dhe mbështeten krijimi i vendeve të mbrojtura të punës për PAK-un dhe sigurim i lëvizjes së tyre në vende pune në tregun e hapur të punës, si dhe përmirësimi i politikave dhe programeve për trajnimin dhe formimin profesional të PAK-ut.

Një nga ligjet kryesore, i cili garanton të drejtat e numrit më të madh të kategorisë së PAK-ut, është **ligji “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore”**, nr.9355 datë 10.03.2005, i cili ka për qëllim të përcaktojë ndihmën dhe shërbimet shoqërore për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike dhe shoqërore. Ky ligj, ka shfuqizuar ligjin nr.7710 datë 18.05.1993 “Për ndihmë dhe përkujdesje shoqërore”, dhe ka parashikuar në dispozitat e tij elemente të reja në ndihmë të PAK-ut, por gjithsesi edhe pse ky ligj

është miratuar së fundmi në vitin 2005, ende ndeshen “nota diskriminuese” midis kategorive të personave me aftësi të kufizuar, për sa i përket përfitimit ekonomik dhe mbrojtjes së tyre në baza statusesh.

Në krahasim me ligjin e mëparshëm, ligji “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore” nr.9355 datë 10.03.2005 ka zgjeruar rrethin e përfituesve, me heqjen e kufizimit moshë, duke përfshirë në skemën e pagesës së aftësisë së kufizuar edhe kategorinë e personave të cilëve AK nuk u ka ardhur vetëm si pasojë e lindjes apo për shkaqe të tjera deri në moshën 21 vjeç (apo deri 24 vjeç, kur vazhdojnë shkollën e lartë), ka përfshirë edhe kategorinë e PAK-ut, të cilët janë bërë të tillë për shkaqe të cilat nuk lidhen me punësimin, pra aftësia e kufizuar nuk ka ardhur si pasojë e aksidentit në punë apo marrëdhënieve të punës dhe pavarësisht nga fakti nëse ata kanë qenë kontribues në skemën e sigurimeve në ndodhjen e saj.

Në këtë kontekst, është për t’u përhëndetur përfshirja edhe e kategorive të tjera të PAK-ut, megjithatë nuk do të lëmë pa theksuar se, ende me këtë ligj, vërehet se PAK me aftësi të kufizuar mendore mbeten ende të diskriminuar midis kategorive të tjera (pavarësisht nga moshja) si në aspektin ekonomik, mungesa e statusit përkatës për këtë kategori (përfitimet që ofrojnë statuse të ndryshme të PAK), ashtu edhe në aspektin e parimit të gjithëpërfshirjes.

Ligji nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” përcakton, ndër të tjera, *llojet dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve shoqërore për individët dhe grupet në nevojë*.

Së fundmi, me VKM nr.658 datë 17.10.2005 janë **miratuar Standardet e shërbimeve shoqërore**. Ky vendim përcakton në mënyrë të detajuar standardet e shërbimeve shoqërore të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga ofruesit e shërbimeve gjatë aktivitetit të tyre në qendra ditore, rezidenciale për të gjitha grupet në nevojë dhe që janë përfitues shërbimesh. Po punohet për aprovimin specifik të këtyre standardeve edhe për kategoritë e PAK-ut.

Miratimi i standardeve të shërbimeve shoqërore dhe procesi i decentralizimit që ka shoqëruar së fundmi këtë politikë ka sjellë si domosdoshmërinë dhe përgjegjësinë përpara shtetit shqiptar për ofrimin cilësor dhe sasior të tyre, shërbimeve shoqërore dhe rehabilituese për PAK-un si një nga elementet më të nevojshme për gjithëpërfshirjen e tyre në shoqëri dhe sigurimin e pavarësisë për çdo njërin prej tyre.

Përshtatshmëria. Në kohën që legjislacioni ynë, në një periudhë të zgjatur tranzicioni, po pëson ndryshime të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit, është momenti për të përfshirë në të elementet e domosdoshme për të krijuar mjedisin e përshtatshëm për kategoritë që, pavarësisht aftësisë të kufizuar, kanë forcën, dëshirën dhe të drejtën për ta përdorur mjedisin njëjloj si gjithë të tjerët.

Tentativat e vazhdueshme për përmirësime të ligjit “Për Urbanistikën” reflektojnë kërkesën e qëndrueshmërisë në fushën e planifikimit urban e njëkohësisht faktin që nuk është arritur ende të hartohet një ligj i plotë e bashkëkohor në këtë fushë. Legjislacioni në vetvete ka mungesa të thella për sa i përket fushës së Ndërtimeve, Transportit dhe Telekomunikim të Përshtatur për Personat me Aftësi të Kufizuar (PAK), për të mundësuar integrimin dhe gjithëpërfshirjen e tyre në jetën shoqërore.

Dokumentet ligjore bazë në fushën e planifikimit urban dhe ndërtimeve janë ligji “Për Urbanistikën” dhe “Rregullorja e Urbanistikës”, të miratuara në vitin 1998 dhe amendamentet ligjore të miratuara në vitin 1999, 2000 dhe në vitin 2003.

Janë për t’u vlerësuar tentativat në ligjet e veçanta për personat me aftësi të kufizuar, si në ligjin nr.7889 datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit” (i ndryshuar), Ligji nr.8626 datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit para-tetraplegjik”, ligji nr.8098 datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”.

Në fushën e planifikimit urban janë kryer disa ndërhyrje ligjore për të përmirësuar situatën urbane dhe koordinimin e ndarjen e pushteteve, si edhe për të plotësuar kuadrin ligjor, në përputhje me standardet bashkëkohore europiane. Megjithatë, për sa i përket fushës së aftësisë të kufizuar mbetet ende shumë për të bërë në këto nivele:

- Mungon ende një ligj për përshtatshmërinë e ambientit për të përfshirë edhe përshtatshmërinë në institucione ekzistuese publike, arsimore, restorante, zyra, shërbime të hapura për publikun, përshtatshmërinë e teknologjisë dhe informacionit për PAK-un.

- Duhet të përfshihet gjerësisht kërkesa për përshtatshëmri në të gjithë kornizën e ligjit për planifikimin hapësinor që është në proces hartimi e miratimi.

- Respektimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor për krijimin e një mjedisi ndërtimor turistik, kulturor e sportiv, të përshtatur për

personat me aftësi të kufizuar, nëpërmjet ofrimit të lehtësirave për përdorimin e tij nga personat me aftësi të kufizuar.

Procesi i Shqipërisë drejt aderimit final në familjen e madhe evropiane, gjithashtu, kërkon zbatimin e politikave dhe ligjeve koherente për PAK-un, të cilat nuk mund të realizohen pa një legjislacion të përshtatur në të gjitha fushat që prekin PAK-un. Si rrjedhim është domosdoshmërisht e nevojshme kryerja e reformave legjislative në mënyrë që politikat e Qeverisë Shqiptare të jenë në të njëjtën linjë me politikat evropiane dhe standardet ndërkombëtare.

Ligjet në vazhdim duhet të hartohen duke pasur si parim të përgjithshëm gjithëpërfshirjen, e cila do të përfshijë masa të qarta, afate konkrete dhe sanksione për t'u përmbushur, duke shkuar drejt asaj që është ideale, drejt miratimit të një ligji gjithëpërfshirës për të gjitha kategoritë e PAK-ut. Shteti dhe vetëm shteti mund ta realizojë këtë, natyrisht duke tërhequr mendimet dhe duke bashkëpunuar me organizata të fushës së aftësisë së kufizuar, por duke iu përmbajtur kornizës që përcaktojnë standardet ndërkombëtare. Për shtetin kjo do të çojë në skema më të thjeshta dhe efikase mbështetjeje dhe shërbimesh dhe një menaxhim më të mirë buxhetesh për aftësinë e kufizuar. Në këtë mënyrë do t'i jepet zgjidhje gjithashtu diskriminimit ekzistues ndaj grupimeve të veçanta të aftësisë së kufizuar, bazuar në diferencime ligjore dhe do të promovohen shanse të barabarta për personat me aftësi të kufizuar në zhvillimin social të vendit.

TË RRRITIM MË TEJ KUJDESIN PËR INVALIDËT E LUFTËS

Nuredin Dushani

Nënkryetar i Shoqatës “Invalidët e Luftës Antifashiste të
Popullit Shqiptar”

I nderuar Avokat i Popullit, zoti Ermir Dobjani!

Të nderuar zonja e zotërinj!

Invalidët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare e pritën me shumë kënaqësi organizimin dhe zhvillimin e kësaj Konferencë të organizuar nga Ju, Avokat i Popullit. Ajo është ngjarje historike në jetën dhe aktivitetin e “personave me aftësi të kufizuara”. E para herë në vendin tonë që mbledhet një kuvend i tillë, me përmasa kombëtare, me pjesëmarrje kaq të gjerë dhe me një tematikë kaq të goditur: “Për të drejta dhe dinjitet të barabartë, për personat me aftësi të kufizuara”.

Në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara futen edhe invalidët e Luftës, të cilët, vullnetarisht, që në moshë fare të re iu përgjigjën thirrjes: “Atdheu në rrezik nga pushtimi nazifashist”, vunë në dizpozicion të tij jo vetëm jetën e familjen, por edhe pasurinë, pa asnjë shpërblim. Së bashku me shokët e tyre partizanë dhe me kuadrot drejtues, ata s’e njohën frikën; e përbuzën vdekjen, sulmuan si luanë mbi pushtuesit, duke nderuar veten, popullin dhe atdheun dhe çliruan Shqipërinë.

Në këtë Luftë kaq të ashpër e të pabarabartë, 28 000 shokë e shoqe të tyre partizanë dhanë jetën për të mos vdekur kurrë, mijëra të tjerë u plagosën, një pjesë e të cilëve edhe shumë rëndë, duke humbur pjesë të rëndësishme të trupit, dhe duke mbetur invalidë për gjithë jetën. Invalidët e Luftës janë një kategori e veçantë, specifike e shoqërisë, janë thesar i rrallë dhe i pazëvendësueshëm i kombit dhe i shoqërisë shqiptare, jeta, lufta, puna e aktiviteti i tyre, përkushtimi e ndershmëria janë pika të fuqishme referimi, nderi e krenarie për brezat. Ata janë të pavdekshëm se i pavdekshëm është ideali dhe vepra e tyre e lavdishme. Ata, me ligj, konsiderohen figura

të larta e të nderuara të popullit dhe të atdheut, që gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore nga shteti.

Për këta trima që vunë jetën në rrezik, pa kaluar as tre muaj nga dita e çlirimit, pavarësisht nga vështirësitë e mëdha dhe urgjente që kishte vendi, organet e pushtetit treguan kujdes të veçantë për të plagosurit dhe të gjymtuarit. Me urdhër, ata kaluan për kontroll mjekësor në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak dhe u morën masa për “rikuperimin dhe shërimin e tyre”, me qindra u dërguan në klinika të specializuara jashtë shtetit e, sidomos, në Itali.

Trajtimi i invalidëve u vu mbi baza ligjore. Në gusht të vitit 1945 doli ligji i parë për trajtimin e invalidëve, që u përfshi në vendime të qeverisë dhe udhëhiqej nga njeri prej zëvendëskryeministrave. Ky kujdes i veçantë për invalidët ndikoi në rikuperimin e shpejtë të pjesëve të trupit dhe për përmirësimin e shëndetit të tyre. Kjo bëri që invalidët, me guxim, vullnet e këmbëngulje të merrnin në dorë dhe të drejtonin sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, të mbrojtjes, arsimit dhe pushtetit, duke u bërë frymëzues në mobilizimin e popullit e, veçanërisht, për rininë në realizimin e detyrave. Ky kujdes që u tregua gjatë 50 vjetëve për invalidët u thellua më tej dhe u ngrit më lart nga organet shtetërore mbas ndryshimit të sistemit në vitet nëntëdhjetë.

Në janar të vitit 1993 Kuvendi i Shqipërisë miratoi “Statusin e ri të invalidëve të Luftës”, i cili ishte një dokument i plotë dhe bashkëkohor. Kërkesat e këtij ligji janë ndjekur dhe zbatuar me përparësi gjatë këtyre 16 vjetëve, nga cilado qeveri e majtë apo e djathtë që ka drejtuar vendin. Për t’u përshëndetur është edhe vendimi i Këshillit të Ministrave që në muajin mars 2006, vendim që u rriti 20% pensionin invalidëve. Edhe ministrinë që mbulojnë problemet e invalidëve na kanë qëndruar afër dhe na kanë zgjidhur shumë shqetësime.

Megjithatë, duhet të mbahet në konsideratë fakti se kanë kaluar mbi 60 vjet nga mbarimi i luftës, mbi 60% e invalidëve të Luftës kanë ndërruar jetë. Moshë e tyre sot i ka kaluar të 77 vjetët. Veç këtyre, dihet se plagët e plumbit mjekohen, por nuk shërohen kurrë, sidomos tek ata që edhe sot bashkëjetojnë me copat e predhave dhe të plumbave në trup. Gjithashtu, duhen marrë parasysh edhe sëmundjet e ndryshme kronike që kanë, vështirësitë e jetës gjatë këtij tranzicioni, streset e përditshme etj. Këto dhe arsye të tjera na detyrojnë t’u kërkojmë organeve shtetërore, që kanë në dorë

zgjdhjen e problemeve të invalidëve, të tregojnë më shumë vëmendje e kujdes për këta “dëshmorë të gjallë të atdheut”, që një fije floku i ka ndarë nga vdekja.

Pse e kërkojmë këtë nga organet shtetërore?

E kërkojmë për faktin se ligjet dhe vendimet për invalidët e luftës janë të plota, por mangësi ka predispozicioni dhe lufta konkrete për zbatimin e tyre. Ja një fakt: Ka rreth 3 vjet që ka dalë një vendim i KM për trajtimin e invalidëve. Ai kërkon nga ministritë që të kryejnë procedura apo të nxjerrin akte nën/ligjore për zbatimin e tij. Një pjesë e ministrive s’e ka kryer këtë detyrë dhe ndodh, si Ministria e Shëndetësisë (e cila në përgjithësi ka qenë korrekte me invalidët), që në fillim të këtij viti, me vendim, bëri ndryshime në ilaçet, por invalidët e Luftës nuk i trajtoi dhe na u desh tre muaj përpjekje për ta zgjidhur, kjo falë ndihmesës e këmbënguljes të Drejtoreshës së Institutit të Sigurimit dhe të Kujdesit Shëndetësor. Invalidët e luftës pajisen nga Ministria e Shëndetësisë me mjete ortopedike, me proteza dhe me mjete lëvizëse të përshtatshme për ta. Por deri më sot ky problem nuk është zgjidhur nga kjo ministri, megjithëse kemi kërkuar disa herë. “Invalidët e Luftës gëzojnë të drejtën e kurimit falas në spitale, në klinika dentare dhe në qendra kurative”. Na vjen keq, por jemi të detyruar t’ju themi, se në këtë drejtim ka një mospërfillje për ta; atyre nuk u kushtohet ai kujdes që meritojnë.

Gjithashtu, udhëtimi i invalidëve të luftës me mjetet e transportit ndërqytetar bëhet me gjysmën e vlerës së biletës. Për rastet kur këto transporte janë private, organet përkatëse, në kontratat me subjektet private, parashikojnë efektet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj pike. Ministria që mbulon këtë sektor është mjaftuar me një shënim në licencë, dhe shoferët jo vetëm që nuk i marrin, por i zbresin shumë herë nga makina, madje edhe i ofendojnë! Një gjë e tillë ndodh edhe me zbatimin e vendimit për “shpenzimet e varrimit të invalidit të Luftës, të cilat i përballon Bashkia ose Komuna”. Por ky problem ka gjetur zgjidhje vetëm në bashkitë e qyteteve të mëdha, se bashkitë e zonave të thella apo komunat e ndryshme s’e njohin fare.

I pajustificuar është edhe veprimi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili, që prej 5 muajve, u mbajti invalidëve lekët që u takonin sipas vendimit të qeverisë, të marsit të këtij viti. Ka edhe probleme të tjera që shqetësojnë jo vetëm invalidët, por edhe veteranët e Luftës që në radhët e tyre ka me qindra të plagosur, por mendojmë se kjo konferencë do të na shërbejë të gjithëve për të

treguar më shumë kujdes për t'u siguruar të drejta dhe shanse të barabarta këtyre personave fatkeq me aftësi të kufizuara.

Ju faleminderit!

ARSIMIMI I PERSONAVE QË NUK DËGJOJNË NË SHQIPËRI

Eduard Ajazi

Kryetar i “Shoqatës së Personave që nuk Dëgjojnë”

Unë dëshiroj të prezantoj sot ke ju një nga çështjet më të rëndësishme të komunitetit të njerëzve që nuk dëgjojnë në Shqipëri, siç është arsimi.

Natyrisht që të gjithë e dimë që arsimi është një pjesë e rëndësishme për jetën e çdo njeriu, por personat që nuk dëgjojnë në Shqipëri janë të privuar nga kjo e drejtë.

Historiku i sistemit arsimor për njerëzit që nuk dëgjojnë në Shqipëri fillon në vitin 1963, me hapjen për herë të parë të Institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë.

Ky institut ka shërbyer dhe vazhdon të shërbejë edhe sot si i vetmi institucion arsimor në të gjithë Shqipërinë për personat që nuk dëgjojnë.

Ky institucion arsimon mesatarisht rreth 150 nxënës në vit nga moshën 6- 17 vjeç. Metoda bazë e mësimdhënies në këtë institucion është oralizmi. Që në fillimet e tij ky institucion i ka dhënë një rëndësi shumë të madhe hartimit të kurrikulave speciale për nevojat e nxënësve të tij, por në dhjetëvjeçarin e fundit ky institucion është orientuar drejt kurrikulave të arsimit të zakonshëm në Shqipëri. Ky institucion pajis nxënësit e këtij instituti me një dëftesë për mbarimin e arsimit 4-vjeçar e barasvlershme kjo me një dëftesë të një shkollë të zakonshme të arsimit fillor klasa I-IV.

Unë mendoj që kjo është një nga mangësitë e para dhe shumë thelbësore, e cila jo vetëm shkel të drejtat për arsim të këtyre fëmijëve, por edhe Nenin 6 pika 1 të Dispozitave Normative për shkollat publike, të miratuara në vitin 2002, ku thuhet: *Arsimi i detyruar është arsimi 8-vjeçar nga klasa I-VIII.*

Si pasojë, nxënësit që nuk dëgjojnë, të cilët mbarojnë institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë në Tiranë, nuk janë në gjendje dhe nuk kanë mundësi që të ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë për arsye

të cungimit të njohurive të tyre gjatë arsimit 8-vjeçar dhe të mosekzistencës së sistemit arsimor për personat që nuk dëgjojnë.

Organizata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk dëgjojnë, duke pasur parasysh eksperiencën e punës së saj shumëvjeçare me njerëzit që nuk dëgjojnë si dhe eksperiencat më të mira në lidhje me arsimimin e njerëzve që nuk dëgjojnë në botë (sidomos të vendeve me standarde të larta sociale, si ato skandinave, USA etj.) si dhe filozofinë dhe direktivat e Federatës Botërore të Njerëzve që nuk dëgjojnë, propozon për mirësimin e sistemit arsimor për njerëzit që nuk dëgjojnë në Shqipëri, që konsiston në:

Sistemi parashkollor

1. Të vendoset një sistem i identifikimit të fëmijëve që nuk dëgjojnë që në moshë të vogël dhe më pas autoritetet lokale duhet të kenë përgjegjësinë për t'i drejtuar këta fëmijë në qendra komunitare.

2. Të hapen qendra komunitare ku fëmijët që nuk dëgjojnë (që në moshë të vogël) dhe prindërit që dëgjojnë mund të shkojnë në mënyrë që të takojnë njerëz të tjerë që nuk dëgjojnë, për të pasur sa më shumë socializim dhe kontakte, për të pasur mundësinë e këshillimit dhe në të njëjtën kohë prindërit mund të marrin edhe mësim në gjuhën e shenjave shqipe.

Në këtë proces duhet të përfshihen njerëz që nuk dëgjojnë të rritur, të cilët do të shërbejnë si modele për prindërit dhe vetë fëmijët që nuk dëgjojnë.

3. Në kopshte të ketë grupe me fëmijë që nuk dëgjojnë (në varësi të numrit të tyre) ose dhe grupe mikse, por stafi duhet të jete i kualifikuar në përdorimin e gjuhës së shenjave shqipe. Të rritur që nuk dëgjojnë duhet të përfshihen në këtë proces.

Sistemi i shkollës

1. Të hapen 4 shkolla për nxënësit që nuk dëgjojnë në Shqipëri, bazuar në ndarjen territoriale.

2. Të punohet me sistemin dygjuhësor në shkollat për fëmijët që nuk dëgjojnë.

3. Gjuha e shenjave duhet të jetë gjuha bazë e mësimdhënies në shkolla dhe gjuha shqipe (si të shkruajmë dhe të lexojmë) të jetë gjuha e dytë. Gjuha shqipe e shenjave nuk ka formë të shkruar, ndaj është e rëndësishme që gjuha e shkruar shqipe është shumë e

rëndësishme për fëmijët që nuk dëgjojnë. Të gjitha materialet e përdorura të jenë në gjuhën shqipe të shkruar dhe kurrikula e përdorur në shkollë të jetë e njëjtë me atë të shkollës së zakonshme.

4. Mësuesit të jenë profesionistë në gjuhën shqipe të shenjave dhe është e rëndësishme të kemi mësues që nuk dëgjojnë të përfshirë në procesin e mësimdhënies, të cilët do të shërbejnë si model për nxënësit që nuk dëgjojnë

5. Të hapen shkolla të mesme për njerëzit që nuk dëgjojnë, me të njëjtën kurrikul si në shkollat e tjera normale, ku gjuha e shenjave të jetë gjuha e mësimdhënies dhe gjuha shqipe të jetë gjuhë e dytë. Mësuesit duhet të jenë njohës shumë të mirë të Gjuhës së shenjave shqipe dhe mësues që nuk dëgjojnë duhet të jenë pjesë e stafit pedagogjik.

6. Njerëzit që nuk dëgjojnë të kenë mundësinë për të ndjekur universitetin pa kufizime, në degën në të cilën ata mund të studiojnë.

7. Të ketë një numër të mjaftueshëm interpretësh në nivelin universitar.

8. Të ketë trajnime profesionale të vlefshme për njerëzit që nuk dëgjojnë dhe shërbime interpretimi në të njëjtën kohë.

9. Të krijohet dhe zhvillohet një punë kërkimore nga ana e institucioneve shtetërore në drejtim të gjuhës së shenjave shqipe, të cilat të kenë edhe përgjegjësinë e botimit të fjalorëve në gjuhën e shenjave shqipe dhe materiale të tjera për gjuhën e shenjave shqipe. Ky proces të financohet nga qeveria shqiptare.

10. Të hapet një degë e re pranë Universitetit të Tiranës, ku të diplomohen njerëz që dëshirojnë të jenë interpretë të gjuhës së shenjave shqipe.

TË AFTË NDRYSHE, POR TË BARABARTE ME TË GJITHË

Mybere Prizreni

Kryetare e “Shoqata e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë”

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj, pjesëmarrës në këtë konferencë!

Të flasësh për të barabartë mes të barabartëve, është një çështje e ndërlikuar, aq më shumë kur flitet për barazi në mes njerëzve dhe personave me aftësi të kufizuar dhe në veçanti për paraplegjikët.

Në fakt duket si lojë fjalësh, por në të vërtetë është ndryshe.

Në Shqipëri personat me aftësi të kufizuar janë ndër personat më të mënjeluar dhe shpesh janë përfshirë në një rreth vicios të varfërisë dhe aftësive të kufizuara. Të dyja këto elemente si aftësia e kufizuar dhe varfëria janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në një mënyrë të tillë ku secila prej këtyre elementeve udhëheq tjetrën. Kjo marrëdhënie krijon një rreth, i cili ka si prirje që t'i përfshijë personat me aftësi të kufizuar në varfëri dhe t'i rendisë ata si ndër personat më të varfër.

Por gjithashtu, edhe në termat jo ekonomikë, personat me aftësi të kufizuar janë të diskriminuar në një sërë mënyrash të tjera si: përjashtimi social, si rrjedhojë e njohurive mbi aftësinë e kufizuar, mënjanimi dhe mungesa e shanseve të edukimit, dhe izolimi social. Si rrjedhojë, aftësia e kufizuar është element i dobësisë, i përjashtimit shoqëror dhe varfërisë.

Një tjetër problem i aftësisë së kufizuar është mungesa e njohurisë mbi këtë fushë. Principi themelor “Asgjë për ne, pa ne” nuk mund të neglizhohet për personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre, me qëllim që ta shohin zhvillimin në një perspektivë afatgjatë.

Shpesh herë e shohim aftësinë e kufizuar si një çështje mjekësore dhe jo si një çështje të të drejtave të njeriut, ndërkohë që theksi duhet vendosur mbi përfshirjen se sa mbi aftësinë e kufizuar. Ajo është një çështje e pjesëmarrjes së barabartë në shoqëri dhe jo vetëm

e rehabilitimit. Kështu që adresimi i çështjes së mobilizimit dhe e emancipimit të personave me aftësi të kufizuara në mënyrë sa më efektive është një nevojë tepër urgjente.

U përmend pak me sipër çështja e fuqizimit dhe edukimit të personave me aftësi të kufizuar. Kjo çështje përbën një tjetër problem që haset në aftësinë e kufizuar dhe që sigurisht shoqërohet me pasojë. Duke e konsideruar aftësinë e kufizuar si një çështje e të drejtave humane, asnjë më mirë se vetë personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat përkatëse nuk do t'i mbronin të drejtat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Por që të arrihet kjo është tepër i rëndësishëm ndërtimi i kapacitetit tek organizatat që merren me çështjet e aftësisë së kufizuar. Ky kapacitet ka të bëjë me menaxhimin dhe drejtimin e shoqatës apo organizatës dhe arrihet duke bërë trajnime në avokati, duke ofruar përkrahje financiare etj. Dhe për sa kohë që ky kapacitet rritet dhe fuqizohet personat me aftësi të kufizuar dhe organizatat do të kenë një kontribut në zgjidhjen e problemeve të personave me aftësi të kufizuara dhe në zhvillimin e shoqërisë, do të kenë një rol në orientimin e politikave, në monitorimin dhe implementimin e tyre.

Në vazhdim të asaj çka u përmend pak më sipër, për sa i përket ngritjes së kapacitetit të organizatave me aftësi të kufizuara, po insistoj të vë theksin mbi këtë çështje, pasi në të shumtën e rasteve ka një prirje nga organizatat donatore që donacionet e tyre financiare t'ua japin atyre. Për këtë qëllim e shoh të nevojshme ngritjen e një partneriteti apo bashkëpunimi sa më efektiv midis OJQ-ve donatorëve apo qeverisë.

Një barrierë mjaft e debatuar për personat me aftësi të kufizuar është dhe infrastruktura, ku futen transporti urban, përshtatshmëria e trotuareve, e banesave etj.

Problem tjetër shqetësues për personat me aftësi të kufizuar është dhe çështja e strehimit, ku ne jemi të vetëdijshëm se çështja e strehimit është problematike edhe për shtresat e tjera të popullsisë, por për personat me aftësi të kufizuara në veçanti (paraplegjikët) është çështje kryesore që duhet parë me përparësi nga ana e shtetit.

Në nenin nr.17 të statutit të Invalidit Para & tetraplegjik, shteti merr përsipër kredi lehtësuese për strehimin, por me këtë kredi paraplegjikët nuk janë në gjendje të blejnë apartamente, pasi çmimi i tyre është shumë herë më i lartë, dhe në të njëjtën kohë janë në gjendje të shlyejnë detyrimet ndaj shtetit. Prandaj kërkojmë që

institucionet shtetërore në bashkëpunim me shoqatat ose organizatat e ndryshme që operojnë në fushën e aftësisë së kufizuar të marrin masa konkrete që problemi i strehimit të marrë zgjidhje, ku më tepër përparësi t'u jepet rasteve më emergjente.

Problem tjetër është rimbursimi i pajisjeve higjieno-sanitare.

Qeveria dhe Parlamenti miratuan një për mirësim në ligjin nr.8626 datë 22/06/2000, ku të sëmuret para & tetraplegjikë do të kenë dy përfitime:

Përfitojnë falas barnat e mbuluara nga skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor.

Rimbursohen për mbulimin e shpenzimeve të paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare.

Aktualisht të sëmuret para & tetraplegjikë si barnat ashtu dhe pajisjet higjieno-sanitare vazhdojnë t'i paguajnë nga xhepi, pasi rimbursimi i tyre është me kosto shumë të ulët, për të mos thënë që nuk është fare.

Çështje tjetër shqetësuese është dhe çështja e karburantit që, me vendim të Këshillit të Ministrave nr.687 datë 15/12/2000, shteti rimbursos shpenzimin për blerjen e karburantit të invalidëve, me vlerë 4 000 mijë lekë në muaj, ndërkohë që çmimi i naftës ka ardhur duke u rritur vazhdimisht dhe vlera e rimbursimit vazhdon të jetë po ajo, dhe për këtë arsye ne kemi kërkuar që vlera e miratuar të rritet në 8 000 mije lekë, por fatkeqësisht kërkesa jonë nuk është marrë parasysh.

Problem tjetër shqetësues dhe emergjent (duke llogaritur afatin kohor) është dhe çështja e *Legalizimit* të banesave për personat me aftësi të kufizuar. Duke qenë se ky proces shoqërohet me një kosto, ne kërkojmë që shteti t'i legalizojë këto banesa *falas* (bëhet fjalë kur banesa është në emër të invalidëve).

Në fillim të diskutimit tim për menda faktin që aftësia e kufizuar është element i dobësisë, i përjashtimit shoqëror dhe varfërisë. Për këtë çështje do të kisha dëshirë të sugjeroja një zgjidhje që ndoshta nuk mund të konsiderohet si një zgjidhje definitive dhe e përhershme e problemeve që aftësia e kufizuar dhe personat me aftësi të kufizuar hasin, por nëse do të bëhet e mundshme aplikimi i saj në aspekte të caktuara mendoj se mund të jetë një instrument i suksesshëm.

Dhe ky instrument është aplikimi i fondeve sociale, të cilat kanë si qëllim në vetvete adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuar dhe integrimin e tyre në shoqëri, i cili është një nga objektivat

kryesorë të aftësisë së kufizuar. Nga aplikimi i këtyre fondeve sociale mund të realizohen projekte të cilat kanë si objektiva: trajnime punësimi, rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të popullsisë ndaj personave me aftësi të kufizuar dhe të aftësisë së kufizuar si fushë në përgjithësi, të trajnojë kujdestarët dhe anëtarët e familjeve me metodat më të mira se si të punojnë me personat me aftësi të kufizuar, të ofrojnë shërbime sociale dhe shëndetësore për kategorinë e personave në fjalë, të ofrojë aktivitete kulturore dhe artistike. Ndërkohë që mbështetja e këtyre fondeve sociale bëhet e mundur vetëm me përkrahjen e donatorëve dhe institucioneve të rëndësishme si Banka Botërore, për shembull. Prandaj dhe për menda pak më sipër që është i nevojshëm bashkëpunimi dhe partneriteti midis OJQ-ve, donatorëve dhe qeverisë, pasi bashkëpunimi me këto institucione të rëndësishme mund ta bëjë të mundur realizimin e këtyre fondeve sociale.

Në fund të këtij diskutimi dua të falënderoj për vëmendjen dhe kohën që më kushtuat.

MENDIME PËR LEGJISLACIONIN AKTUAL PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Vera PAJA

Kryetare e “Shoqatës së Grave dhe Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar”

Puna e Shoqatës së “Grave dhe fëmijëve invalidë” ka qenë dhe është në shërbim të misionit dhe objektivit tonë, të kontribuojmë dhe të bëjmë të mundur që personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë të gjitha të drejtat civile, politike, shoqërore, ekonomike, arsimore dhe kulturore, të njohura në konventat dhe traktatet ndërkombëtare, europiane dhe të Kombeve të Bashkuara, si dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ne, përveç punës që bëjmë për të zbutur sado pak varfërinë nëpërmjet ndihmave humanitare, po përpiqemi gjithashtu të futim një mentalitet të ri të përparuar në opinionin publik dhe në vetë personat me aftësi të kufizuar, se ata janë pjesë e shoqërisë, se mund dhe duhet të përfshihen si pjesëmarrës aktivë në të gjitha fushat e jetës së përditshme, dhe se ata mbijetojnë jo pse mëshirohen nga të tjerët, por sepse kanë lindur të lirë dhe se shteti dhe shoqëria është e detyruar të sigurojë për ta të gjitha të drejtat e tyre, për një jetë me dinjitet dhe prosperitet, larg çdo nënvlerësimi dhe diskriminimi. Ne po bashkojmë përpjekjet tona me ato të të gjitha OJQ-ve, për një shoqëri jorefraktare ndaj personave me Aftësi të Kufizuar, për një shoqëri që inkurajon dhe mundëson gjithëpërfshirjen e tyre, dhe që u siguron një cilësi më të lartë jetese.

Duke njohur gjendjen në të cilën jetojnë personat me aftësi të kufizuar, psikologjinë dhe kërkesat e tyre dhe duke bashkëpunuar me organet përkatëse qeveritare, ne kemi dhënë kontributin tonë modest në konceptimin dhe nxjerrjen e ligjeve dhe vendimeve për këtë pjesë të shoqërisë sonë.

Gjatë këtyre viteve të tranzicionit është krijuar një legjislacion që u jep jetë gati të gjitha të drejtave që përcaktohen në dokumentet ndërkombëtare për personat me AK. Kjo pa dyshim është një arritje me rëndësi.

Problemi i parë që del lidhur me këtë legjislacion është se ai ka akoma nevojë të plotësohet dhe të sistemohet.

Kuadri ligjor është mjaft i shpërndarë. Ka ligje të veçanta për invalidët e punës, për të verbrit, për para dhe tetraplegjikët; ka disa ligje për ndihmën ekonomike, pensionin e invaliditetit, shërbimeve e përkujdesit shoqëror; për punësimin e PAK etj. Ky legjislacion është mjaft fragmentar e i copëzuar dhe si rrjedhojë, përveç të tjerash, në praktikë hasen mjaft vështirësi për njohjen e thelluar të tij, pra edhe për zbatimin e tij. Ky kuadër ligjor është e nevojshme tani t'i nënshtrohet një studimi tërësor, për të parë se sa ai është në koherencë me standardet ndërkombëtare, si dhe për ta ballafaquar edhe me përvojën e deritanishme në zbatimin e tij. Mbi këtë bazë të shikohet mundësia e hartimit të një ligji integral për aftësinë e kufizuar, duke bërë njëkohësisht edhe korrigjimet e nevojshme.

Në kuadrin ligjor në fuqi mungon statusi për personat me AK. Ky status ekziston për të verbrit (Ligji nr.8098 dt. 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”); për para dhe tetraplegjikë (Ligji nr.8625, dt. 22.06.2000); për invalidët e punës (Ligji 7889, datë 14.12.1994). Të gjitha këto nuk plotësojnë nevojat e personave me AK, që nuk janë as të verbër, as paraplegjikë, as invalidë të punës apo të luftës. Pra, mendoj se është i nevojshëm një ligj tërësor, “Për statusin e personave me AK”.

Në mjaft nga ligjet ka mangësi ose nene që nuk i përgjigjen realitetit. Në Ligjin Nr.7995, dt.20.09.1995, “Për nxitjen e punësimit”, neni 15 parashikon që subjekti që ka të punësuar 25 punonjës, njëri prej tyre duhet të jetë me AK. Por dihet se në Shqipëri mbizotërojnë bizneset e vogla me pak punëtorë. Kështu që ky nen është gati formal, madje pengues për punësimin e personave me AK.

Në ligjin: [Nr.9355. datë 10.03.2005](#) nuk përfshihen të gjitha rastet. Ne si shoqatë kemi mjaft anëtare nëna me AK, që kanë fëmijë me AK. Për të gjithë është e qartë se vështirësia dhe problemet në këtë rast janë të shumëfishuara, por ligji 9355 nuk i merr parasysh si raste të veçanta.

Probleme të tilla ka mjaft në legjislacionin aktual, prandaj është i nevojshëm një shqyrtim tërësor i tij.

Por problemi më i madh në legjislacionin e sotëm ka të bëjë me faktin se ai në shumë raste nuk gjen zbatim në praktikë.

Marrim p.sh. ligjin nr.7995, “Për nxitjen e punësimit”, që

përmendëm më lart, po thuaj se nuk po zbatohet. Edhe Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë ndalon çdo lloj diskriminimi në punësimin dhe trajnimin profesional të personave me AK.

Por nga të gjithë anëtarët e mija me AK, asnjëra nuk ka mundur të fitojë një vend pune, në zbatim të këtyre ligjeve.

E njëjta gjë mund të thuhet për Ligjin nr.8872, dt.29.03.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj personave me AK u siguron kualifikime falas në qendra publike. Por edhe ky ka mbetur në letër për personat me AK. Të dy këto ligjet e fundit nuk zbatohen, sepse nuk sigurohet ligjërisht nxitja për krijim vendesh pune për personat me AK, ngritja e qendrave speciale për punësimin e tyre si dhe të qendrave për kualifikimin dhe trajnimin profesional të tyre, në mënyrë që ata të jenë të pranueshëm e të dobishëm në tregun e punës.

Në ligjin nr.7952 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dt. 21.06.1995, parashikohet hapja e një sistemi të integruar kopshtesh e shkollash të nivelit fillor e të mesëm, ku të mësojnë edhe fëmijët me AK. Por në fakt jemi akoma larg zbatimit të këtij ligji. Mungesa e infrastrukturës në shkollat ekzistuese për këtë aktivitet, si dhe moskualifikimi i vetë mësuesëve për t’u marrë me këta fëmijë, bën që vetë shkollat të jenë refraktare e mospranuese për fëmijët me AK. Ligjet duhet të shoqërohen me vendime e programe speciale integrale, që sigurojnë zbatimin në praktikë të tyre.

Probleme të tilla gjejmë edhe në ligjet në fushën e shërbimeve, veçanërisht në ato që kanë të bëjnë me një shërbim shëndetësor riaftësues dhe parandalues për personat me AK.

Një problem tjetër është edhe mosnjohja e këtij legjislacioni kaq shumë të shpërndarë edhe nga vetë personat me aftësi të kufizuar si dhe nga institucionet përkatëse. Prandaj do të ishte mirë të gjendeshin mundësitë për ta botuar këtë legjislacion në broshura të posaçme, të shoqëruar edhe me udhëzime për një kuptim më të saktë të ligjeve.

VLERËSIMI I NEVOJAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Zela Kola

“Shoqata e Mbrojtjes së të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar”, me qendër në Librazhd

Vlerësimin që një person është me aftësi të kufizuar e bën KMCAP, i cili është i përbërë nga një grup mjekësh të specialiteteve të ndryshme.

Këto komisione janë të ngritura nga Ministria e Shëndetësisë dhe funksionojnë në bazë qarku dhe rrethi. Ato arrijnë në përfundimin për një person që është me aftësi të kufizuar I PAAFTË PËR PUNË NJË VIT. Kjo gjë thuhet edhe për një fëmijë një vjeç ose më shumë. Në bazë të këtij përcaktimi personi me aftësi të kufizuar përfiton vetëm pagesën 8 000 lekë, që jepet nga buxheti i shtetit nëpërmjet zyrës së shërbimeve shoqërore në komuna dhe bashki.

Në një ditë nga ky komision mund të vlerësohen rreth 50-60 persona (p.sh. në Tiranë, 90 persona.)

Vetëm dokumentacioni që duhet të shikohet nga ky komision në këtë rast, pra 90 dosje, na duken shumë e jo më të jepen vlerësime për çdo person. Këshilla që ai duhet të ndjekë e të tjera...

Rruga që duhet të ndjekë një fëmijë ose një i rritur për të arritur te ky komision është tepër e gjatë. Por nuk dëshiroj të ndalem te këto.

Në SKPAK, miratuar në vitin 2005 nga qeveria shqiptare, person me aftësi të kufizuar quhen: “ata persona të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor ose gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen për më shumë se gjashtë muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse, gjë që sjell për pasojë kufizime të pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore”.

Sipas standardeve ndërkombëtare, fokusi i përcaktimit të aftësisë së kufizuar zhvendoset nga arsyeja e dëmtimit në perspektivën e zhvillimit të personave të dëmtuar dhe pjesëmarrjes se tyre të

përditshme në jetën shoqërore, si dhe masat që duhet të ndërmerren për të shmangur, minimizuar dhe kompensuar këto kufizime.

Në të njëjtën kohë, fokusi në politikat që do të ndiqen do të ndryshojë nga aftësia e kufizuar në aftësinë dhe kompetencat e personave me aftësi të kufizuara. Atëherë a mund ta kryejë ky Komision (KMCAP) këtë detyrë? Mendojmë që jo.

Pra, nuk duhet të themi nga një ekip mjekësh, për një fëmijë, vetëm fjalët “I paaftë për punë një vit” dhe vetëm kaq. Çfarë do të bëhet me këtë fëmijë, nga ky komision nuk i jepet asnjë këshillë. Dhe prindërit pastaj do të kërkojnë informacione të tjera, po ku t’i gjejnë? Te shoqata ata gjejnë vetëm informacionin bazë për të drejtat e fëmijës me aftësi të kufizuara, shërbimet që mund t’i japë shoqata dhe një drejtim drejt të vetmes Qendër Vlerësimi dhe Zhvillimi që gjendet në Tiranë. Por a mund të vijnë prindërit nga zonat e thella deri këtu? A mund t’u shërbejë kjo Qendër gjithë fëmijëve të Shqipërisë? Po për të rinjtë me aftësi të kufizuara çfarë vlerësimi kemi?

Ka ardhur koha të ndryshojmë. Ne si shoqatë në partneritet me *Save the Children* dhe zyrën arsimore Librazhd po aplikojmë projektin Arsimi Gjithëpërfshirës – Kërkesë e Mileniumit të Ri. Në këtë projekt vlerësimi i nevojave të çdo fëmije dhe hartimi i një plani edukativ të veçantë për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, është përparësi. Nga ky vlerësim dalin edhe rezultatet që kanë arritur të 153 fëmijët me aftësi të kufizuara të përfshirë në shkollat nëntëvjeçare të arsimit të detyruar.

Por në Botë po shkohet drejt një ideje tjetër.

Në kongresin e 9-të ndërkombëtar për Shërbimet Komunitare për fëmijët, të rinjtë dhe familjen e tyre, theksi u vu në kujdesin që duhet të tregohet në mënyrë të veçantë për familjen, pra duhen vlerësuar nevojat e familjes që ka një person me aftësi të kufizuara. Për të arritur drejt vlerësimit të nevojave të familjes dhe fëmijëve e të rinjve me aftësi të kufizuara, duhet ndryshuar tërësisht vlerësimi që i duhet bërë personit me aftësi të kufizuara. Ka ardhur koha që të shkojmë drejt vlerësimit të nevojave që ka familja e personit dhe të përcaktohen nga ky komision që do të bëjë këtë vlerësim. Shërbimet bazë që i duhen dhënë edhe personit, në mënyrë që të shkojmë drejt përmirësimit të aftësive të tij, për ta bërë më të pavarur për jetën dhe jo barrë të shoqërisë.

LEGJISLACIONI SHQIPTAR NË FUSHËN E PAAFTËSISË MENDORE DHE ZBATIMI NË PRAKTIKË

Nasi Duka

President i Përgjithshëm i Shoqatës Kombëtare
“Në Ndihmë të Handikapëve Mendorë”

I nderuar z. Avokat i Popullit!

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Si përfaqësues i shoqatës Kombëtare “Në Ndihmë të Handikapëve Mendorë” të Shqipërisë, kam jo vetëm nderin dhe privilegjin që jam i pranishëm në këtë Konferencë Kombëtare, që organizohet me iniciativën e Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Shqipërisë dhe organizatorëve të tjerë, por edhe të drejtën e respektit për të shprehur edhe ne, në emër të shoqatës, mendimet dhe sugjerimet tona në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe liritë themelore të personave të paaftë mendorë e fizikë, dhe zbatimin në praktikë të këtyre të drejtave në Shqipëri.

Në të gjithë botën, në çdo shoqëri, ka njerëz të paaftë të të gjitha niveleve dhe kategorive, kudo ku jetojnë, ata kanë një standard jetese shumë më të ulët se të tjerët dhe shpesh janë të izoluar e të shkëputur nga shoqëria. Të paaftët janë më të varfër, përfitojnë pak ose aspak edukim, ose një edukim të dorës së dytë, kanë shumë më pak shanse për t’u punësuar dhe jetojnë nën nivelin e varfërisë. Ata gjithashtu provojnë diskriminimin në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë transportin, strehimin, marrëdhëniet dhe jetën familjare, ndihmën sociale, përfaqësimin dhe pjesëmarrjen në jetën shoqërore.

Tradicionalisht, paaftësia është parë si “një problem” i individit dhe ishte individit ai që duhej t’i përshtatej shoqërisë me anë të rehabilitimit, aftësimin apo kurimit. Kohët e fundit personat e paaftë dhe organizatat e tyre kanë treguar nga përvoja dhe eksperiencia e tyre se janë mungesat apo pengesat të cilat tregojnë pamjaftueshmërinë e shërbimit social - ekonomik ato të cilat i ndalojnë të paaftët të marrin pjesë aktivisht në shoqëri.

Natyrisht ky mijëvjeçar i ri karakterizohet nga një sofistikim i emancipimit të shoqërisë, nëpërmjet së cilës duhen shkatërruar këto pengesa reale që hasin personat e paaftë, duke e çuar shoqërinë të këta njerëz dhe jo ata te shoqëria. Kjo duhet kuptuar me faktin që duhet të jetë shoqëria ajo që duhet t'i përfshijë këta njerëz në vetvete, duke u krijuar kushtet e përshtatshme për integrimin, dhe jo të presë që këta të paaftë t'i përshtaten asaj e ta ndjekin në rrugën e zhvillimit. Ndërsa shoqëria ecën përpara me hapa gjigantë, kjo shtresë mbetet prapa, duke mos qenë në gjendje të mbajë të njëjtin ritëm me shoqërinë, kështu që duhen gjetur patjetër mënyrat për t'i krijuar kushtet lehtësuese kësaj shtrese për integrim e zhvillim.

Në këtë kuadër, përveç familjes, dashamirësve, organizatave të ndryshme, strukturave ndihmëse, iniciativave private e shtetërore, një rol të rëndësishëm luan edhe legjislacioni që shërben si bazë mbi të cilin mbështetet çdo veprim dobiprurës për paaftësinë. Nga ana tjetër, qëllim kryesor legjislacioni duhet të ketë mbrojtjen e të drejtave të këtyre personave si qenie njerëzore, sepse, përveç paaftësisë mendore, një disavantazh tjetër i këtyre njerëzve është edhe diskriminimi që ekziston në praktikë, kur shumë prej tyre janë të pambrojtur ndaj abuzimeve, trajtimit degradues dhe lënies pas dore.

Ka ardhur koha për ta ndryshuar këtë situatë krejtësisht çnjerëzore.

Baza mbi të cilën duhet të mbështetemi janë: **“Deklarata ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, 1948”**; **“Deklarata e të drejtave të njerëzve të paaftë, 1975”**; **“Rregullat Standarde të OKB-së”**; **“Deklarata e Varshavës për të drejtat e njeriut, të personave me paaftësi mendore”**; **konventat për të drejtat e njeriut dhe dokumente të tjera ndërkombëtare.**

Në fund të fundit qëllimi ynë kryesor duhet të jetë që të sigurojmë që të drejtat e tyre njerëzore të pranohen me konsekuencë deri në fund, duke u dhënë mundësi atyre për pjesëmarrje të plotë në komunitet dhe jetën familjare, mundësi dhe shanse të barabarta për të kontribuar në shoqëri, të drejtë për vetë-vendosje dhe vetë-përfaqësim.

Po si paraqitet situata në Shqipëri, aktualisht? Mund të themi me siguri të plotë se situata është pak sa kritike. Po marr si shembull legjislacionin e vendit fqinj, Italisë, që ka një ligj nr.104 të 5 shkurtit 1992 me të cilin i kushton plot 44 nene mbrojtjes të të drejtave të

personave të paaftë, duke u mbështetur plotësisht në konventat ndërkombëtare dhe Rregullat Standarde të OKB-së. Në legjislacionin shqiptar, me përjashtim të 4-5 rasteve sporadike, kur neneve për personat normalë i bashkëngjiten klauzola për personat e paaftë, të cilat i akordojnë kushte favorizuese atyre, fjala i paaftë ose paaftësi nuk përdoret gjetiu. Pse ndodh kjo? Këtu luajnë rol disa faktorë: Vendi ynë vjen pas 50 vjet diktature izoluese, gjatë së cilës problemi i paaftësisë trajtohej brenda kuadrit ligjor për personat normalë.

Organizatat joqeveritare nuk ekzistonin dhe në oponencë me shtetin për mbrojtjen e të drejtave të të paaftëve ishte vetë shteti. - Pas viteve '90, Shqipëria kaloi dhe po vazhdon ende të kalojë vite tronditëse të tranzicionit, me një mori ligjesh për t'u ndryshuar nga ligjvënësit tanë në Parlament dhe me një situatë të paqëndrueshme ekonomikopolitike, ndërkohe që shoqëria ishte e mpirë nga mungesa e organizmave joqeveritare dhe e paaftë për të integruar personat me paaftësi mendore. Më vonë, me krijimin e tyre, një rol të rëndësishëm fillojnë të luajnë organizatat joqeveritare të mbështetura nga donatorë e organizma ndërkombëtarë.

Kjo është situata edhe sot e kësaj dite: nga njëra anë një mungesë e theksuar e legjislacionit e nga ana tjetër përpjekjet e shoqatës dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë për ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe krijimin e shërbimeve sociale.

Duke u kthyer te legjislacioni, lind pyetja: Vërtet është kaq i domosdoshëm një legjislacion për të paaftët, kur fare mirë të drejtat e tyre mund t'i mbrojë edhe legjislacioni i përgjithshëm? Në të vërtetë jo gjithçka varet nga legjislacioni: p.sh. në Danimarkë nuk ka një legjislacion "të veçantë"; kurse në Suedi, nuk ka zgjidhje të posaçme ose ligje të përgjithshme për të paaftët e rritur, sepse ata mbulohen kryesisht nga legjislacioni i përgjithshëm. Edhe në Irlandë, legjislacioni ka një tendencë për të dhënë udhëzime, por jo detyrime.

Mungesa e legjislacionit mbushet nga iniciativa e veprimtarive humanitare të privatëve, d.m.th. e shoqatave dhe fondacioneve që veprojnë aktivisht për integrim dhe iniciativave të tjera të reja.

Po në Shqipëri, si do të zgjidhet ky problem? Po të shikosh me vëmendje vendet në zhvillim, të ngjashme me Shqipërinë, siç janë vendet e Europës Lindore, ato e kanë zgjidhur këtë problem duke adoptuar një legjislacion të veçantë për personat e paaftë. Një gjë e tillë mendoj se duhet bërë edhe në Shqipëri, sepse është e pamundur që mungesa e legjislacionit të mbushet vetëm nga iniciativa e

privatëve, për sa kohë që vendi do të jetë në vështirësi ekonomike, e rrjedhimisht me shumë probleme sociale.

Është e rëndësishme që ligji të mbrojtë të drejtat e tyre në një situatë në të cilën, përveç familjeve të të paaftëve dhe shoqatës, askush nuk interesohet për këtë shtresë jo të vogël të shoqërisë. Ajo që ofron ligji për ta deri tani është vërtet pak, po ta krahasojmë me problemet që këta njerëz përballojnë, për më tepër në një situatë të vështirë ekonomike. Përderisa këta janë njerëz me nevoja specifike (speciale), atëherë kanë nevojë edhe për zgjidhje specifike (speciale). Po le të shohim më konkretisht çfarë merr përsipër ligji shqiptar deri tani dhe sa efikas është brenda asaj që merr përsipër të realizojë.

Ligji i parë, i cili ka marrë në mbrojtje personat me prapambetje mendore në Shqipëri, pas viteve '90, është ligji "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", nr.7710, datë 18.5.1993, i cili ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1993. Sipas këtij ligji, përmirësuar më vonë me ligjin nr.7886, datë 8.12.1994, shteti merr në mbrojtje personat me paaftësi të rëndë zhvillimi, ku përfshihen dhe të paaftët mendorë të bërë të tillë që në fëmijëri ose para moshës 21vjeç. Dalja e këtij ligji u shoqërua me VKM nr.311, datë 21.08.1994, si dhe me disa udhëzime të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, të cilat sanksionuan përfundimisht trajtimin social të personave të paaftë nga pushteti lokal, pra nga seksionet e mbrojtjes sociale nëpër komuna e bashki.

Më vonë doli një tjetër VKM, ai me nr.457, datë 21.08.1995, i quajtur "Për përfitim paaftësie", me anë të të cilit, me disa udhëzime të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, u akordohet personave të paaftë një e ardhur mujore e barabartë me 70% të pagës minimale. Kjo do të thotë që sa herë ka rritje të përgjithshme pagash rritet edhe "përfitimi i paaftësisë". E veçanta tjetër e VKM nr.457 është i ashtuquajtur "Përfitim kujdestarie", që është përfitim i një pjesëtari të familjes që kujdeset për personin e paaftë, masa e të cilit është e barabartë me 60% të pagës minimale të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Një problem që ka dalë nga zbatimi në praktikë i ligjit, lidhet me të ashtuquajturin "Përfitim Kujdestarie", i cili sipas VKM nr.457 dhe udhëzimeve të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, përfitohet nga familja e personit të paaftë kur plotësohen disa kritere, njëri prej të cilëve mendoj se duhet korrigjuar. Ky është kriteri sipas të cilit, që një pjesëtar i familjes të marrë "Përfitim Kujdestarie", familja e tij duhet të trajtohet me ndihmë ekonomike nga komuna

ose bashkia. Ky është një paradoks, sepse s' duhet lidhur përfitimi i paaftësisë me gjendjen ekonomike të familjes të të paaftit, përderisa nevojat e tyre janë të njëjta.

Problemi i përfitimit të kujdestarisë natyrisht gjeti zgjidhjen e plotë ligjore nëpërmjet ndërhyrjes së herë pas hershme të shoqatës Kombëtare dhe të vullnetit të mirë të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Një ligj tjetër që mbron të drejtën e personave me prapambetje mendore për t'u arsimuar është dhe ligji nr.7952, datë 21.06.1995, kreu III, "**Arsimi Special Publik**", ku sanksionohet e drejta e arsimit për fëmijë me probleme mendore sipas veçorive të tyre, ose brenda sistemit shkollor ose në klasa apo institucione të posaçme, ku trajtimi i specializuar bëhet falas. Brenda këtij ligji ka mangësi, sepse nuk parashikohet edukimi i të paaftëve në kushte shtëpie, kur ata paraqesin vështirësi lëvizjeje, gjë që jo rrallë ndodh me ta. Në fund të fundit, çdo qenie njerëzore ka të drejtën për arsimim e edukim.

•• Po kështu është rregulluar me ligj edhe kualifikimi i kuadrit të arsimit special nëpërmjet hapjes së degëve apo kurseve të veçanta të specializimit, por zbatimi i këtij ligji në praktikë has mjaft vështirësi, pasi mjaft arsimtarë ngurrojnë të marrin fëmijë të tillë në klasa normale, për vetë faktin e thjeshtë se puna e tyre me këta fëmijë do të jetë e dyfishtë, për të mos thënë më e madhe. Duke pasur parasysh faktin që integrimi i këtyre fëmijëve me probleme mendore në klasa apo shkolla normale do të ndikojë në një farë mënyre në riaftësimin e tyre mendor shumë më shpejt se sa në një institucion të specializuar, mendojmë që me akte nënligjore të veçanta të rritet interesi i atyre arsimtarëve që marrin në klasat e tyre me fëmijë normalë edhe fëmijë të tillë me aftësi të kufizuara mendore, ose me probleme të zhvillimit mendor, të cilët kanë vështirësi në të mësuar, ndonëse edhe tani kanë disa favore, si uljen e numrit të përgjithshëm të nxënësve në një klasë, nëse merr një fëmijë me problem të tilla etj.

Të drejtën për të punuar dhe për të prodhuar të mira materiale e kanë dhe njerëzit me aftësi të kufizuara mendore, të cilët sipas specialistëve mund të kryejnë punë të thjeshta që nuk kërkojnë kapacitet të lartë intelektual dhe nëpërmjet kësaj pune ata mund të riaftësohen sado pak që të jetë e mundur. Këtë të drejtë të tyre e mbron ligji "Për nxitjen e punësimit", nëpërmjet një neni të tij, sipas të cilit çdo punëdhënës është i detyruar të marrë në punë, në çdo 24

persona të punësuar, një person të paaftë fizik apo mendor, e për rrjedhojë shteti e ndihmon atë me zbutjen e detyrimeve fiskale. Ky ligj në këtë drejtim ka mbetur pa u shoqëruar me akte të tjera nënligjore, të cilat do ta plotësonin atë dhe do ta bënë praktikisht të aplikueshëm për zbatim.

Megjithatë, mendojmë që në situatën e vendit tonë, me një shkallë mjaft të lartë papunësie, punësimi i personave me aftësi të kufizuara mendore ka kaluar përkohësisht në plan të dytë, e s'na mbetet veç të shpresojmë që në të ardhmen do të jetë një nga format kryesore të riaftësimit dhe integritit të tyre në një shoqëri të civilizuar. Mirëpo, për të arritur te punësimi, një i paaftë e ka të domosdoshme të fitojë njohuri elementare për punën. Pa ndjekur kurse të trajnimit profesional, ai do ta ketë të pamundur përshtatjen në vendin e punës.

Ligji nuk merr përsipër trajnimin profesional të të paaftëve mendorë dhe as ngritjen e qendrave speciale të punës të tipit të workshop-eve për të paaftët e rëndë. Po kështu, në ligjin për "Sigurimet Shëndetësore" sanksionohet e drejta për të marrë falas barnat që i përkasin diagnozës, dhe me rimbursim barnat e tjera, si dhe shpenzimet e shërbimit nga mjeku i përgjithshëm apo i familjes falas.

Një problem kryesor lidhur me legjislacionin mendojmë që është mosnjohja e ligjeve që mbrojnë personat me aftësi të kufizuara mendore, nga anëtarët e shoqatës, pra nga prindërit dhe të afërmit e këtyre personave. Dhe, nëse nuk e njeh mirë një ligj, nuk di as përfitimet që të jep dhe siguron ai. Mendojmë që bërija publike e ligjeve, jo vetëm do të bëjë që ato të zbatohen drejt në praktikë, por edhe që prindërit mund të japin mendime për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor.

Pra, siç shihet, ligji merr përsipër t'u plotësojë personave të paaftë, **pjesërisht dhe në veçanti**, të drejtën për edukim, të drejtën për përkujdesje mjekësore dhe të drejtën për punësim që nënkupton në aparence edhe mbrojtjen nga diskriminimi. Natyrisht edhe brenda këtyre ligjeve në fuqi ka shumë mangësi dhe gabime, të cilat duhen korrigjuar sa më shpejt.

Diskriminimi te kjo kategori njerëzish nuk duhet parë vetëm si një problem social, por edhe si një fenomen i rrezikshëm mbarëshoqëror në sistemin demokratik.

Detyrë imediate e shoqatës, tani për tani, është që të kërkojë përgatitjen e një kuadri të plotë ligjor, për të ndihmuar personat me paaftësi mendore drejt integritit dhe pjesëmarrjes aktive në shoqëri.

Jemi të ndërgjegjshëm se ndoshta kemi pritur situata të përshtatshme dhe të favorshme ekonomiko-politike për të pasur efektivitet në veprime konkrete dhe në praktikë. Por, të paktën të punojmë tani në situata të stabilizuara, me synim që të sigurojmë një legjislacion të plotë bashkëkohor. Shoqata natyrisht ka kohë që ka hartuar Draftin, **projekt-status**, që ia ka paraqitur më 15 tetor të vitit 1997 Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Qeverisë dhe Parlamentit Shqiptar për miratim, i cili ende nuk është miratuar. Këtë vonesë kohore ne e konsiderojmë jo vetëm të pajustificuar, por dhe një mungesë të theksuar të vëmendjes nga ana e qeverisë dhe shtetit për këtë kategori njerëzish me nevoja të veçanta. Prandaj i bëjmë thirrje edhe një herë të gjithë së bashku qeverisë që të gjejë rrugë dhe mundësi për të miratuar statusin e personave me aftësi të kufizuara mendore.

Statusi merr përsipër t'u krijojë kushte lehtësuese personave të paaftë mendorë e fizikë, për një jetë dinjitoze dhe aktive në shoqëri.

Ishte një rast i veçantë dhe i rëndësishëm për ne, i përfaqësueseve të shoqatës sonë, kontakti dhe bashkëbisedimi me komisionin parlamentar të hartimit të projekt-kushtetutës, për t'u siguruar edhe personave të paaftë mendorë vendin e tyre në Kushtetutë. Nga ky takim i frytshëm dypalësh institucional u pa i arsyeshëm dhe me vend përfshirja e kësaj kategorie njerëzish në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky fakt le të shërbejë edhe sot për përgatitjen sa më shpejt të ligjit të ri integral për personat e paaftë.

Të nderuar zonja dhe zotërinj!

Kjo ishte dhe është, shumë-a-pak, arritja më e rëndësishme dhe pasqyra e shkurtër e gjendjes aktuale e zbatimi në praktikë i problemeve dhe i shqetësimeve të personave të paaftë mendorë, prindërve, kujdestarëve të tyre dhe ligjit, në raport me njëri-tjetrin, në vendin tonë.

Sigurisht në këtë fushë mbetet akoma shumë për të bërë dhe kjo është detyrë e familjes, e specialistëve të fushës, e shoqatës, e shtetit dhe mbi të gjitha e shoqërisë. Një shoqëri që respekton me dinjitet personat e paaftë të saj, respekton vetveten dhe kur respekton vetveten e respektojnë të gjithë.

Ju faleminderit!

UDHËKRYQI I LEGJISLACIONIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ndrek Ismajli

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Drejtoria e Shanseve të Barabarta

ARSYET

- Mënyra e hartimit.
- Mungesa e marrjes së iniciativës nga shteti.
- Mosparashikimi i një kostoje reale.
- Mungesa e studimeve paraprake.
- Mungesë statistikash e të dhënash.
- Mosprania në grupin iniciator të ekspertëve.
- Shikimi i projektligjit vetëm nga përfitimi financiar.
- Mungesa e nxjerrjeve të akteve nënligjore.

98

Mënyra e hartimit

- Grupe të interesit shumë herë janë detyruar të bëjnë presion mbi qeveritë për të hartuar ligje dhe ia kanë sugjeruar ato.
- Shumë herë ligjet janë kopjuar nga OJF apo shtete të tjera.
- Në disa raste ai është përdor si pasqyrë për ata që e kanë përpiluar dhe kanë harruar grupe të tjera.

Mungesa e marrjes së iniciativës nga shteti

- Thujtse të gjitha ligjet për PAK janë inicuar nga Shoqatat e AK.
- Ka çuar në fragmentim të grupit me të njëjtën AK.
- Ligji është marrë shabllon nga OJF.

Mosparashikimi i një kostoje reale

- Ka sjellë përplasje institucionale.
- Vonesë në zbardhjen e akteve nënligjore.
- Zbardhje të përgjysmuar të këtyre akteve.

Mungesa e studimeve paraprake

- Diskriminim në mes të Aftësisë së Kufizuar.
- Marrje privilegjesh të pamerituara nga disa persona.
- Pagesa të njëjta për aftësi të kufizuara të ndryshme.
- Mosofrim shërbimesh, por vetëm pagesa në Cash.

Mungesë statistikash e të dhënash

- Çdo iniciativë, ligj apo strategji, në mungesë të statistikave dhe të dhënave se kujt do u shërbejë, do ishte e dështuar.

Mos prania në grupin iniciator të ekspertëve

- Sjell diskriminim.
- Mosofrim të shërbimeve të duhura.
- Lënie jashtë skemës së mbulimit financiar PAK me të njëjtën shkallë të AK.
- Mosqendrueshmëri të ligjeve në kohë.
- Përplasje të ligjeve me njëri-tjetrin.

Shikimi i projektligjit vetëm nga përfitimi financiar

- Mungesë integrimi të PAK-së.
- Mosofrim shansesh për të qenë të denjë në shoqëri.
- Moskrijim rrugësh e gjetje mjetesh për të kërkuar më të mirën (rënie në rehati).
- Mosofrime shërbimesh në kohën, vendin e cilësinë e duhur.
- Krijim problemesh sociale në familje deri në konfliktualitet.

Mungesa e nxjerrjeve të akteve nënligjore

- Konflikt institucional.
- Zvarritje në zbatim të ligjit.
- Krijim kushtesh për korrupsion.
- Diskriminim të PAK.

Faleminderit!

DISKUTIM NË KONFERENCËN KOMBËTARE “TË DREJTA DHE DINJITET TË BARABARTË PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

Dr. Veip Proda

Kryetar i Shoqatës “Mbrojtja, Integrimi dhe Socializimi i
Artistëve me Aftësi të Kufizuara”

Në radhë të parë falënderoj Avokatin e Popullit dhe institucionin që ai drejton, për këtë nismë shumë të rëndësishme që ka ndër marrë, së bashku me subjekte të tjera, që merren me aftësinë e kufizuar në Shqipëri. Së dyti, dua të vlerësoj se gjatë këtyre viteve tranzicion është bërë dhe vazhdon të bëhet një punë voluminoze propagandistike sidomos, por edhe ligjore, morale e materiale në drejtim të aftësisë së kufizuar. Megjithatë, kjo është e pamjaftueshme si nga pikëpamja konceptuale ashtu edhe nga ana praktike.

Të kesh të drejta dhe dinjitet të barabartë, do të thotë të jesh i barabartë dhe dinjitar brenda kategorisë shoqërore “aftësi e kufizuar” dhe pastaj të pretendosh për të qenë i barabartë me pjesën tjetër të shoqërisë. Dhe, që të ndodhë një gjë e tillë, është e domosdoshme që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të vihen në start të barabartë brendapërbrenda vetvetes dhe pastaj në raport me të gjithë shoqërinë shqiptare. Fatkeqësisht, një gjë e tillë nuk ndodh në vendin tonë, sepse gjysma e personave me aftësi të kufizuar është e diskriminuar moralisht, materialisht, ligjrisht, pra institucionalisht. Prandaj nuk janë të gjithë në një start, nuk janë përfshirë të gjithë në të ashtuquajturin “shanse të barabarta”. Deri tani, si shoqëri civile dhe si shtet, kemi folur shumë dhe kemi bërë pak, për të eliminuar diskriminimin skandaloz, që ekziston në Shqipëri edhe brenda vetë aftësisë së kufizuar.

Në vendin tonë gjysma e personave me aftësi të kufizuar, të evidentuar deri tani, trajtohen absolutisht dhe relativisht ndryshe nga gjysma tjetër. Konkretisht, personat që nuk shikojnë, invalidët e punës dhe para e tetraplegjikët janë të pajisur me statuse, kurse personat me aftësi të kufizuar mendore, fizike nuk kanë statuse,

për të mos folur për personat që nuk flasin e nuk dëgjojnë, të cilët kanë qenë jashtë çdo lloj trajtimi. Pra, ndonëse janë bërë përpjekje disavjeçare, ende nuk reagohet nga organet ekzekutive dhe legjislative në Shqipëri, ndonëse të gjitha hallkave, të gjitha partive në pushtet dhe në opozitë, të gjitha grupeve parlamentare, të gjitha qeverive e me radhë u janë dërguar drafte të statusit për personat me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike. Premtimi ka qenë i njëjtë, uniformë, sikur të vepronte dhe të dirigjonte një dorë dhe, më në fund, asgjë. Po të studiohet legjislacioni shqiptar për aftësinë e kufizuar deri te ligjet më të fundit, do të vërehet qëndrimi skandaloz diskriminues ndaj një pjese të kësaj kategorie shoqërore. Ka kundërvënie, pse jo edhe të qëllimshme nga politika, midis segmenteve të veçanta të aftësisë së kufizuar, për të treguar se “kush është me ne ka beneficione”, “kush nuk është me ne diskriminohet”. Por, krahas këtyre, bën punën e vet edhe korrupsioni, i cili ka molepsur segmente të caktuara shtetërore e pushtetore, nga radhët e shoqërisë civile dhe të huajve që operojnë në Shqipëri. Kontrolli në këtë drejtim është joekzistent. Kjo ndodh, përveç të tjerave, edhe për faktin e mungesës së Ligjit Kundërdiskriminues të personave me aftësi të kufizuar.

Shoqata “Mbrojtja, Integrimi dhe Socializimi i Artistëve me Aftësi të Kufizuara” (MIS-AAK) ka realizuar dy seminare ndërkombëtare, ku janë ngritur me forcë këto çështje, janë marrë angazhime publike dhe pastaj është heshtur. Institucioni i Avokatit të Popullit është mbajtur në korrent për dukuritë e tilla, që ndodhin në vendin tonë. Të paktën ne e kemi bërë në vijueshmëri këtë punë si detyrë tonën permanente.

Për të mos humbur në morinë e gjërave, do t’i sugjeroja Avokatit të Popullit të ndiqte me përparësi këto drejtime lidhur me aftësinë e kufizuar në Shqipëri:

Së pari, evidentimin e saktë të numrit real të personave me aftësi të kufizuar në vendin tonë. Në raportin e Avokatit të Popullit thuhet se aftësia e kufizuar përbën 3 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë, domethënë diçka mbi 100 000 vetë, gjë që s’është aspak e saktë. Në Shqipëri aftësia e kufizuar zë 10-12 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë, pra janë tre deri katër herë më tepër persona me aftësi të kufizuar. Kjo do të thotë se 200-300 000 vetë janë jashtë proceseve të rehabilitimit, integritimit, socializimit,

trajtimin moral dhe material. Në këtë rast nuk bëhet fjalë vetëm për diskriminim moral e material, por edhe për një krim të institucionalizuar. Qeverive shqiptare, kushdo qofshin ato, bën t'u vihen afate për ta realizuar me përgjegjësi këtë detyrim kushtetues, sidomos tani kur gjendemi para regjistrimit të popullsisë, por edhe si nënshkrues të dokumenteve që lidhen me asociim-stabilizimin e Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Europian, prej të cilave burojnë detyra zinxhir.

Së dyti, pajisja e të gjithë kategorisë shoqërore “aftësi e kufizuar” me staturë ose me një status integral. Nga viti 1997 e deri më sot, të gjitha qeveritë, kanë premtuar statusin integral, por asnjëra nuk e ka realizuar. Për këtë ka justifikime të çuditshme: a) “S’duan shoqatat që kanë staturë”! S’besojmë se ka shoqata, të cilat mbulojnë aftësinë e kufizuar, që t’u kundërvihen shoqatave simotra. Por edhe në se është e vërtetë një gjë e tillë, ajo bën fjalë për prekje të interesave të tyre të ngushta, çka duhet të tërheqë vëmendjen e shtetit dhe të pushtetit shqiptar. Në fakt, draftet që janë paraqitur nga ana jonë shmangin në maksimum korrupsionin e ndërthurur administratë-shoqatë.

b) “Fatura është e lartë”. E kemi thënë disa herë se kjo nuk është aspak e vërtetë. Në Shqipëri, për shembull, një numër jo i vogël banorësh nuk paguan drita, dhe faturat e reduktuara për personat me aftësi të kufizuar janë të papërfillshme. Për të mos folur pastaj për evazionin fiskal e të tjera ndodhi të tilla në Shqipëri. Sikur të zbatohet vetëm Ligji nr.7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ardhurat në favor të personave me aftësi të kufizuar nga shteti dhe sektori privat do të ishin disa dhjetëra miliarda lekë.

Së treti, pajisja e aftësisë së kufizuar me Ligjin Kundërdiskriminues. Janë një seri dokumentesh ndërkombëtare, deri te Konventa e OKB-së për Aftësinë e Kufizuar, të cilat ngrenë me forcë luftën kundër diskriminimit të personave me aftësi të kufizuar dhe të familjeve të tyre. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, direkt dhe indirekt, e thekson një gjë të tillë. E, megjithatë, politika dhe administrata shqiptare ose heshtin ose nuk pyesin fare, pra, s’duan t’ia dinë. Sikur vetëm moszbatimi i Ligjit nr.7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” të trajtohet ligjërish, përgjegjësia ligjore do të ishte jo e vogël, për ata që kanë në dorë “edhe gurin edhe arrën”! Ne kemi bërë studimin, kemi mbledhur materiale ligjore të disa shteteve, kemi grumbulluar mendimet nga

radhët e personave me aftësi të kufizuar dhe pjesëtarë të familjeve të tyre, në të gjithë Shqipërinë, se si duhet të jetë një ligj kundërdiskriminues shqiptar (jo i përkthyer) dhe të gjitha materialet gjenden pranë të ashtuquajturit “grup i punës”, por deri tani asgjë nuk është bërë, ndonëse është krijuar edhe një Komitet Shtetëror për aftësinë e kufizuar, i kryesuar nga zëvendëskryeministri!

Për të realizuar këto tri detyra madhore, institucionit të Avokatit të Popullit do t’i sugjerohet që të krijojë një sektor të veçantë*, i cili të merret vetëm me aftësinë e kufizuar, ndryshe sektori që merret tani, duke mbuluar edhe drejtime të tjera, nuk do të mundet të jetë efikas dhe i suksesshëm.

Duke e përfunduar fjalën, shprehim gatishmërinë për një bashkëpunim më të gjerë dhe më të thellë se deri tani, mbi bazën e vullnetarizmit tonë dhe shpresojmë se një gjë e tillë do të vazhdojë edhe nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Faleminderit!

REKOMANDIMET E KONFERENCËS

Në bazë të nenit 30 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, Institucioni ynë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare duhet të organizojë, të paktën një herë në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të këtij detyrimi, në datën 11 dhjetor 2006, në bashkëpunim me organizatat *Save the Children*, UNICEF, *Fondacionin Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar* dhe *Këshillin Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuar*, u zhvillua Konferenca Kombëtare “Të drejta dhe dinjitet të barabartë për Personat me Aftësi të Kufizuar”.

Kjo përzgjedhje u motivua nga fakti që kjo kategori njerëzish në nevojë, sipas burimeve zyrtare përfshin rreth 100 000 persona, që zënë të paktën 3% të numrit të përgjithshëm të popullsisë në vendin tonë. Këta janë përherë e më shumë të ekspozuar nga sfidat e një tranzicioni të vështirë dhe të vendosur në skajet e shoqërisë, me standarde të ulëta ekonomike; me mundësi të pakta arsimimi; me nivel tepër të lartë papunësie; me aftësi të kufizuara lëvizjeje; me të drejta njerëzore përgjithësisht të kufizuara dhe me praninë e një realiteti dhe mentaliteti social jo shumë integruar.

Qëllimi i Konferencës Kombëtare “Për të drejta dhe një dinjitet të barabartë për Personat me Aftësi të Kufizuar” ishte evidentimi i problemeve sociale, ligjore, ekonomike dhe politike që shqetësojnë jetën e këtyre personave, sensibilizimin e mëtejshëm të strukturave shtetërore, të opinionit të gjerë publik, të mediave vizive dhe të shkruara dhe për të vendosur objektivat dhe formuluar Rekomandimet e duhura në përputhje me legjislacionet dhe praktikatat e vendeve më të zhvilluara demokratike.

Parametrat e të drejtave dhe lirive të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe zbatimi i tyre, janë të sanksionuara në Akte dhe Konventa të shumta Ndërkombëtare, si dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut shpallet se: *të gjitha qeniet njerëzore kanë lindur të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të*

drejta dhe se gjithkush duhet t'i gëzojë këto të drejta dhe liri të shprehura në të, pa dallim të çfarëdolloji, si race, ngjyre, seksi, gjuhe, besimi fetar, politik dhe çfarëdolloj tjetër besimi, origjinë kombëtare apo sociale, pasurie, status i lindjes apo një status tjetër.

Konventa e OKB-së “Për Mbrojtjen dhe Nxitjen e të Drejtave dhe Dinjitetit të Personave me Aftësi të Kufizuar” miratuar gjatë vitit 2006, e ngritur mbi parimet e mosdiskriminimit, të barazive e të mundësive, të përfshirjes së plotë të pjesëmarrësve, të respektit për të ndryshmit, të autonomisë etj, përbën një akt madhor dhe kontribut të veçantë në njohjen, zgjerimin, standardizimin dhe unifikimin e të drejtave dhe lirive të këtyre personave.

Në të parashikohet që: *Shtetet palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar...*

Edhe në Kushtetutën tonë janë një sërë normash të rëndësishme që sanksionojnë të drejtat e personave në nevojë. Kështu në nenin 52/2 të saj parashikohet që: *Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj* -Ndërsa në nenin 56 të Kushtetutës sanksionohet se: *Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti. Kushdo ka të drejtë për sigurim shëndetësor sipas procedurës së caktuar me ligj.*

Kurse në nenin 59/e të Kushtetutës nënvizohet detyrimi që: *Shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe të plotësismit të nismës dhe të përgjegjësiive private, synon...e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët.*

Për përgatitjen e Konferencës u punua gjatë gjithë vitit 2006, duke shqyrtuar të gjitha ankesat që i kanë ardhur Avokatit të Popullit, që lidhen me të drejtat e kësaj kategorie personash gjatë viteve 2000-2006, problemet që kanë dalë, si në drejtim të legjislacionit që mbron të drejtat e tyre, ashtu dhe të zbatimit konkret të tij nga ana e organeve të administratës publike shqiptare.

Konferenca trajtoi kryesisht politikat qeveritare në drejtim të mbrojtjes së të drejtave të këtyre grupeve, ndryshimet dhe përmirësimet që i janë bërë legjislacionit në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, njohjes dhe shkallën e zbatimit të tij, roli i OJF-ve në mbrojtje të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe mbajti shënim vërejtjet dhe sugjerimet e përfaqësuesve të tyre.

Shqipëria, nëpërmjet aderimit dhe nënshkrimit të shumë akteve dhe konventave ndërkombëtare, ka marrë përsipër shumë angazhime për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar. Për të gjithë është më se e qartë se ratifikimi i Konventave ndërkombëtare nuk është një qëllim në vetvete, por është shprehje zyrtare e angazhimit të shtetit dhe shoqërisë për të garantuar zbatimin e të drejtave të parashikuara në to.

Në përfundim të punimeve të Konferencës Kombëtare me temë “Të drejta dhe dinjtet të barabartë për Personat me Aftësi të Kufizuar”, në bazë të diskutimeve, vërejtjeve, sugjerimeve dhe propozimeve të pjesëmarrësve dolën këto:

PËRFUNDIME

1) Vënia në fokus të Konferencës Kombëtare vjetore të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar, tregon se problemet e këtyre grupeve shoqërore të rrezikuara të popullsisë janë një preokupim mbarëshoqëror, përbëjnë një dëshmi të ndërgjegjësimit dhe vëmendjes së institucioneve të pavarura, të shoqërisë civile dhe opinionit publik ndaj të drejtave dhe nivelit të jetesës së tyre. Shoqëria shqiptare, me gjithë problemet e shumta që e shoqërojnë në rrugën e integrimit në strukturat euro-atlantike, në mënyrë të veçantë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian, vazhdon të shprehë mirëkuptim për detyrimin dhe përballimin e kësaj sfide, në përpjekje për bashkimin e të gjithë zërave të saj në ndihmë dhe përkrahje të sistemit aftësues për Personat me Aftësi të Kufizuar.

2) Politikat kombëtare të ndjekura deri tani në drejtim të ngritjes, reformimit dhe zgjerimit të sistemit të Ndihmës dhe Shërbimit Shoqëror në mbështetje të Personave me Aftësi të Kufizuar kanë synuar plotësimin e nevojave jetike bazë të tyre, zhvillimin e aftësive dhe mundësive personale, ruajtjen dhe forcimin e procesit të përfaqësimit, si një çështje e të drejtave të njeriut, zbutjen e varfërisë dhe të përjashtimit shoqëror për këta persona dhe familjet e tyre, dhe të krijojë kushte sa më optimale për integrimin e tyre të mëtejshëm në shoqëri dhe për mirësimin e cilësisë së jetesës të tyre.

Në mbarë vendin funksionojnë 6 qendra publike rezidenciale të përkujdesit shoqëror, ku trajtohen rreth 400 fëmijë me aftësi të kufizuar dhe 3 qendra ditore me rreth 70 fëmijë.

Në mbështetje të Personave me Aftësi të Kufizuar janë edhe

rreth 16 000 kujdestarë me pagesë.

3) Pjesëmarrja e gjerë në këtë Konferencë Kombëtare të përfaqësuesve të Kuvendit dhe drejtuesve të ministrive të linjës, tregon interesimin dhe përpjekjet e vazhdueshme të strukturave shtetërore në mbrojtjen dhe realizimin e një spektri sa më të pranueshëm të të drejtave dhe lirive themelore të Personave me Aftësi të Kufizuar.

4) Personat me Aftësi të Kufizuar, përveç mbrojtjes së veçantë kushtetuese dhe një legjislacioni të gjerë dhe që përmirësohet vazhdimisht, në mbrojtje të të drejtave të tyre, kanë edhe mbështetjen e të gjitha Konventave Ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, si Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave; Karta e Rishikuar Sociale Europiane; Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore; Konventa Kundër Torturës dhe Dhunës, Trajtimin apo Ndëshkimin Çnjerëzor dhe Poshtëruës; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike etj. Miratimi i Strategjisë së Shërbimeve Shoqërore ishte një arritje e madhe, por që duhet shpejtuar për përmbushjen e planit të veprimit që shoqëron këtë Strategji.

5) Qeveria shqiptare për vitin 2006 vuri në dispozicion të Personave me Aftësi të Kufizuar 16% fonde më shumë se një vit me parë. Ndërsa për vitin 2007, këto shpenzime janë planifikuar 8.1 miliardë lekë. Konstatohet se ka pasur mbështetje nga buxheti i shtetit për projekte të Shoqatave Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar, për ndërtimin e qendrave rehabilituese.

6) Faktor evident që vihet re është edhe fakti që Organizatat jofitimpruese, që veprojnë në fushën e ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, janë shtuar dhe forcuar vazhdimisht me potencialet e duhura njerëzore-profesionale dhe materiale, duke u bërë me ofrimin e shërbimeve të tyre një faktor tepër i rëndësishëm kontribues, alternativ dhe konkurrues me shërbimet e ofruara nga strukturat shtetërore. Konstatohet një bashkëpunim më i gjerë i tyre me strukturat shtetërore dhe me donatorët.

7) Me gjithë impenjimin e organeve të pushtetit vendor dhe aktorëve të tjerë të administratës publike, vazhdon të mbeten shqetësim zvarritjet për realizimin e të drejtave të tyre, për të cilën Personat me Aftësi të Kufizuar paraqesin ankesa konkrete.

8) Konstatohet se Personat me Aftësi të Kufizuar gjithnjë e më shumë janë ndërgjegjësuar për të drejtat e tyre dhe detyrimet që u ka shoqëria, kërkojnë gjithnjë e më shumë të dëgjohet zëri tyre, të jenë faktorë realë në promovimin e politikave të reja dhe përpiqen të luftojnë diskriminimin dhe mentalitetet tradicionale ndaj tyre, si “një grup mëshire ose si njerëz që kanë nevojë vetëm për trajtim mjekësor”.

9) Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë gjithë ushtrimit të veprimtarisë së tij në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve, nëpërmjet trajtimit të ankesave të këtij grupi të ekspozuar nga mundësitë e kufizuara për të përfituar nga programet e shtresës në nevojë, ka qenë tepër i ndjeshëm në respektimin dhe zbatimin e kërkesave të legjislacionit aktual nga organet dhe strukturat përkatëse shtetërore. Konstatohet se herë pas here, nga këto organe, shkelen, zvarriten ose mohohen të drejta dhe lehtësira të tilla që kanë të bëjnë me punësimin, arsimimin, strehimin, votimin, informimin, aksesin për lëvizje të lirë e pa pengesa në banesa dhe ambiente publike, e deri në mungesën e ndjeshme të numrit të institucioneve rezidenciale në disponim të tyre, që si emërues të përbashkët të tyre kanë neglizhencën, mungesën e kontrollit dhe anashkalimit të ligjit me shumë lehtësi nga strukturat shtetërore përkatëse.

Në bazë të përfundimeve dhe konstatimeve të mësipërme, Konferenca doli me këto

REKOMANDIME

Riformulim dhe saktësim i mëtejshëm në legjislacionin tonë, mbi bazën e konceptit evolues të aftësisë së kufizuar dhe praktikës botërore, për personin me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike.

Evidentimi i saktë i të gjithë Personave me Aftësi të Kufizuar, duke treguar kujdes të veçantë në identifikimin e tyre në zonat e thella rurale.

Nevojitet për të bërë një punë shumë të madhe me të gjithë faktorët e shoqërisë shqiptare, duke vënë në efikasitet potencialet e saj më të mira intelektuale, në mënyrë që shoqëria jonë të iluminohet deri në atë shkallë sa të shkarkojë ngarkesat jo të pakta negative për këtë shtresë në nevojë dhe t’i pranojë si të barabartë në të drejta dhe detyrime.

Fillimin e funksionimit normal të veprimtarisë të Këshillit Kombëtar për Çështjet e Aftësisë së Kufizuar, si një organ i

rëndësishëm që do të ndikojë ndjeshëm në zbutjen e problemeve të Personave me Aftësi të Kufizuar.

Qeveria të diskutojë me partnerët socialë në të gjitha rastet kur diskutohen dhe formulohen politikat dhe strategjitë e çështjeve të zbutjes së varfërisë dhe të përkrahjes me skemat e ndihmës dhe shërbimit shoqëror të shtresave në nevojë.

Të realizohet reformë në kuadrin legjislativ me objektiv aftësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar, për rritjen e aksesit të tyre në shoqëri dhe për të përfituar mundësi të barabarta si dhe sistemimi dhe përafrimi i legjislacionit tonë në fushën e ndihmës dhe shërbimeve sociale me standardet e Bashkimit European, duke i shoqëruar edhe me politika dhe mekanizma zbatues.

Pas ratifikimit të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, miratuar nga Kombet e Bashkuara, nga Kuvendi të bëhen të gjithë përpjekjet për implementimin e tij në legjislacionin tonë mbi bazën e filozofive të reja të trajtimit të përparuar të Personave me Aftësi të Kufizuar, të respektimit dhe realizimit të standardeve të lirive dhe të të drejtave si gjithë qytetaret e tjerë dhe krijimin e mundësive konkrete për integrim.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të botojë një përmbledhje të veçantë të legjislacionit për problemet dhe Personat me Aftësi të Kufizuar.

Sekretariati Teknik i Personave me Aftësi të Kufizuar të përgatisë objektivat e vitit në vazhdim për të gjitha ministrinë e linjës dhe strukturat vendore.

Legalizimi falas i banesave në zonat informale për Personat me Aftësi të Kufizuar.

Të punohet për përgatitjen dhe të miratohet Ligji “Kundër Diskriminimit”.

Monitorimi i respektimit të të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar vlerësohet si një element mjaft i rëndësishëm në përmirësimin konkret të cilësisë së jetës së tyre.

Të shpejtohet puna për përgatitjen dhe miratimin e një Ligji të ri integral, në të cilin të unifikohet përfshirja edhe e Personave me Aftësi të Kufizuar, të lënë deri tani jashtë skemave të përfitimit, si të dëmtuarit nga minat, personat endacakë, njerëzit me distrofi muskulore, persona me aftësi të kufizuara, të bërë të tillë pas moshës 21 vjeç, persona handikapë mendorë etj.

Të bëhen rekomandime për daljen e akteve nënligjore për zbatimin tërësor të Ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, për VKM nr.8, datë 07.01.2005 “Strategjia e Shërbimeve Shoqërore”.

Garantimi i të drejtës së punësimit të sigurohet në kushte të barabarta edhe për Personat me Aftësi të Kufizuar, si gjithë shtetasit e tjerë, në mënyrë që kjo kategori të ketë një punë të përshtatshme dhe të kenë të ardhura nga puna, të cilat do të ndikojnë në rritjen e mirëqenies dhe të respektimit të integritetit të tyre human. Të bëhen ndryshime në Ligjin nr.7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, për forcimin e strukturave të kontrollit në realizimin e normës ligjore, që parashikon që subjektet punëdhënëse që punësojnë 25 punonjës, njëri prej tyre duhet të jetë Person me Aftësi të Kufizuar, si dhe forcimin e sanksioneve dhe zgjerimit të tyre me alternativa të tjera për kundërvajtësit administrativë. Gjithashtu, të studiohet mundësia e përmirësimit të stimujve për inkurajimin e punësimit të këtyre personave dhe të legalizimit për disa vende pune në Administratën Publike ose në sektorin e shërbimeve shtetërore apo private, të jenë të destinuara vetëm për këtë kategori personash.

Të shtohen fondet sociale për ngritjen e shërbimeve të reja me ndarje të gjere gjeografike, veçanërisht të njëjësive ditore të shërbimit, për konsolidimin e qendrave rezidenciale ekzistuese, sidomos për fëmijët dhe të moshuarit me aftësi të kufizuar, sigurimin e mjeteve lëvizëse, si dhe për decentralizimin e tyre.

Ministria e Shëndetësisë të konkretizojë angazhimet e saj në ngritjen e një rrjeti kabinetesh të rehabilitimit fizik-mjekësor dhe të trajtimit mendor.

Të ngrihet nga strukturat shtetërore të linjës një sistem informacioni i detajuar për Personat me Aftësi të Kufizuar, që të përfshijë të dhëna për grup-moshat, llojin e aftësisë së kufizuar, gjininë, nivelin arsimor, që do jetë në shërbim të vlerësimit më të mirë të politikave aktuale dhe në ndërmarrjen e hapave të tjerë për realizimin e të drejtave të këtyre personave

Shteti mund të lehtësohet në fushën e shërbimeve sociale, duke u ndihmuar në këtë drejtim nga biznesi dhe donatorë vendës dhe të huaj. Asnjë shtet, sado i fuqishëm të jetë, nuk mund të mbajë i vetëm një barrë të tillë.

Të punohet për përmirësimin e legjislacionit për projektimin dhe planifikimin urban, për përshtatshmërinë e ambienteve të Të

realizohet konkretisht një nga të drejtat themelore të njeriut, e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur për Personat me Aftësi të Kufizuar, nëpërmjet përmirësimit të Kodit Zgjedhor, për të votuar këto grupe edhe jashtë qendrave të votimit, për alternativat e aksesit në qendrën e votimit, të shërbimit të përkthimit për personat që nuk dëgjojnë dhe përdorimin e mjeteve të votimit të posaçme për personat që nuk shikojnë.

Të shikohet mundësia e lehtësimit të mëtejshëm ose të përjashtimit nga detyrimet e disa taksave dhe tatimeve për Personat me Aftësi të Kufizuar, si një ndihmë konkrete në përmirësimin e gjendjes ekonomike të tyre.

* * *

Në përfundim, Konferenca konkludoi se përmirësimi i sistemit të ndihmës dhe shërbimit shoqëror dhe përshtatja e legjislacionit aktual në këtë fushë me atë të vendeve më të përparuara dhe të Marrëveshjeve dhe Konventave në të cilat Republika e Shqipërisë ka aderuar, do të ndikojë ndjeshëm dhe pozitivisht në përmirësimin e trajtimit dhe integritit të grupeve të Personave me Aftësi të Kufizuara në komunitet.

Sipas mendimit të përgjithshëm, Konferenca ia arriti qëllimit për sensibilizimin dhe angazhimin më të madh të të gjitha organeve, strukturave dhe autoriteteve të administratës publike, për zbatimin e Kushtetutës, akteve të njohura ndërkombëtare, ligjeve përkatëse si dhe rekomandimeve të kësaj Konference. Rekomandimet do u dërgohen Kuvendit, Kryeministrit dhe gjithë ministrive që përfshihen në fushën e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar. Materialet e Konferencës do të botohen dhe do u shpërndahen të gjithë të interesuarve.

Shpresojmë se rekomandimet e kësaj Konference do të vlerësohen me seriozitet dhe do të fillojnë të implementohen nga të gjitha organet kompetente. Institucioni i Avokatit të Popullit do të ndjekë zbatimin e këtyre rekomandimeve.

¹ Ann Elwan, Poverty and Disability; a background paper for the World Development Report, World Bank, October 1999.

² <http://www.un.org/esa/socdev/enable/rights/ahcwgreportax1.htm>

³ For more on this approach, see European Disability Forum, *EDF Policy Paper – Development Cooperation and Disability*, 2002, pp.60-61. Available at: http://www.iddc.org.uk/dis_dev/mainstreaming/edf_policy.pdf.

Konferenca Kombëtare
"AVOKATI I POPULLIT NË MBROJTJE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA"









116



